



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Nr. Protokolit: 060101-4178

Data: 20 Janar 2025

Për: Anëtarët të Kuvendit të Komunës së Pejës

Të nderuar anëtar/e

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1. të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 28, paragrafi 1 i Statutit nr. 01-2020 të Komunës së Pejës dhe në bazë të nenit 11, paragrafi 1.2, neni 15, paragrafi 1 të Rregullorës nr.02-2021 për Punën e Kuvendit të Komunës së Pejës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ju:

THËRRET

Të merrni pjesë në mbledhjen e I të rregulltë për vitin 2025, të Kuvendit të Komunës së Pejës. Mbledhja do të mbahet me dt. 31.01.2025 (Premte), ora: 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Vërëjtje: Kuvendi i Komunës mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.

RENDI I DITËS

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 30.12.2024.
4. Shqyrtimi i i informatës së Komandantit të Policisë së Stacionit Policor në Pejë mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Pejës.
5. Shqyrtimi dhe miratimi pas diskutimit publik i draft Rregullores për Shërbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës.
6. Shqyrtimi i informatës së kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të Komunës së Pejës.
7. Shqyrtimi i informatës mbi planifikimin e Prokurimit për vitin 2025.
8. Shqyrtimi i informatës së kryetarit mbi planin e punës së ekzekutivit për 2025.
9. Shqyrtimi i informatës mbi raportin vjetor të Komunës së Pejës për vitin 2024.
10. Shqyrtimi i raporti informativ i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2024.
11. Shqyrtimi i raportit të KKS-së për vitin 2024.
12. Shqyrtimi i raporteve informative të Komiteteve Konsultative dhe komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës së Pejës.
 - a. Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara;
 - b. Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit;
 - c. Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik;
 - d. Komiteti për Shëndetësi;
 - e. Komiteti për Arsim dhe

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433

f. Komiteti për Urbanizëm dhe Mbrojtjeje të Mjedisit.

13. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar. (Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Enjten me dt. 30 janar 2025).

14. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

KRYESUESI KUVENDIT

z. Rexhep Kurtbogaj



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Nr. Protokolit:

Data: 20 Janar 2025

Për: Anëtarët të Kuvendit të Komunës së Pejës

Të nderuar anëtar/e

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1. të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 28, paragrafi 1 i Statutit nr. 01-2020 të Komunës së Pejës dhe në bazë të nenit 11, paragrafi 1.2, neni 15, paragrafi 1 të Rregullorës nr.02-2021 për Punën e Kuvendit të Komunës së Pejës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ju:

THËRRET

Të merrni pjesë në mbledhjen e I të rregulltë për vitin 2025, të Kuvendit të Komunës së Pejës. Mbledhja do të mbahet me dt. 31.01.2025 (Premte), ora: 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Vërejtje: Kuvendi i Komunës mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.

RENDI I DITËS

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 30.12.2024.
4. Shqyrtimi i i informatës së Komandantit të Policisë së Stacionit Policor në Pejë mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Pejës.
5. Shqyrtimi dhe miratimi pas diskutimit publik i draft Rregullores për Shërbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës.
6. Shqyrtimi i informatës së kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të Komunës së Pejës.
7. Shqyrtimi i informatës mbi planifikimin e Prokurimit për vitin 2025.
8. Shqyrtimi i informatës së kryetarit mbi planin e punës së ekzekutivit për 2025.
9. Shqyrtimi i informatës mbi raportin vjetor të Komunës së Pejës për vitin 2024.
10. Shqyrtimi i raportit informativ i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2024.
11. Shqyrtimi i raportit të KKSB-së për vitin 2024.
12. Shqyrtimi i raporteve informative të Komiteteve Konsultative dhe komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës së Pejës.
 - a. Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara;
 - b. Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit;
 - c. Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik;
 - d. Komiteti për Shëndetësi;
 - e. Komiteti për Arsim dhe

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433

- f. Komiteti për Urbanizëm dhe Mbrojtjeje të Mjedisit.
13. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar. *(Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Enjten me dt. 30 janar 2025).*
14. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

KRYESUES I KUVENDIT
z. Rexhep Kurtbogaj

Raport mbi Gjendjen Ekonomiko Financiare

Sipas raportit financiar JANAR – DHJETOR ne Komunën tone paraqitet një gjendje stabile Ekonomiko –Financiare ne përgjithësi ne te gjithë sektorët. Komuna e Pejës vazhdon te ketë trend shume pozitiv ne te hyrat Komunale dhe për ketë periudhe kemi arrit qe ta realizojmë planifikimin e te hyrave vet anakë, prej 5.3 Milion sa kane qene te planifikuara për te gjithë vitin 2024, Komuna e Pejës ka arrit qe ta tejkalon planin e te hyrave vet anakë, me saktësisht kemi arrit te inkasojmë 7.25 mil Euro se bashku me donacione Ne baze te kësaj ecurie te realizimit te hyrave për vitin 2024 kemi tejkallim te planit buxhetor rreth 1 Milion Euro dhe me ketë planifikohet mbulimi i obligimeve te projekteve për vitin 2024 si rezultat i shpenzimit te buxhetit nga projektet kapitale për vendime gjyqsore si pasoje e kontratës kolektive.

Buxheti i vitit 2024 për te gjitha kategoritë ekonomike është shpenzuar 98.30%

Sa i përket shpenzimeve dominon shpenzimi ne kategorinë e pagave dhe atë praktikisht është shpenzu ne tërësi shuma prej **21,114**. Milion Euro, kontrata kolektive e ka rrit shpenzimin ne kategorinë paga dhe mëditje sa ka qene e planifikuar për paga, shpenzimi i përgjithshëm I kësaj kategorie është si rezultat i ekzekutimet te vendimeve gjyqsore si shkak i kontratës kolektive.

Kategoria e Investimeve kapitale e përben shpenzim rreth **95.51%** apo rreth **13,881** Milion Euro, te kjo kategori kemi trend me pozitiv te shpenzimit dhe arritje e kriterëve te përcaktuara për grantin e performances.

Tek kategoritë tjera: Subvencione, Mallera e Shërbime dhe Shpenzime Komunale e kemi realizim te shpenzimit konform planifikimeve buxhetore te vitit 2024

Sfide konkrete për ketë vit mbetet ekzekutimet e vendimeve gjyqsore si shkak i kontratës kolektive, kemi te ekzekutuar rreth 7,115,milion Euro, fatkeqësisht këto ekzekutime vazhdojnë te ndodhin, edhe ne baze te kalkulimeve do te kemi ekzekutime te tilla edhe ne vitin 2025.

Kjo ishte një raport i shkurte për gjendjen ekonomiko financiare te Komunës sonë për periudhën JANAR – dhjetor, te detajuar si raport e keni te përgatitur ne piken vijuese te rendit te ditës.

3	30000000-9	Furnizim me material elektrik per shkolla	23.05.2025	1	Furnizim me material elektrik per shkolla				20.000,00
4	30000000-9	Blerja e kompjutereve dhe paisjeve percjellese për shkolla	14.02.2025	1	Blerja e kompjutereve dhe paisjeve percjellese për shkolla				20.000,00
5	30000000-9	Furnizim me material për mirëmbajtjen e nyjeve sanitare , kanalizimit dhe ujit	10.02.2025	1	Furnizim me material për mirëmbajtjen e nyjeve sanitare , kanalizimit dhe ujit				30.000,00
6	30000000-9	Furnizim me materiale te textilit (Çarshafa , jorgana , jasteka,dyshek) për nevojat e qerdheve dhe shkollave	10.01.2025	1	Furnizim me materiale te textilit (Çarshafa , jorgana , jasteka,dyshek) për nevojat e qerdheve dhe shkollave				15.000,00
7	30000000-9	Blerja e shtretereve dhe ormanave per cerdhet e K. Pejes	10.01.2025	1	Blerja e shtretereve dhe ormanave per cerdhet e K. Pejes				25.000,00
8	30000000-9	Blerja dhe servisimi e aparateve per fikjen e zjarrit per shkolla	07.04.2025	1	Blerja dhe servisimi e aparateve per fikjen e zjarrit per shkolla				5.000,00
9	30000000-9	Furnizimi me kamera te sigurise per shkolla	07.04.2025	1	Furnizimi me kamera te sigurise per shkolla				3.000,00
10	30000000-9	Furnizim me makineri bujqësore për fermer	10.01.2025	1	Furnizim me makineri bujqësore për fermer				160.000,00
11	30000000-9	Furnizim me material shpenzues per analiza biokimike dhe hematologjike ne Laboratorin e QKMF-së	15.04.2025	1	Furnizim me material shpenzues per analiza biokimike dhe hematologjike ne Laboratorin e QKMF-së				30.000,00
12	30000000-9	Furnizim me shenja unike shendetsore ndriqese dhe te shtypura	07.04.2025	1	Furnizim me shenja unike shendetsore ndriqese dhe te shtypura				10.000,00
13	30000000-9	Furnizim me barna dhe material shpenzues mjeksore per barnatoren qendrore prane QKMF per plotesimin e mungesave me furnizim nga lista esenciale	21.04.2025	1	Furnizim me barna dhe material shpenzues mjeksore per barnatoren qendrore prane QKMF per plotesimin e mungesave me furnizim nga lista esenciale				120.000,00
14	30000000-9	Furnizimi me materiale te ndryshme per sistemin e ngrohjes,kanalizimit dhe pompave termike solarve per QKMF dhe Administrat	10.02.2025	1	Furnizimi me materiale te ndryshme per sistemin e ngrohjes,kanalizimit dhe pompave termike solarve per QKMF dhe Administrat				30.000,00
15	30000000-9	Furnizim me material per mirembajtjen e objekteve shendetesore	17.02.2025	1	Furnizim me material per mirembajtjen e objekteve shendetesore				35.000,00
16	30000000-9	Furnizim me Kompjutera (Desktop ,Monitor,Projektor)	17.02.2025	1	Furnizim me Kompjutera (Desktop ,Monitor,Projektor)				10.000,00

17	30000000-9	Furnizim me Klima inverter per QKMF dhe njesite e saj Kontrat Korniza	10.02.2025	1	Furnizim me Klima inverter per QKMF dhe njesite e saj Kontrat Korniza				15.000,00
18	30000000-9	Furnizim me material Administrativ për SHCK (Kontratë kornizë)	15.01.2025	1	Furnizim me material Administrativ për SHCK (Kontratë kornizë)				20.000,00
19	30000000-9	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	20.01.2025	1	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative				3.000,00
20	30000000-9	Furnizim me materiale percjellese (broshura, rrollbanera, brosha, stikera,...) per shenimim e fushatave sensibilizuese per zyren per barazi gjinore dhe zyren per te drejta te femijeve	20.01.2025	1	Furnizim me materiale percjellese (broshura, rrollbanera, brosha, stikera,...) per shenimim e fushatave sensibilizuese per zyren per barazi gjinore dhe zyren per te drejta te femijeve				25.000,00
21	30000000-9	Furnizim me materiale te ndryshme per sistemin e ujit, kanalizimit, sanitarise per Drejtorine e Administrates dhe QKMF	20.01.2025	1	Furnizim me materiale te ndryshme per sistemin e ujit, kanalizimit, sanitarise per Drejtorine e Administrates dhe QKMF				50.000,00
22	30000000-9	Furnizim me karrika per Administrat	10.04.2025	1	Furnizim me karrika per Administrat				30.000,00
23	30000000-9	Furnizim me procesverbale, blloka te gjobave, shiritave blloba dhe materialeve administrative te ndryshme qanta dhe jelek	10.03.2025	1	Furnizim me procesverbale, blloka te gjobave, shiritave blloba dhe materialeve administrative te ndryshme qanta dhe jelek				5.000,00
24	30000000-9	Blerja e Instrumenteve per matje Gjeodezike	15.01.2025	1	Blerja e Instrumenteve per matje Gjeodezike				20.000,00
Totali i Vlerës									729.000,00

II.2) KONTRATAT PËR SHËRBIME

Rendor i prokurimeve	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përafërt Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës
25	72000000-5	Sherbime te Internetit neper Shkolla	05.02.2025	1	Sherbime te Internetit neper Shkolla				5.000,00
26	80330000-6	Ofrimi i sigurimeve aksidentale per nxenesit e shkollave Profesionale	07.07.2025	1	Ofrimi i sigurimeve aksidentale per nxenesit e shkollave Profesionale				4.000,00
27	80400000-8	Festivali Peja Outdoor	20.02.2025	1	Festivali Peja Outdoor				20.000,00
28	80400000-8	Panairi Veror	17.03.2025	1	Panairi Veror				20.000,00
29	80400000-8	Materjale Promovuese	25.06.2025	1	Materjale Promovuese				15.000,00
30	85111100-1	Blerja e sherbimeve mjekesore	24.02.2025	1	Blerja e sherbimeve mjekesore				7.000,00
31	80330000-6	Shërbimet kontraktuese angazhimi i ekspertit të sigurisë	04.02.2025	1	Shërbimet kontraktuese angazhimi i ekspertit të sigurisë				7.800,00
32	85111100-1	Servisimet e paisjeve mjeksore dhe Diagnostikes	12.03.2025	1	Servisimet e paisjeve mjeksore dhe Diagnostikes				17.000,00
33	80330000-6	Organizimi dhe mbajtja e takimeve letrare Azem Shkreli	12.03.2025	1	Organizimi dhe mbajtja e takimeve letrare Azem Shkreli				10.000,00
34	80330000-6	Organizimi i aktivitetit vjetor Sportisti i Vitit	20.03.2025	1	Organizimi i aktivitetit vjetor Sportisti i Vitit				5.000,00
35	90320000-6	Renimi i Objekteve	10.02.2025	1	Renimi i Objekteve				63.000,00
36	90320000-6	Asgjesimi i mbetjeve mjeksore dhe stoqeve dhe barnave me skadenc	17.02.2025	1	Asgjesimi i mbetjeve mjeksore dhe stoqeve dhe barnave me skadenc				7.000,00
Totali i Vlerës									180.800,00

II.3) KONTRATAT PËR PUNË

Rendor i prokurimeve	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përafërt Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës
37	45222210-4	Rindertimi i Shkollave dhe Anekseve ne Nabergjan, Llozhan, Terstenik, Lidhja e Prizrenit, Ramiz Sadiku, Qyshk, Zahaq, dhe rrethoja ne Hil Mosi Jabllanice	24.01.2025	1	Rindertimi i Shkollave dhe Anekseve ne Nabergjan, Llozhan, Terstenik, Lidhja e Prizrenit, Ramiz Sadiku, Qyshk, Zahaq, dhe rrethoja ne Hil Mosi Jabllanice				200.000,00
38	45222210-4	Ndertimi i trafos ne Qerdhen Vitomerice	24.01.2025	1	Ndertimi i trafos ne Qerdhen Vitomerice				31.000,00
39	45232452-5	Ndërtimi i kanalit në lagjen Asllan Çeshme faza II	20.01.2025	1	Ndërtimi i kanalit në lagjen Asllan Çeshme faza II				30.000,00
40	45112310-1	Ndertimi i rruges Qerdhja "Pellumbat e Paqes" - Shetitorja buze Lumbardhit	23.01.2025	1	Ndertimi i rruges Qerdhja "Pellumbat e Paqes" - Shetitorja buze Lumbardhit				110.000,00
41	45262500-6	Rregullimi I infrastrukures per rreth bizneseve ne hapsirave publike	23.01.2025	1	Rregullimi I infrastrukures per rreth bizneseve ne hapsirave publike				150.000,00
42	45232452-5	Ndertimi i rrugës së Bjeshkës së Jabllanices së Vogel	10.02.2025	1	Ndertimi i rrugës së Bjeshkës së Jabllanices së Vogel				50.000,00
43	45451000-3	Ndërtimi i rrethojave metalike në Varreza	20.02.2025	1	Ndërtimi i rrethojave metalike në Varreza				150.000,00
44	45232452-5	Ndertimi i impiantit ne fshatin Kryshec	20.02.2025	1	Ndertimi i impiantit ne fshatin Kryshec				200.000,00
45	45232452-5	Ndërtimi i impiantit në Jabllanicë të Leshanit	13.03.2025	1	Ndërtimi i impiantit në Jabllanicë të Leshanit				200.000,00
46	45451000-3	Ndertimi I rruges ne zonen industriale ne Zahaq, Sferke , Lutogllave	25.03.2025	1	Ndertimi I rruges ne zonen industriale ne Zahaq, Sferke , Lutogllave				100.000,00
47	45451000-3	Ndertimi i objektit ne varrezat Katolike	26.03.2025	1	Ndertimi i objektit ne varrezat Katolike				35.000,00
48	45232452-5	Ndërtimi i Kanalizimit në lagjet Kapeshnice, Lagjen e Gurit, Lagjen Kristal, Bazeni madh-bellopoj	20.03.2025	1	Ndërtimi i Kanalizimit në lagjet Kapeshnice, Lagjen e Gurit, Lagjen Kristal, Bazeni madh-bellopoj				50.000,00
49	45451000-3	Rindërtimi i Murit të lumit dhe mveshja e murit me gurë	14.03.2025	1	Rindërtimi i Murit të lumit dhe mveshja e murit me gurë				250.000,00

50	45451000-3	Ndërtimi dhe regullimi i hapësirave gjelbruese buzë Lumbardhit dhe në lagjen Asllan Çeshme -shpronsime - impianti Gorozhdec	24.01.2025	1	Ndërtimi dhe regullimi i hapësirave gjelbruese buzë Lumbardhit dhe në lagjen Asllan Çeshme -shpronsime - impianti Gorozhdec				900.000,00
51	45262300-4	Asfaltimi dhe ndertimi I rugeve dhe trotuareve ne Qytet	20.01.2025	1	Asfaltimi dhe ndertimi I rugeve dhe trotuareve ne Qytet				500.000,00
52	45451000-3	Asfaltimi I rrugeve ne Fshatra	20.01.2025	1	Asfaltimi I rrugeve ne Fshatra				600.000,00
53	45451000-3	Ndertimi i urres se automjeteve Kapeshnic Qender -Faza II	20.02.2025	1	Ndertimi i urres se automjeteve Kapeshnic Qender -Faza II				200.000,00
54	45451000-3	Rindertime te ndryshme ne QKMF dhe njesite e saj.	12.03.2025	1	Rindertime te ndryshme ne QKMF dhe njesite e saj.				64.271,00
55	45451000-3	Shtepia per mbrojtjen e femijeve	18.03.2025	1	Shtepia per mbrojtjen e femijeve				50.000,00
56	45451000-3	Shtepia e komunitetit per persona te moshuar	25.03.2025	1	Shtepia e komunitetit per persona te moshuar				230.000,00
57	45451000-3	Mobilimi i shtepis Emergjente	20.01.2025	1	Mobilimi i shtepis Emergjente				80.000,00
58	45232452-5	Ndërtimi i kanaleve të Seravisë, Katundi I ri dhe fshati Zahaq, Gorazhdec	20.03.2025	1	Ndërtimi i kanaleve të Seravisë, Katundi I ri dhe fshati Zahaq, Gorazhdec				200.000,00
59	45451000-3	Renovimi I Teatrit Istref Begolli Faza finale	14.04.2025	1	Renovimi I Teatrit Istref Begolli Faza finale				170.000,00
60	45451000-3	Ndertimi I Palestres se sportive Zahaq Faza perfundimtare	10.06.2025	1	Ndertimi I Palestres se sportive Zahaq Faza perfundimtare				150.000,00
Totali i Vlerës									4.700.271,00

II.4)KONKURSET E PROJEKTIMIT

Rendor i prokurimeve	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përafërt Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës
61	93000000-8	Hartimi I Projektit te objektit te Kuvendetit,	12.05.2025	1	Hartimi I Projektit te objektit te Kuvendetit,				30.000,00
62	93000000-8	Hartimi I Projektit Shkolla Filllore Loxhe	12.05.2025	1	Hartimi I Projektit Shkolla Filllore Loxhe				15.000,00
63	93000000-8	Hartimi I projektit Sheshi nga Ura zallit deri tek Ura e Re nga Pjesa e Qender	12.05.2025	1	Hartimi I projektit Sheshi nga Ura zallit deri tek Ura e Re nga Pjesa e Qender				15.000,00
64	93000000-8	Hartimi I projektit Sheshi nga Ura zallit deri tek Ura e Re nga Pjesa e Kapeshnices	12.05.2025	1	Hartimi I projektit Sheshi nga Ura zallit deri tek Ura e Re nga Pjesa e Kapeshnices				15.000,00
65	93000000-8	Hartimi i projektit-Implanti i ujerave te zeza ne fshatin Leshan	14.04.2025	1	Hartimi i projektit-Implanti i ujerave te zeza ne fshatin Leshan				15.000,00
66	93000000-8	Hartimi I projektit-Rrjeti i Ujesjellesit ne Fshatrat Shtupeq i Vogel dhe Shtupeq i madhe	22.04.2025	1	Hartimi I projektit-Rrjeti i Ujesjellesit ne Fshatrat Shtupeq i Vogel dhe Shtupeq i madhe				10.000,00
Totali i Vlerës									100.000,00



Komuna e Pejës
Municipality of Peja
Opština Peć

Plani i Punës 2025

Janar, 2025



Data/Date/ Datum;	3.01.2025
Për / To/Za :	Zyrës se Kryetarit
Nga /From/ Od	Drejtoria e Administratës
Lënda/Subject/Tema:	Plani i punës për vitin 2025

Drejtoria për Administratë

Drejtoria për Administratë mbulon 9 (Nëntë) Sektorë:

1. Gjendja civile
2. Qendra për shërbim të qytetarëve
3. Zyra ligjore
4. Përkthim dhe lekturim
5. Teknologji informative
6. Logjistikë
7. Mjeteve themelore (pasurisë komunale)
8. Barazi Gjinore
9. Mbrojtjen e fëmijëve dhe ri integrim

Planifikimi i punëve për vitin 2025 nga Sektorët është:

SEKTORI - GJENDJA CIVILE

1.Aktvendime për regjistrim me vonesë ne RTHL	255
2.Aktvendime për regjistrim me vonesë në RTHV	412
3.Aktvendime për korrigjime të emrit/mbiemrit	410
4.Vendime për ndërrim të emrit/mbiemrit	306
5.Regjistrime në RTHL-ve	2485
6.Regjistrime në RTHV-ve	1614
7.Regjistrime në RTHM-ve	1590
8.Lëshuarje certifikata të lindjes	35100
9.Lëshuarje ekstrakte të lindjes	78510
10.Lëshuarje certifikata të kurorëzimeve	22100
11.Lëshuarje certifikata të vdekjes	9215
12.Lëshuarje certifikata të statusit martesor	2539
13.Lëshuar certifikata të vendbanimit	10774
14.Lëshuarje e vërtetimeve të vendqëndrimit	1370
14.Lëshuar certifikata të shtetësisë	1674
15.Lëshuar deklarata të Bashkësisë Familjare	8812
16.Lëshuar vërtetime nga Arkiva	2210
17. Aplikime për tu liruar nga shtetësia e Kosovës	65
18. Aplikime për ta fituar shtetësinë e Kosovës	350
19.Aplikime për të rikthyer shtetësinë e Kosovës	250

Në total nga zyrtarët dhe e-kiosku planifikohet të jepen shërbime:..... **180.041**

Ne taksa parashikohet të realizohen: 204.893,00 €

SEKTORI - QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE

- Mbikëqyrja e të gjitha aktiviteteve të sektorit dhe sigurim sa me efikas të shërbimeve me qytetar në raport me Institucionin, gjithashtu bashkëpunim të plotë me Drejtorin rreth caktimit të objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e objektivave. Aprovimi i lëndëve nga Drejtoria për Administratë,
- Mbështetje dhe këshilla për Drejtorinë përkatëse sipas kërkesës së Udhëheqësit më të lartë Administrativ të institucionit dhe titullarin e institucionit për fushën e përgjegjësisë së sektorit. Lajmërimi i qytetarëve rreth përgjigjeve të lëndëve nga Drejtoritë,
- Pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes, sipas fushës së përgjegjësisë, duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analizave të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes.
- Zhvillimi i planit të punës për zbatimin e detyrave të lidhur me shërbimet të cilat i ofrohen qytetarëve nga ky sektor.
- Sigurim komunikimi në raport me qytetarët dhe zyrtarët e sektorit përkatës të institucionit lidhur me kërkesat dhe parashtratat tjera të qytetarëve.
- Organizimi dhe shpërndarja e punëve për stafin si dhe menaxhimi i realizimit të detyrave dhe përgjegjësisë që duhen përmbushur në përputhje me objektivat dhe përgjegjësitë e sektorit.
- Dërgimi i zyrtarëve në trajnime rreth avancimit dhe ngritjes së kapaciteteve të shërbimeve sa me cilësore në raport me qytetarët dhe zyrtarët përkatës.
- Pranimi i kërkesave/ankesave për të gjitha Drejtoritë si dhe shpërndarja e tyre tek Drejtoritë përkatëse.

SEKTORI - ZYRA LIGJORE

Zyra Ligjore në bazë të kërkesës së juaj të parashtruar, si me poshtë ka listuar planin e punë për vitin 2025.

- Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe pjesëmarrje në seminare të organizohen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Punëve të Brendshme, Organizata e Sigurisë dhe Bashkëpunimit Evropian dhe Kolegjiumi i Zyrtarëve Ligjore në kuadër të AKK-së.
- Shkëmbimi i përvojave më të mira me zyrtarët ligjorë respektivisht me shefat e zyrave ligjore të komunave të Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e ligjeve sektoriale dhe akteve nënligjore.
- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me të gjitha zyrtarët ligjorë të Shërbimit Civil Komunal.
- Ofrimi i ndihmës juridike të sektorëve të drejtorive të Komunës lidhur me zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore sektoriale.
- Evidentimi i ligjeve dhe akteve nënligjore të cilat e obligojnë Komunën në zbatimin e tyre.
- Shqyrtimi i të gjitha projekt akteve të cilat propozohen nga drejtoritë respektive në realizimin e kompetencave vetanake apo të deleguara.
- Konsultimi në aspektin juridik për Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit.
- Angazhime tjerat eventuale të deleguar nga Drejtori i administratës dhe raportimi tre mujor, gjashtë mujor, nëntë mujor dhe dymbëdhjetë mujor.

SEKTORI - PËRKTHIM DHE LEKTURIM

Prioriteti I	Avancimi profesional për zbatimin e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunë
Objektiva I	Ngritja e kapaciteteve për përkthyes përmes trajnimeve dhe pjesëmarrjes në seminare që organizohen nga komuna, Qeveria, Ministria apo organizata e ndryshme ndërkombëtare.
Aktiviteti 1	Trajnime, Seminare, Punëtori.
Aktiviteti 2	Shkëmbimi i përvojave të mira në mes të përkthyesve të komunave të Kosovës si dhe të vendeve fqinje si dhe vendeve të BE-së lidhur me praktikat e përdorimit të gjuhëve zyrtare në administratën lokale.
Objektiva II	Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe zbatimi i Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë si dhe Rregullores komunale për përdorimin e gjuhëve zyrtare.
Aktiviteti 1	Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve me të gjitha Drejtoritë komunale lidhur me zbatimin e ligjit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare.
Aktiviteti 2	Zbatimi në praktikë i Rregullores mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunë.
Aktiviteti 3	Bashkëpunimi me Kolegjiumin e përkthyesve të komunave të Kosovës në realizimin e detyrave dhe obligimeve.
Prioriteti II	Strategjia e punëve në përkthim në secilën Drejtori.
Objektiva III	Njoftim me Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe me Rregulloren e komunës mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare, implementimi dhe zbatimi i saj i përgjithshëm.
Aktiviteti 1	Dërgimi i dokumenteve përmes shërbimit digjital, përkthimi, kthimi dhe shpërndarja deri të pala.
Aktiviteti 2	Komunikimi në mes të drejtorive dhe Zyrës së përkthimit. Komunikimi zyrtar. Komunikimi digjital pa pasur nevojë që pala të jetë ndërmjetëse në këtë proces.
Aktiviteti 3	Përkthimi i të gjitha Rregulloreve dhe akteve tjera normative që i miraton Kuvendi i Komunës. Rregulloret dhe vendimet e ndryshme që qytetarët të jenë të informuar mbi punën e Komunës në përgjithësi.
Aktiviteti 4	Bashkëpunimi me donator dhe partnerët tjerë në fushën e përkthimeve.
Aktiviteti 5	Përkthimi i të gjitha dokumenteve dhe akteve tjera të të gjitha drejtorive dhe organeve të komunës të cilat vijnë në Zyrën e përkthimit. Përgatitja e Raportit vjetor të punës dhe realizimi i Planit vjetor të paraparë.

Sektori për Teknologji Informative ka përmbushur objektivat e parashikuara për vitin 2024.

Si sektor planifikojmë objektivat dhe aktivitetet si me poshtë për vitin 2025:

Planifikimi i punëve nga Sektori për Teknologji Informative për vitin 2025	
Objektiva 1:	
Ngritja e kapacitetit të stafit nga sektori për Teknologji Informative	
Aktiviteti 1	Seminare, trajnime dhe punëtori - Avancimin e shërbimeve elektronike, Digjitalizim i brendshëm dhe Digjitalizimin e jashtëm dhe trajnimi i SHCK-al.
Aktiviteti 2	Vizita pune në vendet fqinjë, vizita ne Komunat e Kosovës - Shkëmbimi i përvojave, e ne shërbim të futjes se ideve dhe përvojave të reja në funksion
Objektiva 2:	
Furnizim me kamera, pajisje të zërimit dhe pajisje tjera digjitale për Administratë dhe Objektet e SHCK	
Aktiviteti 1	Mirëmbajtja dhe Blerja e Kamerave për objektet e SHCK
Aktiviteti 2	Mirëmbajtja dhe blerja e kamerave të qytetit
Aktiviteti 3	Blerja dhe vendosja e panove digjitale njoftuese në objektet e Administratës
Aktiviteti 4	Blerje e pajisjeve te zërimit dhe software për sallën e Asamblesë Komunale.
Aktiviteti 5	Shtrirja e rrjetit të Internetit (Fiber Optik) në qytet
Objektiva 3:	
Avancimi i Teknologjisë dhe rritja e kapacitetit për ruajtjen e te dhënave	
Aktiviteti 1	Hapja e një hapësire për ruajtjen e te dhënave për zyrtarët, secili zyrtar do ketë një hapësirë të veçantë për ruajtjen e te dhënave.
Aktiviteti 2	Krijimi i bazave te dhënave - Krijimi i bazave te dhënave sipas kërkesave qe i drejtojnë Drejtoritë përmes Drejtorisë për Administratë.
Aktiviteti 3	Blerja e kompjuterëve - blerja dhe zëvendësimi i kompjuterëve të vjetër me të ri, ndikimi direkt në përmirësimin e shërbimeve, shpejtësia e zbatimit të planit të punës, teknologjia e fundit qe mund të ketë kapacitetin e përditësimeve të reja - Windows 11 etj.
Aktiviteti 4	Mirëmbajtja e E-kioskut – Shërbime cilësore 24/7 për qytetarët, planifikohet edhe avancimi me një shërbim të ri, lëshuarja e kopjeve të planit (Gjithnjë në koordinim me ASHI).
Objektiva 4:	
Projekte të cilat planifikohen të realizohen nëse financohen nga ndonjë grand apo donatorë	
Aktiviteti 1	Smart City (Qyteti i mençur) avancimi i të gjitha shërbimeve digjitale brenda territorit të qytetit
Aktiviteti 2	Vendosja e radarëve në hyrjet e qytetit - Hyrja nga Prishtina, Mitrovica dhe Deçani

SEKTORI - LOGJISTIKË

- Mirembajtja e Objekteve Komunale si dhe Zyret e Vendit
- Mbikqyrja e pastrimit të Objekteve Komunale
- Furnizimi me material shpenzues per kerkesa te te gjitha drejtorive
- Kontrollimi dhe mirembajtja e nxemjeve qendrore si dhe furnizimi me derivate dhe mirembajtja e gjeneratoreve
- Mirembajtja e veturave, servisimi dhe furnizimi me derivate
- Kontrollimi i sigurimit fizik të objekteve gjatë orarit te punes dhe jasht orarit të punes.
- Realizimi i punëve të tjera sipas nevojës dhe kërkesave nga Drejtori

SEKTORI - MJETEVE THEMELORE (PASURISË KOMUNALE)

Nr	Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës duhet të behën sipas planit të prokurimit, bazuar ne buxhetin e parapare për investime kapitale për vitin 2025
1	Shpenzimet Komunale
	Përcjellja, pagesa si dhe raportimi lidhur me të gjitha shpenzimet që bëhen në objektet komunale (rrymë, ujë, tel. fixe, tel. mobile, mbeturina, shpenzimet. postare etj.)
2	e-Pasuria, Sistemi i Menaxhimit te Pasurisë Komunale
	-Regjistrimi i pasurisë jo kapitale (aseteve) hyrje - dalje për secilën drejtori (ngarkim-shkarkim). -Regjistrimin e materialit shpenzues (hyrje - dalje)për të gjitha drejtoritë komunale.
3	Përcjellja dhe evidentimi I shpenzimeve të OJQ-ve dhe org.tjera të cilat janë në kuadër të objekteve komunale.
4	Evidentimi i shpenzimeve komunale ne data bazën e shpenzimeve
5	Kryen edhe punë tjera të kësaj natyre sipas nevojës dhe kërkesë së Drejtorit, të cilit I përgjigjet për punën e vetë.

Zyra për Barazinë Gjinore në Komunën e Pejës, me punën e saj për vitin 2025, angazhohet për promovimin dhe avancimin e barazisë gjinore si një prej prioriteteve kyçe të komunës, duke siguruar përfshirjen e grave dhe burrave në vendimmarrje dhe aktivitete të tjera publike. Ky plan synon rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet gjinore dhe zbatimin e politikave për krijimin e një mjedisi të drejtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët.

Objektivat Kryesore për Vitin 2025:

1. Rritja e Ndërgjegjësimit Publik:

Organizimi i fushatave sensibilizuese mbi rëndësinë e barazisë gjinore në nivel lokal.

Publikimi i materialeve edukative për fuqizimin e grave dhe rolin e tyre në shoqëri.

2. Pjesëmarrja Aktive e Grave në Vendimmarrje:

Sigurimi që gratë të përfaqësohen në mënyrë të barabartë në këshillat komunale dhe komisionet vendore.

Trajnime për fuqizimin e grave në lidhshmëri dhe drejtim.

3. Zhvillimi i Politikave dhe Rregulloreve për Barazi Gjinore:

Hartimi dhe miratimi i strategjive të reja për zbatimin e barazisë gjinore në të gjitha fushat e administratës komunale.

Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të planit të barazisë gjinore në nivel komunal.

4. Fuqizimi Ekonomik i Grave:

Mbështetja e grave sipërmarrëse përmes trajnimeve dhe granteve.

Organizimi i panairëve dhe aktiviteteve për promovimin e produkteve të grave sipërmarrëse.

5. Arsimimi dhe Trajnimet:

Organizimi i trajnimeve për stafin komunal mbi çështjet e barazisë gjinore.

Edukimi i nxënësve të shkollave mbi rëndësinë e barazisë gjinore dhe parandalimin e diskriminimit.

6. Përfshirja e Burrave në Promovimin e Barazisë Gjinore:

Organizimi i aktiviteteve për të inkurajuar burrat të mbështesin barazinë gjinore.

Ndërtimi i një rrjeti mbështetës për përfshirjen e burrave në kauzat gjinore.

Detyrat dhe Aktivitetet:

Monitorimi i Situatës Gjinore: Mbledhja dhe analiza e të dhënave mbi barazinë gjinore në nivel lokal.

Pjesëmarrja në Platforma Kombëtare: Pjesëmarrja në takime dhe forume kombëtare për shkëmbim përvojash dhe praktika të mira.

Organizimi i Eventeve: Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Grave dhe aktivitete të tjera sensibilizuese.

Bashkëpunimi me Organizatat Joqeveritare: Puna e përbashkët me organizatat që promovojnë barazinë gjinore.

SEKTORI – MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE RI INTEGRIM

1	Ekipi Komunal për te drejta të fëmijëve
1.1	Realizimi dhe Monitorimi i planit të veprimit të Ekipit Komunal për te drejta të fëmijëve dhe rishikim zbatimit të planit në baza vjetore bazuar në vetëvlerësimin komunal
2	Asambleja Komunale e fëmijëve
2.1	Organizim i takimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme
2.2	Monitorimi në zbatimin e procedurave të konsultimit me fëmijë
2.3	Bashkëpunim dhe takime me Këshillit të prindërve në nivel Komunal
2.4	Planifikim dhe përgatitje e planit të punës me AKF
2.5	Planifikim i buxhetit me AKF
3	Shënimin e ditëve ndërkombëtare për drejtat e fëmijëve
3.1	Do të organizohen 9 aktivitete të ndryshme për shënimin e ditëve ndërkombëtare për sensibilizim, promovim dhe respektim të drejtave të fëmijëve
4.	Zbatimi i programeve të vetëdijesimit dhe avokimit për mirëqenien e fëmijëve
4.1	Ngritja e kapaciteteve të politikë bërësve dhe zyrtarëve komunalë për aspekte të drejtave të fëmijëve
4.2	Ofrohen trajnimet për politikë bërësit dhe zyrtarët komunalë në fushën e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës nga ZBGJ
5	Organizimi i fushatave vetëdijesuese për të rriturit dhe për fëmijët
5.1	Planifikohen të organizohen fushata vetëdijesuese dhe shpërndahet material promovues për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtat e tyre nga DKA
6	Sigurimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset vendimmarrëse për çështjet që lidhen me jetën e tyre
6.1	Përcaktimi dhe zbatimi i procedurave të konsultimit me fëmijët me rastin e vendimmarrjes
6.2	Hartohet një udhëzues praktik për procedurat e konsultimit me fëmijë që në fazat e hershme të proceseve vendimmarrëse nga DKA dhe ZMFR
7	Fuqizimi i organeve përfaqësuese të fëmijëve
7.1	Nxitet funksionimi i rregullt i organeve përfaqësuese të nxënësve në të gjitha nivelet
8	Vlerësimi dhe raportimi
8.1	Bëhet vlerësimi periodik (çdo 6 muaj) i zbatimit të planit të punës dhe hartohet raporti
8.2	Bëhet vlerësimi përfundimtar i zbatimit të planit të punës EMF dhe hartohet raporti përfundimtar

Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë

Nita Panduri Mullarama

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT- PEJË		
Plani Vjetor i Punës për vitin 2025		
Nr	Aktivitetet e planifikuara	Periodha e realizimit
	Spektori i Arsimit	
	Niveli parashkollor dhe parafillor	muaji
1	Analizë e realizimit të Planit dhe programit të punës për vitin 2024	<i>I</i>
2	Pilotimi i projektit të MASHTI-it për Kujdesin dhe Zhvillimin në Fëmijërinë e Hershme dhe trajnimet e edukatoreve për zbatim të projektit	<i>I-XII</i>
3	Monitorimi i punës së Qendrave me bazë në komunitet në bashkëpunim me OJQ” Save the children” për KZHFH në Shfmu ”Lidhja e Pejës”, ”Sami Frashëri”, “Rilindja”, Migjeni” dhe “28 Nëntori”	<i>I-VI dhe IX-XII</i>
4	Bashkëpunimi me Ekipin Vlerësues për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me NEV-të moshës 3-6 vjeç	<i>I-XII</i>
5	Mbikëqyrje profesionale, pedagogjike për ngritjen e cilësisë së punës në ed.parashkollor	<i>I,II,III,IV,V,X,XI,XII</i>
6	Mbikëqyrje e regjistrimit të fëmijëve në kl.parafillore (në shkolla)	<i>V-VIII</i>
7	Vizitë informative lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor	<i>VIII</i>
8	Aktivitete kulturore-artistike në kopshtin "Pëllumbat e Paqes"	<i>III,VI,IX,XII</i>
9	Analizë e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parafillor sipas moshës,gjinisë dhe etnisë-nga sistemi SMIA	<i>IX,X</i>
10	Raportimet tek koordinatori për Performancë në SMPK në kuadër të Drejtorisë së Arsimit	<i>V</i>
11	Përgatitjet për fillimin e punës së Qerdheve të reja /kërkesat për inventarizim dhe sistemim të kuadrit të rekrutuar	<i>I, II</i>
12	Trajnime për Zbatim të Kurrikulës së AP	<i>IV</i>
13	Pjesëmarrje në trajnime të organizuara nga MASHTI për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme	
	Arsimi Fillor,i Mesëm i Ulët dhe i Mesëm i Lartë (Niveli 1,2,3)	Muaji

14	Planifikimi vjetor i punës për vitin 2025 (sipas niveleve)	I
15	Përpunimi Statistikor i suksesit të nxënësve për gjys.vjet.e parë(2024/2025)	I
16	Grumbullimi i raporteve të punës gjashtëmujore të drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave .	I dhe VII
17	Shqyrtimin e raporteve nga shkollat për fillimin e gjysëmvetorit të dytë	I
18	Analizë profesionale e braktisjes së nxënësve (2024/2025)	I
19	Analiza e kërkesave të shkollave për plotësimin e vendeve të lira me kuadër arsimor	I -II
20	Vlerësimi i performances së drejtorëve të shkollave , të cilët janë në përfundim të mandatit (vlerësimi i performances së katër drejtorëve)	II-IV
21	Analiza e nevojave dhe shqyrtimi i kërkesve të shkollave për furnizim me dru për vitin shkollor 2025/2026	II-III
22	Vizita pune në shkolla me karakter të përgjithshëm,informativ dhe mbikëqyrës (niveli 1,2,3)	I-XII
23	Evidentimi i nxënësve të kl. të IX-ta për Testin e Arritshmërisë 2025 dhe caktimi i qendrave të testimit	II
24	Implementimi i projektit KosEd-Vlerësimi i performances ë shkollës i udhëhequr nga kolegët, pilotim në gjashtë Shfmu	II
25	Vizita dhe shërbime shëndetësore për nxënësit e klasave të II-të,V-të dhe IX-të ,të 4 Shfmu:”Xhemajl Kada”,”Asdreni”,”Lidhja e Prizrenit” dhe ”7 Shtatori”-Bashkëpunim i Drejtorisë së Shëndetësisë, DKA-së dhe Drejtorisë Mirëqenies Sociale	II-IV
26	Grumbullimi i të dhënave nga Fusha e Arsimit për Vlerësimin e Performances së Komunës në SMPK	V-VI
27	Mbledhje me drejtor shkollash	I-VI dhe IX-XII
28	Organizimi i takimit me mësimdhënësit e pensionuar për nderë të 7 Marsit-Ditës së Mësuesit	III
29	Përzgjedhja nga DKA e mësuesit të vitit dhe nominimi për çmimin “Shaban Jashari”	III
30	Organizimi i testit nderkombetar PISA-2025 me nxënës 15 vjeçar	IV-V
31	Planifikimi dhe monitorimi i regjistrimit të nxënësve në kl.e parë (2025/2026)	V dhe IX
32	Caktimi i qendrave të testimit dhe administruesve të Testit Kombëtar të Maturës 2025	V-VI
33	Planifikimi i regjistrimit të nxënësve në kl.e X-të (AML)për vitin shkollor 2025/2026	V-VI
34	Mbajtja e Testit të Arritshmërisë 2025	VI
35	Aktivitete për Ditën e Planetit	V

36	Zbatimi i politikave të reja nga MASHTI per vitin 2025	I-XII
37	Monitorimi dhe analiza e regjistrimit të nxënësve në kl.e parë	V
38	Publikimi i rezultateve,shqyrtimi i ankesave dhe analiza e rezultateve të Testit të Arritshmërisë 2025	VI,VII
39	Rishikim i funksionimit të paraleleve të ndara (sipas prioritetit të vlerësuar nga MASHTI)	V-VII
40	Planifikimi i të dhënave (profileve) për konkursin e regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të (shpallja e konkursit nga MASHTI)	VI-VIII
41	Organizimi i manifestimeve konform datave të shënuara si:"Java e dyerve të hapura", "Dita Nderkombëtare e Fëmijëve", "Dita Botërore e Mjedisit", "Festa e Abetares"etj	V,VI
42	Aplikimi në e-Kosova për mbajtjen e Testit të Maturës Shtetërore 2025 (afati i Qershorit)	VI
43	Caktimi i Qendrave të testimit dhe shpërndarja e materialit udhëzues per testin e Maturës 2025	VI
44	Regjistrimi i nxënësve në kl. e X-të për vitin shkollor 2025/2026	VII
45	Mbajtja e Testit Kombëtarë të Maturës 2025	VI
46	Publikimi i rezultateve të Testit Kombëtarë të Maturës 2025	VI-VII
47	Shqyrtimi i ankesave të nxënësve pas rezultateve të Testit Kombëtarë	VI-VII
48	Analizë profesionale e suksesit të gjys.vjet.dytë	VII
49	Përpunimi i listave të shkollave për tekstet shkollore për vitin shkollor 2025/2026	V,VI
50	Përgatitja për mbajtjen e testit të Maturës Shtetërore 2025 (afati i gushtit)	VIII
51	Publikimi i rezultateve,shqyrtimi i ankesave dhe analiza e rezultateve të Testit të Maturës 2025 (afati i gushtit)	IX
52	Furnizimi i shkollave me dokumentacion pedagogjik për v.shk 2025/26	VIII
53	Furnizimi i shkollave me lënd djegëse për v.shk 2025/26	VIII
54	Raporti në MASHTI mbi fillimin e vitit shkollor 2025/2026	IX
55	Vizita monitoruese shkollave fillore të mesme të ulta dhe të larta	I-XII
56	Analizë e funksionimit të Organeve Qeverisëse dhe profesionale në shkolla	XI
	Planifikimi i Aktiveteve nga Zyra e Arsimit Gjithpërfshirës	
57	Pranimi i kërkesave për inicimin e rasteve për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore	I-XII
58	Analiza e raporteve dhe instrumenteve për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore	I-XII
59	Planifikimi i rasteve për vlerësim pedagogjik	I dhe II
60	Vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me NEV arsimore sipas kërkesave nga shkollat	I-VI dhe IX-XII
61	Sjellja e vendimeve dhe rekomandimeve nga Ekipi Pedagogjik	I-VI dhe IX-XII

	për shkollën dhe familjen	
62	Shpërndarja e vendimeve dhe rekomandimeve tek shkolla dhe familja	I-VI dhe IX-XII
63	Monitorimi në shkolla i rasteve të vlerësuara nga zyrtari për gjithëpërfshirje	I-VI dhe IX-XII
64	Raportime të rregullta në MASHTI për numrin e rasteve e të vlerësuara dhe përkrahjen e ofruar	I-VI dhe IX-XII
65	Mbledhja e raporteve mujore të punës së psikologeve dhe asistentëve të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore	I-VI dhe IX-XII
66	Takime me psikolog dhe asistent të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore (4 takime në DKA)	I,VI , VIII dhe XI
	Sektori Administratës	
67	Evidentimi i mësimdhënësve të cilët kanë arritur moshën 65 vjeçare (lëshimi i vërtetimeve për vitet 90/99 si dhe vendimet e pensionimit)	I-XII
68	Pranimi i kërkesave të paraqitura nga personeli i shkollave si dhe nga palët tjera të interesit	I-XII
69	Shqyrtimi dhe përgjigjet në kërkesat dhe ankesa te palëve	I-XII
70	Shpallja e konkurseve për kuadër arsimor sipas kërkesave të drejtorëve të shkollave	I-XII
71	Shpallja e konkurseve për pozitën e drejtorëve dhe zv.drejtorëve të shkollave	I-III
72	Përgatitja e kontratave të punës për stafin arsimor dhe kontrollimi i dosjeve	I-XII
73	Shpallja e konkurseve për regjistrim të nxënësve të kl. X-ta viti shkollor 2025/26	VII-VIII
74	Shpallja e konkursit për ekskursion-maturantët	VIII
75	Shqyrtimi i ankesave pas njoftimit të rezultateve	VIII
76	Shqyrtimi i disa kërkesave për dokumentacion nga Auditorët e Jashtëm.	I_XII
	Planifikimi I aktiviteteve nga zyrtari për Teknologji Informative	
77	Hartimi i një plani për zëvendësimin e pajisjeve të vjetra dhe përmirësimi i Infrastruktues Teknologjike	I-II
78	Modernizimi i kompjuterëve të vjetër ,siguria dhe mirëmbajtja	I-XII
79	Backup i rregullt i të dhënave të shkollave	I-XII
80	Instalimi i softuerëve antivirus dhe siguria kibernetike	I-XII
81	Rregullimi i kamerave te demtuara dhe shtimi i tyre ne rast kerkesave	I-XII
82	Auditimi i plotë i gjendjes së kompjuterëve dhe rrjetit.	I-XII
83	Rrjetëzimi i shkollave dhe furnizimi me pajisje shtesë për internet	I-XII

84	Bashkëpunim me kompani të TI-së për donacione ose blerje me çmim të reduktuar..	I-XII
85	Vizita të rregullta në shkolla për të monitoruar gjendjen e teknologjisë	I-XII
	Investimet e parapara për vitin 2025	
86	Ndërtimi i palestrës së sportit në fshatin Treboviq	100,000.00
87	Ndërtimi i sallës së sporteve në Glllogjan	200,000.00
88	Rindertimi i shkollave dhe anekseve ne Nabergjan , Llozhan, Trestenik , Lidhja e Prizrenit , Ramiz Sadiku,Qyshk , Zahaq, dhe rrethoja ne Hil Mosi Jabllanice	200,000.00
89	Ndërtimi i Gjimnazit	804,966.53



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
RAPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE HIDROEKONOMISË



PLANI I PUNËS 2025

DBPH

Plani i Punës për vitin 2025

Objektivat kryesore të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi

1. Krijimi i kushteve për rritjen e kapaciteteve prodhuese, menaxhim të qëndrueshëm të resurseve natyrore (tokën, pyjet, kullosat dhe ujin), modernizimi i bujqësisë, tërheqja e investimeve për të krijuar një mjedis favorizues për rritjen e mirëqenies së qytetarëve në viset rurale të Komunës së Pejës.

2. Zbatimi i projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetës dhe punës përmes:

- a) Investimeve kapitale (penda dhe kanale të ujitjes)
- b) Ofrimi i shërbimeve këshillimore (ngritja e kapaciteteve të fermerëve në menaxhimin e fermave dhe aplikimin e teknologjive të avancuara në prodhimtarinë bujqësore)
- c) Mbështetje për sektorin e blegtorisë, bletarisë, perimkulturës, pemëtarisë, pemëve të imëta dhe bimëve mjekuese
- d) Hulimtimi i burimeve financiare për grante dhe subvencione në sektorin e bujqësisë
- e) Mbështetje për iniciativa e reja të fermerëve në prodhimtarinë bujqësore (ngritjen e cilësisë dhe sasisë të prodhimeve bujqësore)

3. Bashkëpunimi me institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare, vendore dhe ndërkombëtare, bizneset lokale dhe të jashtme, drejt realizimit të projekteve zhvillimore komunale për një ambient më të mirë të zhvillimit ekonomiko-bujqësore.

OBJEKTIVAT E DBPH PËR VITIN 2025	AKTIVITETET PËR ARRITJEN E KËTYRE OBJEKTIVAVE	AFATI KOHOR	REZULTATET E PRITURA
1.Mbështetja financiare e kërkesave të fermerëve	Shqyrtimi i të gjitha kërkesave në afate kohore dhe subvencionimi financiar në bazë të planifikimit buxhetor,sipas llojit të kërkesës	Varësisht nga kërkesat	Përmirësim i gjendjes ekonomike tek ekonomitë familjare të fermerëve,kompenzim i dëmeve të shkaktuara etj.
2.Subvencionet nga Drejtoria e Bujqësisë	2.1 Shpallja e Thirrjes Publike për “Furnizim me mekanizëm bujqësor për fermerët e Komunës sonë”,në bazë të Rregullores Komunale për Ndarjen e Subvencioneve 01/2017.	Janar-Mars	Lehtësimi kushteve të punës dhe ngritja e kapaciteteve prodhuese tek fermerët.
3.Bashkëpunimet me donatorë	Ndarja e mjeteve buxhetore nga kodi i subvencioneve, sipas planifikimit buxhetor 2024-2025për bashkëfinancim të projektit me Organizaten Islamic Relief Kosova.	Shtator 2024-Prill 2025	Avancim i bashkëpunimit që sjell rritje të përfitimeve financiare dhe asetëve fizike për fermerët.
4.Aktivitetet e Drejtorisë për Bujqësi	4.1 Mbajtja e sesioneve informuese me fermerë rreth aplikimit për subvencione dhe grante për vitin 2025 4.2 Pranimi i aplikacioneve të fermerëve për Pagesa Direkte nga MBPZHR 4.3 Përgaditja e planit për mbjellje pranverore dhe vjeshtore si dhe përcjellja e afatit të korrje-shirjeve 4.4 Vlerësimi i dëmeve të mundshme në bujqësi nga fatkeqësit e ndryshme natyrore 4.5 Monitorimi i investimeve kapitale	4.1 Janar-Qershor 4.2 Varësisht nga afati i shpalljes nga AZHB 4.3 Qershor-Dhjetor 4.4 Sipas kërkesave 4.5 Mars-Nëntor	4.1Rritja e numrit të përfituesve të subvencioneve 4.2 Përfitojnë të ardhura financiare më shumë se 2000 fermerë. 4.3 Rritja e sipërfaqeve të kultivuara ,minimizimi i humbjeve nga përdorimi i inputeve të duhura dhe përdorimi i makinerisë së avancuar për korrje 4.4 Kompenzim i dëmeve të shkaktuara me qëllim të zvogëlimit të humbjeve tek fermerët 4.5 Zbatimi i kontratave dhe përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes

5. Investimet kapitale	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në këto fshatra: Baran I Ulët, Baran I Epërm, Çallapek, Kosuriq, Penda e Vranocit dhe Broliq - LOT 1 Loxhë, Vragoc, Dobërdol, dhe Graboc - LOT 2 Pavlan, Gllaviqicë, Ramun, Leshan dhe Kliqinë - LOT 3 Trestenik, Nabërgjan, Llabjan, Dardania III, Ruhot dhe Nakëll- LOT 4 Ozdrim, Dubovë, fshatrat e Podgurit dhe ndërtimi I mureve të pendës së Vragocit- LOT 5	Shkurt-Shtator	Rritja e sipërfaqeve të tokave bujqësore në ujitje, rritja e rendimenteve të prodhimeve bujqësore etj.
6. Subvencionet e MBPZHR	6.1 Afati i aplikimit për TM2 të vitit 2024 6.2 Afati i aplikimit për Pagesa Direkte 2025 6.3. Afati i aplikimit për pleh dhe sasi të dorëzuar të grurit	Varësisht nga afati i shpalljes nga AZHB	Përkrahja e financiare e me shumë se 2000 fermerëve
7. Aktivitetet e Qendrës Informuese Këshillimore (QIK)	7.1 Kontakte e vizita në ferma dhe kultivuesit e kulturave të ndryshme bujqësore 7.2 Trajnim për këshilltar 7.3 Demonstrime në fushë 7.4 Informacione të përgjithshme për zonën, burime njerëzore, klimatik-tokësore, struktura, potencialet prodhuese etj.	Vazhdimisht	Fermerët do të kenë informata dhe këshilla të nevojshme në kohë të duhur, qoftë duke u informuar direkt në fermë apo edhe në zyret e DBPH.
10. Monitorimi i Vendgjuetive të Përbashkëta në Komunën e Pejës	Vizita të kohëpaskohshme në terren nga menaxheri i kontratës në	Gjatë sezonës së Gjuetisë	Mbrotjtja, shtimi i kafshëve si dhe kultivimi i florës dhe faunës në këto dy Vendgjueti
11. Trajtimi i qenëve endacak dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës	Vazhdimi i hapjes së procedurave të tenderimit për projektin “Trajtimi i qenëve endacak dhe menaxhimi i strehimores”	Varësisht nga marrja e vendimit nga Zyra e Prokurimit dhe OSHP	Zvogëlimin e rrezikut nga qentë endacak në rrugë dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës”

✓





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEĆ

Plani i Punës

2025

DREJTORIA PËR ÇËSHTJE PRONËSORE-JURIDIKE

PLANII PUNËS 2025

- Drejtoria për Çështje Pronësore - Juridike ka planifikuar punët e listuara si më poshtë:

- Zhvillimi i procedurës për identifikimin e uzurpimeve në banesat e Kuqe të cilat gjenden në lagjen FIDANISHTE, Llamella A1-A2 të cilat janë pronë komunale.
- Zhvillimi i procedurës për lirimin e hapësirave publike të uzurpimit dhe rrënimi i uzurpimeve në rrugën Azem Bejta dhe rrugët e tjera të qytetit.
- Zhvillimi i procedurës për lirimin e hapësirave publike të uzurpuara dhe rrënimi i uzurpimeve në rrugën “Lekë Dukagjini” për krijimin e shtegut të ecjes buzë lumit “Lumbardh” dhe lirit të rrugës kryesore në drejtim të Rugovës.
- Verifikimi i statusit të banesave të objektit të ashtuquajtur Llausha, në rrugën “Bill Klinton” dhe lirimi i banesave në atë ndërtesë, pasi që është vërtetuar se palët i keqpërdorin.
- Vazhdimi dhe verifikimi i realizimit të pagesave të qirasë së banesave dhe lokaleve që janë pronë komunale, dhe kioskave.
- Verifikimi i statusit të banesave të ndërtuara, në Krivogllavë dhe te Tregu i Gjelbërt, e që janë pronë Komunale të cilave ju kemi bërë kontrata mbi shfrytëzimin si raste sociale e që menaxhohen nga Komuna.
- Vazhdimi i lëshimit të Lejeve për Pano dhe Reklama, si dhe lëshimin e Vendimeve për shfrytëzimin e tyre në afat 1 Vjeçar sipas rregullores mbi taksa tarifa dhe gjoba, dhe largimi i atyre reklamave të cilat nuk kanë leje për shfrytëzim.
- Vazhdimi i procedimit të lëndëve të bartura nga viti paraparak 2024.
- Inicimi i kërkesave që kanë të bëjnë me ndarjen e trojeve, bashkangjitje trollit amë, regjistrime të pronësisë sipas vendimeve të kuvendit komunal.

- Procedimi i kërkesave për këmbimin e pronës Private me Pronën Komunale për realizimin e planeve rregulluese për qytetin e Pejës.
Data: 25.12.2024

Arianit.demaj@rks-gov.net

zip-peje@hotmail.com

<http://kk.rks-gov.net/peje>

Për: Kryetarin e Komunës – Ing.Gazmend Muhaxheri

CC: Shefin e Kabinetit – Kastriot Belegu

Nga: Njësia e Informimit Publik në Pejë

Lënda: PLANI I PUNËS PER VITIN - 2025

Njësia e Informimit Publik e Komunës së Pejës, më punën e vet më mediat dhe më opinionin publik angazhohet që të siguroi transparencën dhe kështu ta njoftoi opinionin më punën, efikasitetin dhe angazhimet e pushtetit lokal, që do të thotë inkurajimin e qytetarëve në vendimmarrje.

Njësia e Informimit Publik, e cila si angazhim primar ka përcjelljen e punës dhe të aktiviteteve të Zyrës së Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal (legjislativ) përkatësisht Këshillit të Drejtorëve dhe organeve të tyre gjatë këtij viti, synon të konsolidohet në mënyrë që të kryejë më sukses funksionin e vetë si një zyrë efikase. Në këtë frymë do të përpiqemi që të japim kontributin tonë në afirmimin dhe prezantimin e vendimeve të Kryetarit të Komunës, të Asamblesë dhe të Shërbimit Civil Komunal dhe zbatimin e tyre në favor të mirëqenës të të gjithë qytetarëve.

Kjo zyrë, gjatë vitit vijues pos punëve të zakonshme (rutinore) vazhdimisht do të jetë në azhurnim të Web-faqes dhe do të begatoi të dhënat më karakteristike për Komunën e Pejës, siç janë: Zyra e Kryetarit, Kuvendi dhe organet e tij, të dhënat e drejtorive, rregulloret, vendimet, Procesverbalet, njoftimet për kontrata dhe për dhënie të kontratës, Planet vjetore të Prokurimit, konkurset, raportet vjetore, raportet financiare dhe të gjitha materialet e nevojshme në mënyrë që të sigurojmë transparencën e duhur të Qeverisë komunale, Kuvendit Komunal dhe organeve të tij.

- Kjo Zyrë gjatë vitit vijues do të duhej të jetë e njoftuar me agjendat ditore, të jetë prezentë në takime për të qenë në rrjedha të ngjarjeve dhe aktiviteteve ditore në Komunë, në fushën e informimit publik që është parakusht për informim më kohë e korrekt.

- Do të insistojmë më një bashkëpunim më të afërt më Drejtorët e drejtorive dhe organet tjera të Komunës.
- Do t'i përcjellim dhe do të njoftojmë për mbledhjet dhe aktivitetet e Kryetarit, Asamblesë Komunale, Komiteteve, Këshillit të Drejtorëve, Komisioneve të Kuvendit etj.
- Do të njoftojmë më kohë opinionin nëpërmjet shpalljeve publike, web-faqes zyrtare, rrjeteve sociale, komunikatave e njoftimeve për media, për festat shtetërore, fetare, takimet publike, dëgjimet buxhetore etj.
- Do të mbajmë kontakte të rregullta dhe kolegjiale më përfaqësuesit e mediave lokale, kombëtare e ndërkombëtare që veprojnë në Pejë e në vend.
- Do të organizojmë konferenca shtypi në bashkëpunim me Zëdhënësin dhe kabinetin e Kryetarit, sipas vlerësimit të organeve drejtuese të Komunës.
- Do të vazhdojnë kontaktet dhe bashkëpunimin më Zyrat e Informimit Publik të Komunave të rajonit e të vendit.
- Do të publikojmë informatat lidhur më aktivitetet e Komunës për realizimin e Përformancës, Transparencës, llogaridhënies të planeve të veprimit për Integritet etj.
- Sipas nevojës dhe kërkesës së Kryetarit do të nxjerrim fletushka informuese të cilat do të shpërndajmë nëpër Bashkësi Territoriale.
- Edhe vitin 2025 është në pikëpyetje publikimi i dokumenteve në Platformën e Konsultimeve Publike nga Zyra e Kryeministrit, sepse nuk është caktuar Zyrtari përgjegjës për Konsultime Publike.
- Do të marrim pjesë në takime profesionale dhe trajnuese për mediat dhe Informimin Publik të organizuara nga ekspert vendor e ndërkombëtar dhe angazhime në punë të tjera që dalin më kohë të nevojshme e të arsyeshme.

Njësia e Informimit Publik i raporton Kryetarit të Komunës dhe do të bashkëpunojë ngushtë me kabinetin e Kryetarit, më Drejtorit Komunale si dhe me njësitë dhe zyrat komunale sipas nevojave dhe mundësive.

Njësia e Informimit Publik gjatë vitit 2025 do ta ketë një staf të rregullt prej tre vetave:

Arianit Demaj – Udhëheqës i Njesisë së Informimit Publik

Ariana Lukaj - Zyrtare për Informim dhe Komunikim me media

Granit Thaqi - web-master, fotograf dhe menaxhues i rrjeteve sociale

Njësia e Informimit Publik
Arianit Demaj-Udhëheqës i zyrës
Email: Arianit.demaj@rks-gov.net
Tel zyre: 0383 200 43 407
Tel mob: 044 125 089



PLANË PROGRAMI I PUNES - PLAN RADA
DETYRAT DHE OBLIGIMET TË PUNËS PËR VITIN 2025 - ZADACI I OBAVEZE ZA 2025 GODINU
ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM-OPŠTINSKA KANCELARIJA ZA ZAJEDNICE I POVRATAK

Nr Br	Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës Opis poslova i zadataka	Njësia matëse Jedinicamj ere	Planifikimi për 2025 Planirano za 2025	PERIUDHA KOHORE E REALIZIMIT												Verejtje Napomena
				Janar Januar	Shkurt Februar	Mars Mart	Prill April	Maj Maj	Qershor Jun	Korrik Jul	Gusht August	Shtator Septembar	Tetor Oktober	Nëntor Novembar	Dhjetor Decembar	
1	Bashkëpunim - Takimet me Ministrin për Komunitete dhe Kthim Saradnja- sastanci sa Minstarstvom za Zajednice i Povratk	Nr.takimeve Br.sastanaka Realizume Realizovano	28	1	3	2	3	2	4	2	0	3	2	3	3	
2	Vizitat ne teren me personat-familjet te kthyera Posjete povratničkih porodica	Nr.vizitave Br.poseta Realizume Ralizovano	29	1	2	2	3	3	3	3	0	3	3	2	4	
3	Bashkëpunim me OJQ qe meren me kthime Saradnja sa NVO koje se bave povratkom	Nr.takimeve Br. sastanaka Realizume Realizovano	20	1	2	2	1	2	1	2	0	2	3	2	2	
4	Pjesmarja në mledhje Komisioni Komunal për Kthim Ucesce u Opstinskoj Komisiji za Povratk	Nr.takimeve Br.sastanaka Realizume Realizovano	11	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1	
5	Bashkëpunim - Takimet më Ministrin Puneve te Brendshme Saradnja-Sastanci sa Ministarstvom Unutrašnjih Poslova	Nr.takimeve Br.poseta Realizume Realizovano	29	2	2	3	3	2	3	3	0	3	2	3	3	
6	Vizitat ne teren me personat-familjet te riadhesuara Posjete repatriranih porodica	Nr.vizitave Br.poseta Realizume Realizovano	29	2	3	2	3	3	3	3	0	2	2	3	3	
7	Bashkëpunim me OJQ qe meren me riintegrimin e personave të riadthesuar Saradnja sa NVO koje se bave reintegarcijom repatriranih osoba	Nr.takimeve Br.sastanaka Realizume Realizovano	25	1	2	3	3	2	3	2	0	3	2	2	2	

8	Pjesmarja në mledhje Komisioni Komunal për Riintegrim	Nr.takimeve Br.sastanaka	11	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1
	Ucesce na Opstinskoj Komisiji za Reintegraciju	Realizume Realizovano													
9	Bashkëpunim me Zyren e Punesimit për projektet e personave të riadthesuar	Nr.takimeve Br.sastanaka	11	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1
	Saradnja sa Zavodom za zapošljavanje na projektima repatriranih lica	Realizume Realizovano													
10	Takime me perfaqetsuesit e bashkësive lokale	Nr.takimeve Br.sastanaka	11	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1
	Sastanci sa predstavnicima lokalnih zajednica	Realizume Realizovano													
11	Vizita ne teren për të gjitha komunitetet për të marrë informacion për problemet dhe nevojat e tyre.	Nr.vizitave Br.poseta	29	2	3	3	2	3	2	3	1	3	3	2	2
	Terenske posjete svim zajednicama kako bi se dobile informacije o njihovim problemima i potrebama.	Realizume Realizovano													
12	Bashkëpunim me Ministrit të ndryshme pran Qeverin Kosovës si dhe me Zyren e Kryeministrit	Nr.takimeve Br.sastanaka	11	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1
	Saradnja sa različitim Ministarstvima pri Vladi Kosova kao i Kancelarijom Premijera	Realizume Realizovano													
13	Pjesëmarja në Komitete të Formura	Nr.takimeve Br.sastanaka	19	2	1	2	1	2	2	2	0	1	2	1	3
	Učešće na formiranim komitetima	Realizume Realizovano													
14	Bashkepunimi me Drejtorit Komunale	Nr.takimeve	27	2	3	2	3	2	3	2	0	2	3	3	2
	Saradnja sa Opštinkim Direktoratima	Realizume Realizovano													
15	Bashkëpunim me Qendren Për Punë Sociale	Nr.takimeve Br.sastanaka	31	2	3	2	3	3	3	3	0	2	3	4	3
	Saradnja sa Centrom za socijalni rad	Realizume Realizovano													
16	Bashkëpunim me Policin e Kosoves, FSK dhe KFOR	Nr.takimeve Br.sastanaka	33	3	3	3	3	3	3	3	0	3	3	3	3
	Saradnja sa Policijom Kosova, KBS i KFOR-om	Realizume Realizovano													
17	Bashkëpunim me ZKKK të Komunave tjera	Nr.takimeve Br.sastanaka	22	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2
	Saradnja sa OKZP drugih opština	Realizume Realizovano													

Shefi I Zyres

Dipl.Ing.Sabahudin Ciriković



PREALIZIMI I LANË PROGRAMIT TË PUNESPËR VITIN 2024
REALIZACIJA PLANA RADA ZA 2024 GODINU

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM-OPŠTINSKA KANCELARIJA ZA ZAJEDNICE I POVRATAK

Nr Br	Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës Opis poslova i zadatoka	Njësia matëse Jedinicamj ere	Planifikimi për 2024 Planirano za 2024	PERIUDHA KOHORE E REALIZIMIT												Verejtje Napomena
				Janar Januar	Shkurt Februar	Mars Mart	Prill April	Maj Maj	Qershor Jun	Korrik Jul	Gusht August	Shtator Septembar	Tetor Oktober	Nëntor Novembar	Dhjetor Decembar	
1	Bashkëpunim - Takimet me Ministrin për Komunitete dhe Kthim Saradnja- sastanci sa Minstarstvom za Zajednice i Povratok	Nr.takimeve Br.sastanaka	26	2	2	3	2	2	3	2	0	3	2	3	2	
		Realizume Realizovano	29	1	3	2	3	2	4	2	1	3	2	3	3	
2	Vizitat ne teren me personat-familjet te kthyera Posjete povratničkih porodica	Nr.vizitave Br.poseta	30	2	3	2	3	3	4	2	0	3	3	3	2	
		Realizume Ralizovano	29	1	2	2	3	3	3	3	1	3	3	2	3	
3	Bashkëpunim me OJQ qe meren me kthime Saradnja sa NVO koje se bave povratkom	Nr.takimeve Br. sastanaka	21	2	2	1	2	2	2	2	0	2	2	2	2	
		Realizume Realizovano	20	1	2	2	1	2	1	2	0	2	3	2	2	
4	Pjesmarja në mledhje Komisioni Komunal për Kthim Ucesce u Opstinskoj Komisiji za Povratok	Nr.takimeve Br.sastanaka	11	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1	
		Realizume Realizovano	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	
5	Bashkëpunim - Takimet me Ministrin Puneve te Brendshme Saradnja-Sastanci sa Ministarstvom Unutrašnjih Poslova	Nr.takimeve Br.poseta	30	2	3	3	3	2	3	2	0	4	2	3	3	
		Realizume Realizovano	29	2	2	3	3	2	3	3	1	3	2	3	2	
6	Vizitat ne teren me personat-familjet te riadhesuara Posjete repatriranih porodica	Nr.vizitave Br.poseta	31	3	3	3	2	3	4	3	0	3	3	2	2	
		Realizume Realizovano	29	2	3	2	3	3	3	2	2	2	3	2	2	
7	Bashkëpunim me OJQ qe meren me riintegrimin e personave të riadthesuar Saradnja sa NVO koje se bave reintegarcijom repatriranih osoba	Nr.takimeve Br.sastanaka	33	2	3	3	3	3	3	3	0	3	3	3	4	
		Realizume Realizovano	25	1	2	3	2	2	3	2	2	3	1	2	2	

8	Pjesmarja në mledhje Komisioni Komunal për Riintegrim	Nr.takimeve Br.sastanaka	11	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1
	Ucesce na Opstinskoj Komisiji za Reintegraciju	Realizume Realizovano	2	0	0	0	0	0	1	0	0	0	2	0	1
9	Bashkëpunim me Zyren e Punesimit për projektet e personave të riadthesuar	Nr.takimeve Br.sastanaka	11	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1
	Saradnja sa Zavodom za zapošljavanje na projektima repatriranih lica	Realizume Realizovano	11	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1
10	Takime me perfaqetsuesit e bashkësive lokale	Nr.takimeve Br.sastanaka	11	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1
	Sastanci sa predstavnicima lokalnih zajednica	Realizume Realizovano	12	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
11	Vizita ne teren për të gjitha komunitetet për të marrë informacion për problemet dhe nevojat e tyre.	Nr.vizitave Br.poseta	27	2	3	2	2	3	2	2	2	3	2	2	2
	Terenske posjete svim zajednicama kako bi se dobile informacije o njihovim problemima i potrebama.	Realizume Realizovano	29	2	3	3	2	3	2	3	1	3	3	2	2
12	Bashkëpunim me Ministrit të ndryshme pran Qeverin Kosovës si dhe me Zyren e Kryeministrit	Nr.takimeve Br.sastanaka	11	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1
	Saradnja sa različitim Ministarstvima pri Vladi Kosova kao i Kancelarijom Premijera	Realizume Realizovano	10	0	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1
13	Pjesëmarja në Komitete të Formura	Nr.takimeve Br.sastanaka	17	2	1	2	1	2	1	2	0	1	2	1	2
	Učešće na formiranim komitetima	Realizume Realizovano	19	2	1	2	1	2	2	2	0	1	1	2	3
14	Bashkëpunimi me Drejtorit Komunale	Nr.takimeve	28	2	3	2	3	2	3	2	0	2	4	3	2
	Saradnja sa Opštinkim Direktoratima	Realizume Realizovano	27	1	2	3	2	3	3	2	0	2	4	2	3
15	Bashkëpunim me Qendren Për Punë Sociale	Nr.takimeve Br.sastanaka	35	2	3	3	4	3	3	3	0	3	3	4	4
	Saradnja sa Centrom za socijalni rad	Realizume Realizovano	28	1	3	2	3	2	3	2	0	3	3	3	3
16	Bashkëpunim me Policin e Kosoves, FSK dhe KFOR	Nr.takimeve Br.sastanaka	33	3	3	3	3	3	3	3	0	3	3	3	3
	Saradnja sa Policijom Kosova, KBS i KFOR-om	Realizume Realizovano	33	3	3	3	3	3	3	3	0	3	3	3	3
17	Bashkëpunim me ZKKK të Komunave tjera	Nr.takimeve Br.sastanaka	22	2	2	2	2	2	2	2	0	2	2	2	2
	Saradnja sa OKZP drugih opština	Realizume Realizovano	5	0	0	1	0	1	0	1	0	1	0	1	0

Shefi I Zyres

Dipl.Ing.Sabahudin Ciriković



Komuna e Pejës
Municipality of Peja
Opština Peć

Raporti i Punës për Vitin 2024

Janar, 2025



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

Data / Date /Datum:	23.12.2024
Për / To / Za:	Zyrës së Kryetarit
Nga / From /Od:	Drejtoria për Administratë
Lënda / Subject / Tema:	Raport i punës 03 Janar - 18 Dhjetor 2024

RAPORT I PUNËS

Në këtë drejtori veprojnë 9 Sektorë:

1. Gjendja Civile
2. Qendra për shërbim të qytetarëve
3. Ligjor
4. Përkthim dhe Lekturim
5. Teknologji Informative
6. Logjistikë
7. Mjete themelore (pasurisë komunale)
8. Barazi Gjinore
9. Mbrojtjen e fëmijëve dhe ri integrim

*Te gjitha lëndët e Drejtorisë për Administratë për periudhën e parashikuar brenda afateve të shqyrtimit janë 0 (zero), të përfunduara me kohë, zgjidhje e tyre në afate rekorde, përgjigje e shpejtë palëve, totali i lëndëve të Komunës janë: **99.897** kurse vetëm nga Drejtoria për Administratë janë: **65.266** apo me përqindje ne nivel të përgjithshëm Komunal, vetëm Drejtoria e Administratës ka **65.33 %** te lëndëve.*

Nga Drejtoria për Administratë janë realizuar këto punë dhe projekte:

- 1. Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative*
- 2. Furnizim me kompjuterë*
- 3. Mirëmbajtja e kamerave të qytetit*
- 4. Furnizim me material Administrativ për nevojat e SHCK-së*
- 5. Furnizim me material elektrik për SHCK*
- 6. Furnizim me artikuj për mirëmbajtjen e objekteve*
- 7. Servisimi (Mirëmbajtja) e automjeteve*
- 8. Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve*
- 9. Furnizim me naftë për nxehje*
- 10. Furnizim me naftë për veturat zyrtare*
- 11. Takime, aktivitete për barazi gjinore*
- 12. Takime dhe aktivitete për fëmijët dhe të drejtat e tyre*

Vendosja e te dhënave sipas raporteve nga Sektorët:

Bazuar në raportet e dërguara nga udhëheqësit e sektorëve në Drejtorinë e Administratës, raporti i punës për periudhën 03 Janar - 18 Dhjetor 2024 është si vijon:

1. SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Ka kryer këto shërbime:

1.Vendime për regjistrim me vonesë ne RTHL	60
2.Vendime për regjistrim me vonesë në RTHV	163
3.Vendime për korrigjime të emrit/mbiemrit	120
4.Vendime për ndërrim të emrit/mbiemrit	153
5.Regjistrime në RTHL-ve	2251
6.Regjistrime në RTHV-ve	827
7.Regjistrime në RTHM-ve	743
8.Lëshuar certifikata të lindjes	23862
9.Lëshuar ekstrakte të lindjes	53021
10.Lëshuar certifikata të kurorëzimeve	12182
11.Lëshuar certifikata të vdekjes	6165
12.Lëshuar certifikata të statusit martesor	2445
13.Lëshuar certifikata të vendbanimit	6174
14.Lëshuar certifikata të shtetësisë	1074
15.Lëshuar deklarata të Bashkësisë Familjare	4751
16.Lëshuar vërtetime nga Arkiva	1605
17.Raporte për lindje statistikës DEM-1	2251
18.Raporte për vdekje statistikës DEM-2	827
19.Raporte për kurora statistikës DEM-3	743
20.Aplikime për tu liruar nga shtetësia e Kosovës	23
21.Aplikime për ta fituar shtetësinë e Kosovës	206
22.Aplikime për te rikthyer shtetësinë e Kosovës	174
Gjithsej shërbime të kryera:	112.674

Janë realizuar taksa nga zyrtaret dhe e-kiosku:

163.554,00 Euro.

Vërejtje: Në raport janë të përfshira shërbimet nga data 03.01 deri me datë 18.12.2024.

2. QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE

- Qendra për Shërbim me Qytetar gjatë periudhës kohore janar/dhjetor '2024 ka ndërmarr një serë aktivitete të ndryshme në kuadër të Drejtorisë për Administratë si dhe me Institucionet tjera relevante që ndërlihen me këtë sektor.
- Vizioni i QSHQ-ës për të ardhmen është që të përqendrohem në avancimin dhe ngritjen e kapaciteteve sa me cilësore rreth ofrimit të shërbimeve me qytetarë.
- Qendra për Shërbim me Qytetar gjatë periudhës kohore janar/dhjetor '2024 ka pranuar kërkesa, ankesa dhe dokumente të tjera të parashtruara dhe të destinuara në Drejtori të ndryshme sipas tabelës së më poshtme:

Kjo qendër se bashku me Gjendjen Civile kanë pranuar gjithsej 99.897 kërkesa, ankesa dhe dokumente të tjera të parashtruara dhe të destinuara në drejtori të ndryshme sipas tabelës së më poshtme:

Raporti sipas departamenteve dhe statusit te zgjidhjes

03/01/2024 - 18/12/2024

Përshkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshtë	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Përfunduar	Totali
Drejtoria për Administratë	9	24	8,880	99	9	1	0	29	56,215	65,266
Drejtoria për Arsimit	3	85	2,771	26	1	7	0	204	0	3,097
Kuvendi Komunal	0	9	53	1	0	0	0	1	0	64
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	60	289	2,725	55	0	0	0	7	0	3,136
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	0	9	179	43	0	1	0	0	0	232
Drejtoria për Mirëqenie Sociale	0	52	0	0	0	1	0	0	0	53
Drejtoria për Shëndetësi	8	9	343	157	12	0	0	8	0	537
Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	2	146	1,049	147	7	209	1	19	0	1,580
Kryetari i Komunës	4	21	1,571	21	0	201	7	24	0	1,849
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	1	15	220	46	0	0	0	1	0	283
Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi	42	3,435	16,049	0	0	0	0	121	0	19,647
Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike	0	53	539	226	1	0	1	2	0	822
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	0	114	10	0	0	0	0	0	0	124
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi	0	7	560	762	3	5	1	4	0	1,342
Drejtoria për Punë Inspektuese	0	361	323	5	1	2	1	2	0	695
Drejtoria për çështje Pronësoro-Juridike	1	115	888	19	1	15	0	13	0	1,052
Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Prokurimi	0	117	0	0	0	0	0	0	0	117
	130	4,861	36,161	1,607	35	442	11	435	56,215	99,897

Në Qendrën për Shërbim të qytetarëve kanë kaluar lëndë nga te gjitha Drejtoritë, lëndët nga Drejtoria për Administratë janë aprovuar nga zyrtarët e Drejtorisë për Administratë.

Qendra për Shërbim Qytetarëve - Arkiva

Njësia e Arkivës në periudhën kohore i ka kryer të gjitha detyrat e punës të cilat janë në përgjegjësi dhe fushëveprim i kësaj zyre. Zyra e Arkivit e Komunës së Pejës ka kryer punët duke u përkujdesur në zbatimin e ligjeve të aprovuara dhe harmonizimi i akteve të ndryshme me Ligjin Nr04/L-088 për Arkivat Shtetërore ,Ligjit Nr.04/L- 184 për Administrimin e Punës në Zyre dhe të Rregullores MAP Nr. 01\2015 për shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve dhe afateve e ruajtjes së tyre. Gjatë këtij viti jemi munduar për ti arritur këto objektiva të cilat edhe i përcakton vendi i punës,

- Janë pranuar dokumentet dhe lëndët për arkivim dhe jemi kujdesur për arkivimin e tyre në përputhje me procedurat ligjore.
- Sistemimi dhe mirëmbajtja e lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit.
- Mirëmbajtje e arkivit te veçantë për rastet e detajuara specifike dhe ruajtja e paprekshmërisë së informatave.
- Seleksionimi i rregullt i lëndëve arkivore.
- Mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me institucionet e arkivit të Kosovës, me qëllim të dorëzimit të lëndëve arkivore arkivit kompetent pas kalimit të afatit.
- Ndërmarrje e veprime tjera të nevojshme për funksionimin sa më të mirë të ligjit mbi lëndën arkivore të Kosovës;
- Koordinim i punës me nëpunësin që merret me postën për shpërndarjen e postës, shkresave jashtë dhe brenda institucionit;
- Kryerja e çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Është dorëzuar edhe Aneksi me te dhëna të plota, raport i detajuar.

3. ZYRA LIGJORE KOMUNALE

Gjatë periudhës gjashtë (6) mujore konkretisht **03.janar-31 MaJ për vitin 2024**, në zyrën ligjore ka kryer këto aktivitet të cilat po i paraqesim si në vijim:

1. Ofrimi i ndihmës juridike për Komision Disiplinor
2. Bashkëpunim me Udhëheqësin e Personelit është shqyrtuar shkresa/Njoftime të ndryshme
3. Konsulta me Inspektorët lidhur përmbajtjen formale të formularit për shqiptimin e gjobës administrative.
4. Anëtar i Komisioni për Planin e Integritetit.
5. Pjesëmarrje në Komisione për rekrutim të zyrtarëve.
6. Interpretimi i Marrëveshjes për Bartjen e Kompetencave për Themelimin e Inkubatorëve të Biznesit.
7. Pjesëmarrje në punëtori të ndryshme.
8. Harmonizimi i Rregullës së Brendshme për menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në aspektin ligjore dhe tekniko-legjislativ.

Për raport me të detajuar është bashkëngjitur aneksi.

4. PËRKTHIM DHE LEKTURIM

Zyra e përkthimeve ka kryer punën e vet në harmoni me Ligjin për përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Kosovë.

Të gjitha dokumentet që kanë ardhur për përkthim në këtë zyrë janë përkthyer, në afat, me kohë dhe pa ndonjë vonesë (dokumente dhe materiale të ndryshme nga të gjitha drejtoritë dhe zyrët, komitetet dhe organet tjera të komunës).

Prej muajt Janar gjerë në Shtator të vitit 2023, janë **përkthyer gjithsejtë 838 faqe material të ndryshëm, si dhe 30 orë** përkthime të drejtpërdrejta në takime të ndryshme në objektet e Komunës dhe në terren. Më poshtë po japim një pasqyrë të dokumenteve kryesore dhe të vazhdueshme që janë përkthyer:

1. Procesverbalet e Kuvendit të Komunës;
2. Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa;
3. Procesverbalet e Komitetit për komunitete;
4. Procesverbalet e KKSB-së;
5. Procesverbalet e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara,
6. Procesverbalet e Komitetit konsultativ për zhvillim ekonomik,
7. Procesverbalet e Komitetit konsultativ për mbrojtje të mjedisit,
8. Vërtetime të ndryshme;
9. Vendime dhe Aktvendime të ndryshme;
10. Konkurse të ndryshme, konkluzione, njoftime, ftesa;
11. Njoftime të ndryshme, Plane dhe strategji;
12. Projektet të ndryshme.

5. TEKNOLOGJI INFORMATIVE

Janë kryer punë të përditshme, dhe është raportuar çdo ditë pune, numri i kërkesave të realizuara është: **1993** Kërkesa.

Bazuar në kërkesat tjera për menaxhim dhe implementim, me poshtë gjeni të dhënat:

- Planifikim për riparimin e rrjetit, kërkesë drejtuar drejtorisë për vendosje në planin e prokurimit
- Kontribut i dhënë nga sektori për Teknologji Informative rreth përgatitjes për shërbimet e E-Kosova, në pjesën ku përfshihen të dhënat e kërkuara nga Komuna Pejë
- Laura menaxhimi i bazës së të dhënave nga Sektori për TI-ve.
- Zyrtarët nga sektori i TI-ve, Pjesëmarrje në shumë Komisione, takime të ndryshme, punëtori dhe konsulta.
- Kontrata të menaxhuara nga zyrtarët e Sektorit
- Mbështetja e shërbimit të Kuvendit me votim elektronik dhe të tjera.
- Përgatitje e paramasave për punë të ndryshme nga Sektori për Teknologji Informative
- Menaxhimi i bazave të dhënave lokale të krijuara me zero kosto.
- Menaxhimi i bazave të dhënave nga ASHI.
- Menaxhimi i e-kioskut
- Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për Teknologji Informative – Kompjuterëve

Për raport me të detajuar dorëzohet aneksi i veçantë të Drejtoresha e Drejtorisë

6. LOGJISTIKA

- Mirëmbajtja e objekteve komunale
- Mbikëqyrja e pastrimit të objekteve dhe furnizimi me material të pastrimit
- Mirëmbajtja e veturave si dhe servisimi i tyre
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik
- Rregullimin dhe servisimin e gjeneratorit në ndërtesën kryesore pas djegies së instalimit dhe aparaturave elektronike
- Rregullimi i nyjave sanitare në ndërtesën e administratës, kuvendit dhe kadastrës
- Regjistrimin e automjeteve të reja (5 veturave)
- Furnizimi me material shpenzues për të gjitha drejtoritë
- Pranimin e mallit si zyrtarë alternativ për pagesa për të gjitha drejtoritë .
- Furnizimi me material shpenzues për nevojat e të gjitha drejtoratëve.
- Përgatitja e lendeve për pagesë nga Drejtoria e Administratës
- Bartja e inventarit të zyrave ZKK-minoriteteve si dhe zyrat e kabinetit të kryetarit.
- Punët e kryera në urën të sharra, bartja dhe pastrimi i mbeturinave .
- Rregullimi dhe montimi i paneleve ndriçuese në zyre dhe korridore të ndërtesave komunale.

7. ZYRA E MJETEVE THEMELORE (PASURISË KOMUNALE DHE E-PASURIA)

- Pagat e punëtorëve për mirëmbajtje dhe sigurim, NPL EKO SIG
- Bartja e obligimeve të mbetura nga viti paraprak, si dhe kryerja e të gjitha obligimeve të shpenzimeve komunale pas alokimit të buxhetit.
- Kryerja e pagave për “Eko- Sig”, për Shërbimet Teknike dhe Mirëmbajtja si dhe Sigurimi Fizik.
- Shpenzimet e rrymës për periudhën dhjetor’23- nëntor’24
- Shpenzimet e ujit për periudhën dhjetor’23- nëntor’24
- Shpenzimet e telefonisë fikse për periudhën dhjetor’23- nëntor’24
- Shpenzimet e mbeturinave për periudhën dhjetor’23- nëntor’24

Shpenzimet e rrymës me vendim të Kryetarit për:

- Pompat e ujit Vranoc, për periudhën dhjetor’23- nëntor’24
- Radio Peja për periudhën dhjetor’23- nëntor’24
- Gorazhdeci, për periudhën dhjetor’23- nëntor’24
- KK-Access Action Program (zyra e turizmit afër patrikanës) të gjitha shpenzimet komunale (Rryma, uji dhe mbeturinat),
- Telefonia.Mobile -Vala, për periudhën dhjetor’23- nëntor’24
- Shpenzimet postare për periudhën dhjetor’23- nëntor’24
- Pagesat për kyçje të rrymës për Shtëpinë e Fshatit-Dubovë dhe vazhdimi i pagesave të rrymës
- Pagesa e rrymës për Pompat e ujit në lagjen “Asllan Qeshme”, për kyçje.
- Regjistrimi i lendeve në sistem e-Pasuria, (regjistrimi i materialit shpenzues), si dhe realizimi i kërkesave të zyrtareve për furnizim me material shpenzues për të gjitha drejtorit.
- Regjistrimi i aseteve në sistemin e-Pasuria (nxjerrja e barkodeve) ngarkimi dhe transferet sipas kërkesave.
- Evidentimi i shpenzimeve komunale në databazën e shpenzimeve,
- Barazimi i pagesave me kompanitë:”KESCO”,”AMBIENTI” si dhe “HIDRODRINI”
- nxjerrja e barkodeve për drejtorin e Shëndetësisë, dhe Arsimit.

Punë tjera sipas kërkesave.

8. BARAZI GJINORE

Gjatë periudhës raportuese nga korriku deri në dhjetor 2024, prej se ka filluar punën si sektor, sektori për Barazinë Gjinore ka realizuar një sërë aktivitete që pasqyrojnë përkushtimin ndaj përmirësimit të barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës në familje.

- Realizimi i Strategjisë Komunale dhe Planit të Veprimit Lokal ka qenë një arritje e rëndësishme, duke përfshirë pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e institucioneve, OJQ-ve dhe qytetarëve.
- Gjithashtu, trajnime të shumta dhe aktivitete ndërgjegjësimit kanë shërbyer për fuqizimin e kapaciteteve lokale dhe për adresimin e çështjeve kyçe si dhuna me bazë gjinore, qasja në pronë dhe trashëgimi, dhe rëndësia e shëndetit publik për gratë.
- Mbështetja e partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë ka qenë një shtyllë kyçe për realizimin e qëllimeve tona.
- Duke parë rezultatet e deritanishme, Zyra për Barazinë Gjinore do të vazhdojë angazhimin e saj për zbatimin e politikave të barazisë gjinore dhe fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri.
- Synimi ynë për periudhën në vazhdim do të përqendrohet në avancimin e mëtejshëm të iniciativave lokale dhe krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm për mbështetjen e të drejtave të grave dhe vajzave.
- Përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe përkushtimit të gjithë akterëve të përfshirë, ne besojmë se do të kontribuojmë në një shoqëri më të barabartë dhe më të sigurt për të gjithë qytetarët e Komunës së Pejës.

Raport i detajuar gjendet në aneksin e dorëzuar te Drejtoresha e drejtorisë


9. MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE RIINTEGRIM

- Organizim i takimeve bashkëpunimi me drejtori të Komunës dhe institucione parashkollore dhe shkollore, policia e Kosove si dhe OJQ-te ndërkombëtare dhe vendore në Pejë.
- Prezantim i punese së zyrës për MFR (zyra për mbrojtjen e fëmijëve dhe ri integrim) me te gjithë bashkëpunëtoret qe e parasheh ligji nr.06/L084 për mbrojtjen e fëmijëve
- Pjesëmarrje në konferenca, tryeza, trajnime dhe seminare të ndryshme ne muajt nëntor – dhjetor 2024 si:
 - Integrimi gjinor dhe vlerësimi i ndikimit gjinor përkrahur nga UN Women;
 - Tryezën e diskutimit rreth zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës përkrahur nga koalicioni i OJQ–ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF dhe Terre des hommes në Kosovë,
 - konference: “Të Bashkuar Kundër Dhunës – MJAFT” mbështetur nga NDI;
 - Certifikim nga trajnimi një javor me temën "Krijimi i Mekanizmave Referues sipas Programit Channel" përkrahur nga CDF;
 - Trajnim me temën Buxheti i përgjegjshëm gjinor përkrahur nga UN WOMEN organizuar nga Zyra për Barazi Gjinore znj. Samka Drançolli

Për detale i bashkëngjitur është aneksi dhe i dorëzuar te Drejtoresha e drejtorisë.

Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë

Nita Panduri Mullarama

Drejtoria Komunale e Arsimit-	 KOMUNA E PEJËS OPŠTINA PEÇ MUNICIPALITY OF PEJA	PERIUDHA RAPORTUESE
Nr.prot. _____		JANAR -- qershor-dhjetor
Naser gega Naser gega@rks-gov.net 044-221-164		DATA: 26.12.2024

Nr. Ref.	Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës duhet të behën sipas planit të prokurimit, bazuar ne buxhetin e parapare për investime kapitale për vitin 2022	Muaji i realizimit përfshirë edhe procedurën e prokurimit	Çmimi i planifikuar në Euro
1.	OFRIMI I SIGURIMEVE AKSIDENTALE PER NXËNËSIT E SHKOLLAVE	NENTOR	3,500.00
2.	FURNIZIM ME MATERIAL HIGJIENIK DHE USHQIMOR	PRILL	145,000.00
3.	NDËRTIMI I SALLËS NË FSHATIN TREBOVIQ	SHKURT	175,000.00
4.	NDËRTIMI I SALLËS NË FSHATIN GLLOGJAN	SHKURT	175,000.00
5.	NDËRTIMI I OBJEKTIT TË GJIMNAZIT SHKENCOR	QERSHOR	2,981,010.38
6.	NDËRTIMI I ANEKSIT TË SHKOLLËS "28 NËNTORI"-ZLLAPEK	SHKURT	
7.	INTERNETI NE SHKOLLA	NENTOR	6,000.00
8.	FURNIZIM ME LENDE DJEGESE-DRE	SHTATOR	447,000.00
9.	RIPARIMI I KULMIT NE SHKOLLEN ODHISE PASKALI	SHTATOR	3,425.00
10.	LYERJA E MUREVE NE SALLEN E SPORTEVE NE POQESTE , RENOVIMI I KULMIT NE SALLEN NE LOXHE DHE NE SALLEN E SPORTEVE NE NABERGJAN	SHTATOR	36,030.00
11.	NGROHJA QENDRORE DHE SANITARE NE PUNETORINE E SHKOLLES RIFAT GJOTA	GUSHT	29,596.06
12.	NDERTIMI I KATIT TE PARE TE ANEKSIT NE SHFMU " RILINDJA "	GUSHT	68,446.40
13.	NDERTIMI I ANEKSIT TE SHKOLLES NE FSHATIN ZLLAPEK	PRILL	78,801.94
14.	NDERTIMI I QERDHES NE OBORRIN E SHKOLLES EKONOMIKE	SHKURT	947,619.66

Drejtoria Komunale e Arsimit ka për qëllim krijimin e kushteve për edukim cilësor të të gjithë nxënësve dhe avancim të vazhdueshëm profesional të mësimit në përfundim të mesimit me Kornizën e Kurrikulës së Kosovës.

Në Komunën e Pejës vijojnë mësimin 15619 nxënës në 26 shkolla fillore të mesme të ulta ,në 6 shkolla të mesme të larta . Në tri objekte funksionon IP “ Pëllumbat e Paqes ”me 395 fëmijë.

Në mësimdhënie janë të përfshirë 1450 mësimit prej të cilëve 931 femra dhe 519 meshkuj.

Gjatë periudhës së gjashtë mujorit të parë në sektorin e arsimit janë realizuar këto detyra:

- Takim i drejtorit të DKA-së me drejtorët e shkollave - përgaditjet e shkollave për fillimin e periudhës të dytë të vitit shkollor 2023/2024.(30 janar 2024)
- Vlerësimi i punës së stafit të DKA-së gjatë vitit 2023-janar
- Përpilimi i listave të nxënësve nga komuniteti boshnjak lidhur me regjistrimin dhe vijueshmërinë e nxënësve në shkolla-JANAR
- Organizimi dhe mbajtja e mësimit shtesë për nxënës të riatëdhësuar –janar-qershor
- Punëtori për hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Parandalim të Braktisjes dhe Mosregjistrim në Shkolla –janar ,vazhdon
- Trajnimi i edukatoreve për pilotimin e Kurrikulës së Re –janar-vazhdon
- Evidentimi dhe raportimi për rastet e migrimit të mësimit dhe nxënësve –në vazhdimësi
- Përzgjedhja e dy Shfmu me nxënës të kl. VII-ta nga DKA, në pjesëmarrjen e Projektit “Drejt Malit”2024,u përzgjedhën Shfmu”7Shtatori dhe Shfmu”Tetë Marsi”-janar 2024
- Përzgjedhja e mësimit për çmimin “ Shaban Jashari ” . Çmimin e fitoj – zj.. Luljeta Kurhasani mësimit në SHFMU”Lidhja e Prizrenit ” Pejë–muaji shkurt
- Shpallja e konkursit për plotësimin e vendeve të punës : 24.02.2024 (gjithsej 44 vende të shpallura)
- Punëtori me drejtor të shkollave të përzgjedhura me Projektin KOSED: caktimi i datës së vlerësimit(vëzhgimit) të jashtëm të shkollës së parë nga ana e Ekipit Komunal për Vlerësim të shkollës nga kolegët-me 4.03.2024 Shfmu”Lidhja e Prizrenit”.
- Organizimi nga DKA i drekës solemne dhe shpërndarjes së mirënjohjeve për

mësimdhënësit e pensionuar (nga data 7mars 2023-7 mars 2024) për nderë të 7 Marsit –ditës së Mësuesit.

- Zhvillimi i procedurave të rekrutimit të puntorëve të rinjë(testet me shkrim,intervista ,vendimet per pranim)etj-mars 2024
- Vizita dhe shërbime shëndetësore për nxënësit e klasave të II-të,V-të dhe IX-të ,të 4 Shfmu:”Xhemajl Kada”,”Asdreni”,”Lidhja e Prizrenit” dhe ”7 Shtatori”- Bashkëpunim i Drejtorisë së Shëndetësisë, DKA-së dhe Drejtorisë Mirëqenies Sociale
- Planifikimi i Qendrave për Sistemimin e nxënësve për testin e Arritshmërisë 2024-mars 2024.
- Raportimi në SMPK për Përfomancën e Komunës për vitin 2023 (fusha e arsimit)- 26mars 2024
- Shqyrtimi i ankesave të ndryshme nga shkollat (nga prindërit ,nxënësit ,drejtorët) ,nga ana e komisionit për ankesa - mars 2024
- Mbajtja e Ligjeratave nga Policia rajonale e Pejës në bashkëpunim me DKA-në - mars 2024 , me temat :
 - 1.Bullizmi dhe masat parandaluese (Klasat -VI—IX)
 2. Siguria e qarkullimit te këmbësoreve ne trafik (Klasat e I – VII).
- Mbajtja e Ligjeratave nga Policia rajonale e Pejës në bashkëpunim me DKA-në Tema: Respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë me qellim te parandalimit te ekstremizmit dhe radikalizmit te dhunshëm (Klasat VIII—IX) 22.04 deri 26.04.2024
- Hapja e Objektivit të ri të qerdhes ,në Karagaq -22.04.2024
- Organizimi i Panairit të Edukimit me nxënës të klasave të XII-ta në sallën “1 Tetori” në Prishtinë, me dt.17.04.2024
- Përzgjedhja nga DKA i Ekipit të II-të Për Vlerësimin e Jashtëm të Shkollave nga Kolegët ,në Shfmu”Tetë Marsi”, data e vlerësimit 22.04.2024 deri 26.04.2024.
- Përgatitjet për hapjen e objektivit të ri të qerdhes në Vitomiricë (pranimi i inventarit)-muaji Maj 2024
- Përzgjedhja nga DKA e ekipit të mësimdhënësve për trajnim nga MASHTI Ngritja e kapaciteteve për rishikim të teksteve shkollore në arsimin e detyrueshëm (0-9) me 11 dhe 12.05.2024
- Planifikimi i DKA për regjistrim të nxënësve në klasat e X-ta për vitin shkollor 2024/25-maj 2024
- Inaugurimi i qendrës së re të ECCD në shfmu”28 Nëntori “ Raushiq, në kuader të projektit “ Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë në Kujdesin dhe Zhvillimin e Fëmijerië së Hershme në Kosovë” Save the Children”
- Konkursi për zv drejtor të IAAP “Rifat Gjota” , ShFMU”Asdreni dhe edukatore për parafillor në IP.
- Planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasën e parë –10 Maj 2024
- Planifikimi i “Java e Dyerve të Hapura “për nxënës të klasave të nënta –vizitë shkollave të mesme dhe promovim i tri shkollave profesionale në qendër të

qytetit - 20-24 maj 2024

- Raportime në MASHTI lidhur me numrin e nxënësve braktisës të shkollimit të obliguar -16 nxënës braktisës dhe 3 të rikthyer (27 Maj 2024)
- Shpërndarja e vërtetimeve të mësimdhënësve të pensionuar, kontributdhënës të viteve 90/99, procedura në vazhdimësi.
- Përzgjedhja nga DKA i Ekipit të III-të Për Vlerësimin e Jashtëm të Shkollave nga Kolegjet „në Shfmu”28 Nëntori” në Raushiq, data e vlerësimit 27.05.2024 deri 31.05.2024.
- Organizim i trajnimit " Shëndeti riprodhues gjithpërfshirës"nga KOPF, MASHT në bashkëpunim me DKA - pjesë e kurrikules se re lëndore
- Pjesëmarrja e zyrtreve të DKA-së dhe mësueses së shkollës SHFMU”Lidhja e Prizrenit” Adelina Laja, në Manifestimin ‘Festa e Abetares “në nivel kombëtar në Gjilan -maj 2024
- Organizimi nga DKA, në përkrahje të zyrës së kryetarit, e punëtorisë në Durrës dhe vizitës studimore në qytetin e Elbasanit, me drejtor ,zv,drejtor të shkollave,zyrtar të DKA-së dhe zyrtar komunal 23-24-25 maj 2024
- Bashkëpunimi me OJQ të ndryshme në interes të arsimit në shkollat e komunës së Pejës- në vazhdimësi(Human,Save the children , Syriivizionit , YENI-Caritasi Zviceran , etj)
- Organizimi i testit Timss 2024 në formë elektronike në qendren e testimit IAAP”Rifat Gjota”- me nxënës të klasave të IV-ta të 7 shkollave të Komunës së Pejës-nga data 03-07.06.2024
- Vlerësime pedagogjike të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nga ana e Ekipit Vlerësues Komunal. Janë vlerësuar 41 raste - janar –qershor 2024
- Regjistrimi i nxënësve në klasë parafillore dhe në klasë të para për vitin shkollor 2024/2025 –datë 15.05.2024-vazhdon
- Takim informues me mësimdhënës të caktuar në administrim të testit të Maturës 2024 dhe testit të Arritshmërisë -qershor
- Caktimi i Qendrave të testimit (shkolla) për sistemimin e maturanëve ku do t'i nënshtrohen testit të Maturës 2024 (forma e aplikimit on-line e-Kosova)
- Organizimi i testit kombëtar Matura 2024–me dt.22.06.2024.
- Organizimi i Testit të Arritshmërisë 2024 me 25.06.2024 dhe 28.06.2024 -1358 nxënës do ti nënshtrohen testit i cili do të mbahet në 10 qendra të testimit
- Organizimi i ceremonisë së shpërndarjes së certifikatave për anëtarët e Ekipit të tretë **Vlerësimi i jashtëm i shkollave të Udhehequr nga kolegjet** (vlerësimi i

shkollës Shfmu"28 Nëntori"Raushiq)-5 korrik 2024

- Mbledhja e raporteve të punës 6 mujore të drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve të shkollave për periudhën: janar-qershor dhe korrik –dhjetor 2024
- Njoftimi i shkollave të mesme të larta për rezultatet e testit të matures 2024 korrik -Rezultati i testit të Maturës 2024 në nivel Komunal- **81.31%**
- Shpallja nga DKA e konkursit për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në arsimin e mesëm të lartë për vitin shkollor 2024/2025, datë: **09.07.2024**
- Njoftimi i shkollave për rezultatet e Testit të Arritshmërisë 2024 -Pjesa 1 dhe 2 më dt. 8 korrik 2024 -Rezultati i testit të Arritshmërisë në nivel Komunal-**54.74%**
- Dorëzimi në MASHTI i tabelarit të plotësuar ,me kërkesat e shkollave të Komunës së Pejës për tekste shkollore, sipas katalogjeve të ofruara ,për vitin shkollor 2024/2025 -10 korrik
- Planifikimi i konkursit për regjistrim në klasa të X-ta ,afati i gushtit -regjistrimi fillon me dt.19.08.2024
- Hartimi i Planit Komunal të Veprimit kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-26
- Pjesëmarrja në takimin e rregullt me trupen koordinuese/keshilluese-Human Kosova – çdo muaj nga një takim .
- Implementimi i Projektit "Sot unë Polic i Kosovës" me nxënës të klasave të V-ta,të Shfmu"28 Nëntori dhe Shfmu"Xhemajl Kada" ,me dt 20.08.2024
- Takim me drejtor dhe zv drejtor të shkollave të komunës së Pejës - diskutim rreth përgaditjeve për fillimin e vitit shkollor 2024/25 dt 18.08.2024
- Njoftimi i shkollave për hapjen e sistemit SMIA për regjistrimin e të dhënave për sukses të periudhës fundi i vitit shkollor -gusht, numrin e orëve të planifikuara dhe numrin e orëve të mbajtura për vitin shkollor 2023/24.
- Njoftimi i shkollave për hapjen e sistemit SMIA për grumbullimin dhe analizën e të dhënave të regjistrimit të nxënësve në vitin shkollor 2024/25 si dhe përditësimi i të dhënave për personel në shkolla –bazë për planifikimin e buxhetit të shkollave .
- Organizimi i **Testit të Maturës 2024** në dy qendra të testimit (afati i Gushtit 31.08.2024)
- Organizimi i pilot projektit Pisa 2025 me nxënës 15 vjeç (01.01.2008 deri me 31.12.2008) të shkollës IAAP"Rifat Gjota"me dt 28.10.2024
- Organizimi i ligjeratave nga Policia rajonale e Pejës me :

Tema:1-Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të Internetit Klasat e V - IX.

Tema: 2 - Kërkesë për Rritjen e Masave Parandaluese ndaj Fenomenit të Vetë-lëndimit të nxënësve- muaji tetor 2024

- Përgaditja e raportit nga DKA per SIA- lidhur me procesin e VPD-së, për drejtor dhe zv/drejtor, sa prej tyre janë në proces të vlerësimit të brendshëm dt.28.10.2024
- Organizim i takimit me të gjithë drejtorët e shkollave të mesme të larta si dhe me komandant të policisë rajonale në Pejë, në lidhje me sigurinë në shkolla – dt.24.10.2024
- Punëtori për hartimin e Planit të Veprimit 2025-2026 të Komunës së Pejës për mësimin dhe përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe të gjuhëve të komuniteteve – 28 Tetor
- Përzgjedhja nga DKA e 4 shkollave dhe implementimi i projektit “Together against Discrimination” të cilën e zbaton OJQ “Roma in Action” në partneritet me OJQ Romtegra dhe për të cilën e ka të nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me Drejtorin Komunal të Arsimit në Pejë –Nëntor 2024
- Formimi i Ekipit të katërt për Vlerësimin e jashtëm të shkollës të Udhehequr nga koleget-vlerësimi i shkollës Shfmu”Fan Noli “Krushec–modeli kosovarë i vlerësimit të shkollës, dt.11.11.2024 deri 15.11.2024
- Organizimi i ligjeratave nga Policia rajonale e Pejës me nxënës të klasave VI-IX dhe shkolla të mesme të larta me temën: “Parandalimi i Dhunes ne Familje” nga data: 25.11.2024 deri me 29.11.2024
- Organizimi nga DKA i Olimpiadës së Matematikës në nivel Komunal - OMK 2025, e mbajtur në shfmu”Asdreni” me dt.09.11.2024 dhe të drejtën e vazhdimit të garës e fituan 16 nxënës të klasave të VI,VII,VIII,IX,X,XI dhe XII , në Olimpiadën e XVII Matematike e Kosovës - OMK 2025. e cila u mbajt me 16 nëntor 2024 në Prishtinë
- Përkrahja e organizatës joqeveritare e licencuar nga MASHTI- **Lions Quest Kosovo**- në angazhimin e trajnimeve të mësimdhënësve ,në vazhdimësi gjatë vitit 2024
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me KFOR Italian në realizimin e aktiviteteve në shkolla (kurset e gjuhës Italiane në Shfmu”Ramiz Sadiku”,donacion i laptopëve në Shfmu”Smajl Hajdaraj”).
- Zhvillimi i procedurave të konkursit plotësues të dt 15.10.2024 për mësimdhënës në IAAP “Rifat Gjota” –nëntor 2024
- Takim në DKA me zyrtarin e lartë nga MASHTI, si dhe drejtorët e shkollave të komunës së Pejës -diskutim lidhur me procedurat e aplikimit për licencim të mësimdhënësve- nëntor 2024
- Pjesëmarrje e zyrtarëve nga DKA në punëtorinë 5 ditore "Krijimi i Mekanizmave Referues sipas Programit Channel"–Trajnim i ofruar nga **ekspertë të çertifikuar kosovarë**, nën mbikëqyrjen e **ekspertëve nga Britania e Madhe (COMMUNITY**

DEVELOPMENT FUND-CDF) –Më datë 9-13 dhjetor 2024 Pejë.

- Mbledhja e të dhënave nga shkollat, për numrin e nxënësve 15 vjeç, të cilët janë të lindur nga data 01.01.2009 deri më 31.12.2009, për pjesëmarrje në testin PISA 2025 - dt. 12.12.2024
- Vizita në shkolla të realizuara në vazhdimësi nga drejtori i DKA dhe zyrtarët me qëllim të monitorimit të gjendjes në shkolla
- Parashikimi i pozitave të reja në arsim për vitin 2025, nga DKA Pejë-dhjetor 2024 (raportim të zyra e personelit)
- Dorëzimi i raportit të punëve të realizuara nga DKA për vitin 2024 dhe planifikimi i aktiviteteve për vitin 2025.

Raport i realizimit të i aktiviteteve nga Zyra e Arsimit Gjithpërfshirës

- Pranimi i kërkesave për iniciimin e rasteve për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
- Analiza e raporteve dhe instrumenteve për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
- Vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me NEV arsimore sipas kërkesave nga shkollat
Numri total i fëmijëve me NEV arsimore të vlerësuar nga ana e Ekipit Vlerësues Komunal, në periudhën janar -dhjetor është 63 nxënës, ku prej tyre janë katër nxënës të rivlerësuar.
- Shpërndarja e vendimeve dhe rekomandimeve nga Ekipi Pedagogjik për shkollën dhe familjen
- Monitorimi në shkolla i rasteve të vlerësuara nga zyrtari për gjithëpërfshirje
- Raportime të rregullta në MASHTI për numrin e rasteve e të vlerësuara dhe përkrahjen e ofruar
- Mbledhja e raporteve mujore të punës së psikologeve dhe asistenteve të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore
- Takime me psikolog , asistent të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe mësues udhëtues nga Qendrat Burimore

Raport i realizimit të i aktiviteteve nga Zyrtari për Teknologji Informative

Gjatë periudhës Shtator 2024 - Dhjetor 2024 është punuar intensivisht në funksionalizimin e infrastrukturës teknologjike në shkolla dhe zyra të Drejtorisë së Arsimit.

Puna ka përfshirë:

- Instalimi dhe konfigurimi i 40 kompjuterëve në shkollat e komunës.
- Përditësimi i softuerëve dhe sistemit operativ për pajisjet ekzistuese.

Mbështetje dhe Rregullim i Pajisjeve:

- Rregullimi i 12 printerëve me probleme funksionimi.
- Asistim në konfigurimin e aplikacioneve të moniorimit dhe menaxhimit të kamerave të sigurisë.
- Inspektimi dhe optimizimi i pajisjeve të tjera, si projektorët dhe pajisjet për mësimdhënie.
- Mbështetje teknike për mësuesit për përdorimin e aplikacioneve mësimore dhe zgjidhjen e problemeve të lidhjes së pajisjeve.

Raport i realizimit të i aktiviteteve nga Zyrtari i lartë për Ndërtimtari

Gjatë periudhës Tetor 2024 - Dhjetor 2024 bazuar në kërkesat e shkollave janë realizuar këto intervenime nga Nëpunësit teknik dhe mbështetës (Mjeshtër i elektroteknikës dhe mjeshtër i ngrohjes, klimatizim dhe ujësjellësi) , në mbikëqyrje të Inxh.të Ndërtimtarisë në DKA :

- Intervenime në ujë dhe kanalizime në shkolla
- Intervenime në rregullimin e ndriçimit në disa klasa të shkollave
- Intervenime në sanimin e pikjeve dhe pastrimin gjeneral të kulmeve në ShFMU”Lidhja e Prizrenit “ dhe ShFMU”Dëshmorët e Kombit “ Baran
- Intervenimet në ngrohjet qendrore (vendosja e pompave të reja)në ShFMU”Ramiz Sadiku “ ShFMU” Skenderbeu” Treboviq dhe ShFMU” 28 Nëntori “ Raushiq

Administrata

- Përgjigje në kërkesa dhe ankesa të palëve , bazuar në ligj dhe vendosja në programin INTRANET
- Shpallja e konkurseve për mësimdhënës,plotësimi I vendeve të liruara (pushimet e lindjes)
- Shpallja e konkursit për drejtor shkolle në SHFMU”Migjeni “ Glllogjan

- Pranimi i Aplikacioneve në konkurset e shpallura
- Zbatimi i detyrave administrative si : vendimet e ndryshme ligjore për mësimdhënës dhe palë të tjera, kontratat e punës, vendimet për ndërprerje të marrëdhënies së punës, pagese ,pushimet e lehonise etj
- Pelqime ,Rekomandime ,njotime për shkolla
- Ankesa ndaj vendimeve te inspektoriatit
- Pjesëmarrja në vendime të komisioneve disiplinore,te ankesave etj.
- Vizita të rregullta në institucionet arsimore me qëllim të monitorimit të gjendjes në shkolla.

Sektori I Financave

TRANSPORTI I NXËNËSVE NË RELACIONET MBI 4 KM dhe fëmijëve me nevoja të veçanta - sipas ligjit për AP, neni 15 dhe neni 40.

PËRCJELLJA E NDRYSHIMEVE NË LISTËN E PAGAVE Janar-dhjetor 2024

Zotimet e mjeteve buxhetore - Janar –dhjetor- 2024

Zotimi i mjeteve dhe regjistrimi ne formë kompjuterike

Percjellja e mjeteve te alokuara dhe mjeteve te shpenzuara

Nxerrja e raporteve nga sistemi I Freebalancit dhe kontrollimi I ecurise se pagesave permes sistemit te Freebalancit

Pregaditja e pagave, tatimeve e kontributeve per mesuese mbeshtetese dhe percjellja per pagesë.

Pregaditja e specifikacioneve per komunal, percjellja per pagese, dhe dergimi I emajleve te kompanit perkatese si dhe krahasimi me pasqyrat e pagesave nga kontraktoret.

Futja e te dhënave per komunal ne databazen e instaluar nga zyra e IT-se se Komunes.

2024

Raporti vjetor i punëve të kryera



Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe
Hidroekonomi

Dhjetor 2024

Përmbajtja:

1.LLOJI DHE NUMRI I KËRKESAVE

- 1.1 Tabela e kërkesave të ndara sipas numrit dhe statusit
- 1.2 Inkasimet e të hyrave nga kontratat e marrjes me qira të tokave bujqësore komunal
- 1.3 Inkasimet e të hyrave nga vendimet për ndërrim të destinacionit të tokës
- 1.4 Rritja në përqindje e kërkesave të parashtruara në DBPH për vitin 2024
 - 1.4.1 Grafikoni i rritjes së numrit të kërkesave
 - 1.4.2 Grafikoni i rritjes në përqindje të kërkesave
- 1.5 Kërkesat e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe vërshimet
- 1.6 Kërkesat për vendosjen e paneleve solare

2.SUBVENCIONET NGA DREJTORIA E BUJQËSISË

- 2.1 Përkrahja e fermerëve me mekanizëm bujqësor
- 2.2 Përkrahja e fermerëve në “Ngritjen e Pemishtes me Mjedër”

3.BASHKËPUNIMET ME DONATORË

- 3.1 Bashkëpunimi me Organizatën Syri Vizion
 - 3.1.1 Tabela me sektorë përfitues të grantit nga Syri Vizion
- 3.2 Bashkëpunimi me Organizatën “Caritas”
- 3.3 Marrëveshja e bashkëpunimit me “Islamic Relief Kosova”

4.AKTIVITET E DREJTORISË PËR BUJQËSI

- 4.1 Monitorimi i Vendgjuetive
- 4.2 Workshop-i i Organizatës CARE
- 4.3 Lansimi i programit “EREA”
- 4.4 Seminari i mbajtur nga Kooperativa COOPEX me perfaqësues francez
- 4.5 Tryezë e rumbullakët me përfituesit e projektit WEERA
- 4.6 Nënshkrimi i kontratave të përfituesve të granteve nga OJQ Syri Vizion
- 4.7 Inagurimi i serave moderne në fshatin Leshan
- 4.8 Mbajtja e sesionit informues me Caritasin Zviceran
- 4.9 Fillimi i procedurave të ritenderimit për projektin “Trajtimi i qenëve endacak dhe menaxhimi i strehimores”
- 4.10 Shpërndarja e mekanizmave bujqësorë
- 4.11 Vizitë tek gratë fermere përfituese të projektit me Organizatën CARE
- 4.12 Trajnim për zhvillim në financa për gratë në biznese
- 4.13 Pjesëmarrja në fushatën “Toka jonë,shija juaj”
- 4.14 Aktivitetet edukative në lidhje me produktet vendore
- 4.15 Inspektimet e punimeve tek kanalet e ujitjes

5.INVESTIMET KAPITALE

- 5.1 Planifikimi i inv.kapitale (kanaleve të ujitjes) për vitin 2025-2026

6.SUBVENCIONET E MBPZHR

- 6.1 Afati i aplikimit për TM2 i vitit 2023
- 6.2 Afati i aplikimit në Programin e Pagesave Direkte për sipërfaqet e mbjellura me kultura bujqësore të përcaktuara në PPD 2024
- 6.3 Afati i aplikimit për TM1 2024,sasi të dorëzuar të grurit dhe plehra artificial

7.AKTIVITETET E QENDRËS INFORMUESE KËSHILLIMORE (QIK)

Drejtoria e Bujqësisë gjatë vitit kalendarik 2024 ka qenë e fokusuar në zhvillimin dhe mbështetjen e sektorit bujqësor të Komunës së Pejës, ku si punë kryesore ka qenë të sigurohet që ky sektor të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase, duke përmirësuar kështu produktivitetin dhe standardet e jetesës apo kushtet e punës për fermerët dhe komunitetet rurale.

Përmes trajnimeve dhe takimeve të shumta me fermerë, përfaqësues të organizatave dhe kompanive investitore jemi munduar të nxisim bashkëpunime për të krijuar mundësi të reja tregtare.

Poashtu një nga prioritetet kyçe të Drejtorisë së Bujqësisë edhe këtë vit, bazuar në vlersësimin e nevojave për ujitje si dhe kërkesave të shumta nga fermerët dhe nga bashkësitë lokale të fshatrave të Komunës së Pejës, ka qenë ndërtimi i kanaleve të ujtijes duke ndihmuar kështu përmirësimin e prodhimit bujqësor.

1.LLOJI DHE NUMRI I KËRKESAVE

Nga muaji Janar i fillimit të këtij viti e deri në muajin dhjetor, Drejtoria e Bujqësisë ka pranuar në total **1,337** kërkesa të natyrave të ndryshme:

- ✚ Aplikime për grante dhe subvencione nga DBPH për investime në makineri apo për përmirësimin e kushteve të fermës
- ✚ Kërkesa për regjistrimin në sistemin elektronik eFr, për t'u pajisur me çertifikatë të fermerit
- ✚ Kërkesa për ndrrime të kulturës së tokës
- ✚ Kërkesa për ndrrim të destinimit të tokës
- ✚ Kërkesa për marrje me qera të tokës komunale
- ✚ Kërkesa për ndihmë financiare për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe kafshët e egra

Pas pranimit të secilës kërkesë, është bërë identifikimi i tyre si dhe shqyrtimi nga zyrtarët përkatës të Drejtorisë, nëse ato janë të mundshme për t'u realizuar.

1.1 Në tabelën e poshtë-shënuar janë të paraqitura kërkesat e ndara sipas statusit, numrit dhe realizimit të shqyrtimit të tyre:

Statusi i kërkesës	Numri i kërkesave
Në proces	6
Miratuar	556
Refuzuar	762
Hedhur poshtë	3
Pezulluar	5
Ceduar	1
Anuluar	4

1.2. Kërkesa për marrje me qira të tokës bujqësore komunale: Dy (2) aplikues si persona fizik. Persona juridik nuk ka pas aplikues.


. -Këto kërkesa këtë vit nuk janë miratuar pasi që për vitin 2024 kjo taksë nuk është paraparë me Rregulloren Komunale për Taksa dhe Tarifa.

Kjo taksë do të jetë pjesë e Rregullores për vitin 2025.

1.3 Ndrimi i destinacionit të tokës: Sa i përket ndrrimit të destinacionit të tokës, nga toka bujqësore në tokë ndërtimore, këtë vit kemi patur rritje të kërkesave, bazuar në rritjen dhe zhvillimin e zonave urbane si dhe për shkak të fitimeve më të larta krahasuar me bujqësinë.

- Kemi pranuar gjithsej 22 kërkesa, 20 janë miratuar dhe lëshuar vendime kurse 2 prej tyre janë refuzuar.

- Totali i të hyrave të inkasuara nga këto vendime të lëshuara është **18,690.70 €**.




Janë punuar shkresa të ndryshme për Ministrinë e Bujqësisë, rekomandime për Zyrën e Kryetarit dhe Zyrën e Prokurimit, Vendime, Procesverbale të vlerësimit të dëmeve etj.

1.4 Nëse bazohemi në raportin e vitit të kaluar të Drejtorisë së Bujqësisë për vitin 2023, shohim se këtë vit ka pasur dukshëm rritje të kërkesave, nga **802** në **1,377**.



1.4.1 Rritja e numrit të kërkesave të përgjithshme prej 802 në 1377



1.4.2 Rritja në përqindje e numrit të kërkesave për vitin 2024 në 58%

1.5 Nga Komisioni Komunal i Vlerësimit të Dëmeve janë pranuar dhe janë në shqyrtim 5 kërkesa të dëmeve të shkaktuara nga fatkqesitë e ndryshme natyrore, si dhe dëme të shkaktuara në sektorin e blegtorisë nga sëmundje të ndryshme.

1.6 Kemi pranuar dy (2) kërkesa për ndrim të përkohshëm të destinimit të tokës bujqësore në tokë jo bujqësore, për vendosjen e **paneleve solare**.

1. Kompania “DUKAGJINI SOLAR SVERKE 04 L.L.C” – Me pëlqim të DUMM bazuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartat Zonale Nr.65/2023, dhe Aktvendim të DBPH lejohet ndrimi i përkohshëm i destinimit të tokës për ndërtimin e parkut solar në sipërfaqe të mëdha, në ngastrat e cekura në kërkesë. Sipërfaqja që do të ndërrohet është

105ha e 6572 m² dhe duhet të paguhet shuma prej 158,485.80 Euro, sipas UA nr.41/2026 neni 14, pika 14.2 paragrafi b) për kompenzim.

2. Kompania “SOLARISS L.L.C” –Me pëlqim të DUMM bazuar në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartat Zonale Nr.65/2023, dhe Aktvendim të DBPH lejohet ndërimi i përkohshëm i destinimit të tokës për vendosjen e paneleve solare në fshatin Kosuriq, sipas ngastrave të cekura në kërkesë. Sipërfaqja që do të ndërrohet është 106.8473ha dhe do të paguhet shuma prej 160,270.95 Euro, sipas UA nr.41/2006, neni 14, pika 14.2, paragrafi b) për kompenzim.

Të gjitha këto pagesa do të kryhen në Fondin Komunal.


2. SUBVENCIONET E D.B.P.H

2.1 Sipas thirrjes publike të dt.08.04.2024, më nr.prot.12/320-01/27801, planifikimit buxhetor dhe vendimit të Zyrës së Kryetarit më nr.400-01/41901/2024 të dt.27.05.2024 është shpallur afati i aplikimit për përkrahjen financiare (subvencionimin) të projektit **“Përkrahja e fermerëve-bujqëve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim.**


Ky projekt ka qenë bashkëpunim në mes të Komunës së Pejës dhe fermerëve, ku Komuna ka participuar me 70% kurse fermerët 30 % të vlerës financiare.

Vlera totale e projektit ka qenë **89,980.00 €**.

Për këtë projekt kanë aplikuar **537** fermerë, përfitues janë shpallur **106** prej tyre.



2.1.1 Bazuar në rekomandimin e Drejtorisë së Bujqësisë si dhe vendimin e lëshuar nga Zyra e Kryetarit nr.400-01/35431/2024, u aprovua edhe realizimi i vazhdimit të pjesës së dytë të projektit **“Përkrahja e fermerëve-bujqëve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim”**, ku u zgjodhën përfitues edhe 65 fermerë aplikues, të cilët kanë qenë në listë të pritjes nga pjesa e parë e projektit.



Vlera totale e projektit ka qenë **48,080.00 €**, me participim **30%** të shumës fermeri përfitues, ndërsa pjesën tjetër Komuna.

2.2 Pasiqë Mjedra si një pemë frutore ka kërkesë të madhe për përpunimin e produkteve të ndryshme dhe kultivimi i saj është rritur vitet e fundit në Kosovë, ne si Drejtori kemi bërë projekt-propozimin për përkrahjen e fermerëve me projektin **“Ngritja e pemishtës me mjedër”**, me ç`rast do përmirësoheshin edhe kushtet e jetesës dhe të punës për disa banorë të zonave rurale në Komunën tonë.

Projekti parashihet kultivimin e mjedrës në sipërfaqe prej **2ha**, ku do të përfitojnë **10-20** fermerë, nga **0.10** deri në **0.20ha**.


Mbështetja financiare e projektit është **29,600.00 Euro**, dhe implementimi i saj parashihet të realizohet në vitin 2025.

Komuna do të subvencionoj **70%** të vlerës së projektit, ndërsa fermerët përfitues **30%**.

3. BASHKËPUNIMET E D.B.P.H ME DONATORË

Bashkëpunimi me donatorë është një aspekt shumë i rëndësishëm për ne si Drejtori që kemi për qëllim realizimin e projekteve të përcaktuara, e që ndihmon në sigurimin e burimeve financiare apo materiale dhe mbështetjes për arritjen e objektivave.

Kemi pasur bashkëpunime me organizata ndërkombëtare dhe fondacione të ndryshme me të cilët si rezultat i komunikimit të mirë dhe raportimeve të rregullta kemi arritur të krijojmë një raport të qëndrueshëm dhe transparent.




3.1 Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, si dhe përfaqësues nga OJQ “SYRI VIZION”, kanë nënshkruar marrëveshjen e partneritetit për implementimin e projektit “**Gratë dhe personat me aftësi të kufizuara si ndërmarrëse bujqësore në Kosovë**”.

Qëllimi i memorandumit është që përmes DBPH që ka shprehur dëshirën për participim në vlerë prej 15.000.00 euro në këtë projekt, të krijoj mundësi të reja për përfituesit e përzgjedhur të këtij projekti, pasi që kjo kategori përballlet me sfida të shumta, që lidhen kryesisht me mungesën e mundësive të barabarta, diskriminimin dhe barrierat të shumta për arsimim të kualifikuar dhe kanë pjesëmarrje të ulët në tregun e punës.

3.1.1 Nga ky projekt përfituan gjithsejt 15 biznese familjare (gra fermere), ku në tabelën e paraqitur më poshtë i kemi paraqitur shumat e fituara të grantit si dhe sektorin ku kanë përfituar:

SEKTORI	SHUMA E PËRFITUAR E GRANTIT
Mekanizim - Perimtari, agro-turizëm-kultivator, freze, pllug	5,500.00 €
Mekanizim -mbjellëse pneumatike - lavërtari, blegtori	5,500.00 €
Perimekulturë, serre, kultivator, freze, pllug	5,330.00 €
Makina për përpunimin e frutave organike në lëngje dhe raki hydroprese pasterizator, mulli për bluarje	4,950.00 €
Përpunimi i mollës së egër- prodhimi I uthullës nga molla e egër	5,500.00 €
Perimekulturë, serre, kultivator	5,500.00 €
Mekanizim -freze, mikser për bluarjen e ushqimit- lavërtari, blegëtori	5,500.00 €
Bletari-centrifuge, shkrirëse e dyllit, depozit, koshere me blete	5,470.00 €
Mekanizim -freze, pllug, spërkatëse, lavërtari, blegëtori	5,240.00 €
Mekanizim - BMA -moto kultivator, freze, pllug, kose	5,500.00 €
Mekanizim -moto kultivator, kose, freze, pllug- Perimtari	5,500.00 €
Bletari-koshere, centrifug, pajisje tjera të bletarisë	5,243.00 €
Mekanizim - lavërtari, blegëtori- grabuje, kose, ngarkues plehu, mbjellëse e grurit	4,400.00 €
Kultivuese e arrës, pemëtari, kose fidanë arre, pajisje	5,220.00 €
Perimekulturë, serre, sistem i ujitjes, pompa	3,500.00 €
TOTALI:	77852.5 €

3.2 Komuna e Pejës në bashkëpunim me **Caritasin Zvicëran** ka subvencionuar fermerët kultivues të pemëve të imëta (mjedër dhe boronicë). Tek kultivuesit e boronicave kanë përfituar grant 7 fermerë, në sipërfaqe prej 2.5ha në vlerë 70,000.00 Euro, kurse tek kultivuesit e mjedrës kanë përfituar 11 fermer në sipërfaqe 1.60ha në vlerë 36,000.00 euro. Komuna ka participuar me **8,000.00** euro për blerjen e foljeve.




Në përgjithësi tregu i boronicës dhe mjedrës ka potencial të lartë për t`u zhvilluar dhe mund të ofrojë mundësi të rëndësishme për bujqësinë dhe ekonominë lokale.

3.3 Edhe këtë vit kemi vazhduar bashkëpunimin me Organizatën “**Islamic Relief Kosova**”, ku kemi nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit të projektit “Fuqizimi Bujqësor për Popullatat e Cënueshme në Kosovë”, për shpërndarjen e serave të dy dimensioneve dhe mekanizmave bujqësorë. Vlera totale e këtij projekti ka qenë **109,130.43 €**.

IRK ka participuar 50,90% të shumës totale, Komuna e Pejës 49.10% kurse fermerët përfitues 25% të vlerës së komponentës përfituese.

Në grafikonin e mëposhtëm keni të paraqitura numrin e përfituesve dhe llojet e paisjeve bujqësore:



4. AKTIVITET E D.B.P.H-së

- 4.1** Monitorim i vazhdueshëm i Vendjguetive. Shoqata e Gjuetarëve “Reqebulli” në periudhën dimërore ka ndihmuar kafshët e egra malore duke u përkujdesur për ushqyeshmërinë e tyre.
- 4.2** Gjatë muajit janar është mbajtur Workshop i Organizatës CARE me gratë përfituese të projekteve për bizneset e tyre familjare.
- 4.3** Në muajin shkurt kemi marr pjesë në lansimin e programit “Fuqizimi i Ekonomive Rurale në Bujqësi” EREA,program ky i cili synon të jap energji të re,inovacion,zgjidhje dhe përparim të mëtejshëm për ekonomitë rurale dhe fermerët e përkushtuar të Kosovës. Programi EREA financohet nga Caritasi Zviceran.
- 4.4** DBPH ka mbajtur seminar për blegtorë me ekspert francez nga Kooperativa Bujësore COOPEX dhe nga Instituti i Blegtorisë i Republikës së Francës si dhe përfaqësues nga MBPZHR. Seminari është mbajtur në Sallën e Kuvendit Komunal Pejë me dt.28.03.2024 dhe është diskutuar rreth selektimit gjenetik të kafshëve si dhe rëndësia e përgaditjes së ushqimeve në bazë të proteinave.

4.5 Është mbajtur tryezë e rrumbullakët me gratë fermere përfituese të projektit WEERA ,për integrimin e perspektivës gjinore në politikat komunale.

4.6 Me dt.03 prill është bërë nënshkrimi i kontratave me përfituesit e projektit nga OJQ “Syri Vizion”.Kanë qenë gjithsej 28 përfitues fermerë nga katër komunat: Pejë,Istog,Gjakovë dhe Rahovec. Vlera totale e projektit për Komunën e Pejës ka qenë 77,852.50 Euro.

4.7 Kemi marr pjesë në inagurimin e serave moderne në Regjionin e Pejës,më saktësisht në fshatin Leshan.Duke i`u faleminderuar mbështetjes zvicerane,shtatë sera moderne do të ndërtohen në regjione të ndryshme të Kosovës.Kjo do të kontribuojë në ngritjen e produktivitetit në gjithë sektorin e Agrokulturës,duke përfituar kështu një numër i madh i fermerëve.

4.8 Me dt.26 prill është mbajtur sesion informues nga DBPH në bashkëpunim me CARITAS-in Zviceran në lidhje me fuqizimin e iniciative të grave në sektorin e bujqësisë.

4.9 Përgaditja e paramasave dhe parallogarive për shpalljen e RITENDERIT nga Zyra e Prokurimit për projektin “Trajtimi i qenëve endacak dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës”.

4.10 Në periudhën 27.05-31.05.2024 është bërë shpërndarja e mekanizmit bujqësor sipas listave përfituese.

4.11 Së bashku me përfaqësuesit e CARE Austria për Ballkanin,kemi vizituar disa nga përfituesit e projektit WEERA. Qëllimi i vizitës ishte njohja nga afër e grave përfituese, përfitimet që makineritë i`u kanë sjellë në zhvillimin e biznesit të tyre si dhe njohjen me sektorinë e bujqësisë në zonat rurale të Komunës së Pejës.

4.12 Në fund të muajit korrik Komuna e Pejës përmes DBPH, në bashkëpunim me Organizatën Austriake CARE mbajtën trajnim për ngritje të aftësive në financa për gratë në biznese.

4.13 Kemi marr pjesë në fushatën “Toka jonë shija juaj” që është organizuar në qendër të qytetit të Pejës nga programi EREA, në partneritet me shoqatat: Shoqata Organike Mjedrat në Kosovë dhe Shoqata PePeKo-Association of Fruits and Vegetable Processors of Kosovo. Në këtë fushatë u zhvilluan shumë aktivitete si krijimi i koktejeve nga produktet vendore, vizatimi i produkteve vendore për krijimin e ekspozitës si dhe krijime të tjera arti nga produktet vendore.

4.14 Në bashkëpunim me Caritasin Zviceran në Kosovë, kemi organizuar aktivitete edukative në shkollën SHFMU Dardania Pejë dhe në shkollën e mesme Ali Hadri Pejë, ku në këto aktivitete interaktive nxënësit mësuan më shumë për benefitet dhe produktet vendore.

4.15 Gjatë muajit tetor kemi inspektuar punimet e kanaleve të ujitjes në fshatrat: Nakëll, Nabërgjan, Trestenik, Pavlan, Zahaq, Ramun.

4.16 Janë mbajtur trajnime falas për fermerë në muajin nëntor nga TMI-Tourism and Marketing Institute, me përkrahjen e MBPZHR-së me temën “Forcimi i kapaciteteve të OJQ-ve të turizmit rural përmes ngritjes së aftësive në marketing”.

4.17 Gjatë muajit dhjetor kemi inspektuar punimet e kanalit të ujitjes në fshatin Loxhë.

FOTO NGA DISA PREJ AKTIVITETEVE TË LARTËCEKURA:



1.Ushqyeshmëria e kafshëve të egra gjatë periudhës dimërore



2.Pjesëmarrja në lansimin e programit “Fuqizimi i Ekonomive Rurale në Bujqësi” EREA



3.Nënshkrimi i marrëveshjes së partneritetit në mes Komunës së Pejës dhe OJQ “Syri Vizion”



4. Tryezë e rrumbullakët me gratë fermere përfituese të projektit WEERA



5.Kultivuesit e mjedrës,përfitues të projektit nga Caritas-i Zviceran



6.Kultivuesit e boronicave,përfitues të projektit nga Caritas-i Zviceran



7.Plani i Ambulantes Veterinare për Trajtimin e Qenëve Endacak



8. Shpërndarja e makinerive bujqësore për fermerë



9. Inspektimi i punimeve tek ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatrat Nakëll, Nabërgjan, Trestenik, Ramun, Zahaq, Kliqinë dhe Loxhë



10. Donacion nga KFOR-i italian për fermerët e KK Pejë që merren me kultivimin e mjedrës



11. Shpërndarja e mekanizmave bujqësor për fermerët e Komunës së Pejës, bashkëpunim ky me Islamic Relief Kosova

5.INVESTIMET KAPITALE

5.1 Sipas raporteve të mbikëqyrësve të kontratave për kanale,dhe pagesave të realizuara nga DBPH janë përfunduar të gjitha punët nga viti i kaluar,sipas kontratave të nënshkuara nga planifikimet buxhetore dhe planet e prokurimit të vitit të kaluar.


5.2 Bazuar në kërkesat e fermerëve të Komunës së Pejës,si dhe në kërkesat e kryetarëve të bashkësive lokale, në lidhje me atë se cilat fshatra kanë nevojë për rregullimin e infrastrukturës së ujitjes dhe ndërtimin e kanaleve të ujitjes, ne si Drejtori përmes procedurave të Zyrës së Prokurimit KK Pejë, kemi nënshkruar këto projekte dy (2) vjeçare për ndërtimin e kanaleve të ujitjes:

Kontratat e ndërtimit të kanaleve të ujitjes 2025/2026

<i>Përshkrimi i projektit</i>	<i>Vlera e kontratës</i>	<i>Pagesa 2024</i>	<i>% e realizimit</i>
Ndërtimi I kanaleve të ujitjes në fshatrat: Baran I Ulët, Baran I Epërm, Çallapek,Kosuriq ,Penda e Vranocit dhe Broliq -LOT 1	198,979.50 Euro	€ 20,117.00	10.11 %
Ndërtimi I kanaleve të ujitjes në fshatrat: Loxhë, Vragoc, Dobërdol,dhe Graboc - LOT 2	131,225.50 Euro	€ 14,833.00	11.30%
Ndërtimi I kanaleve të ujitjes në fshatrat: Pavlan,Gllaviqicë,Ramun, Leshan dhe Kliqinë - LOT 3	128,994.50 Euro	€ 24,103.00 € 16,897.00	31.78%
Ndërtimi I kanaleve të ujitjes në fshatrat:Trestenik, Nabërgjan, Llabjan, Dardania III,Ruhot dhe Nakëll-LOT 4	188,264.00 Euro	€ 21,946.50 € 20,413.00	22.50%
Ndërtimi I kaneleve të ujitjes në fshatrat: Ozdrim,Dubovë, fshatrat e Podgurit dhe ndërtimi I mureve të pendës së Vragocit-LOT 5	€ 164,444.44 Euro	10,000.00	6.08%
TOTALI:	811,907.94 €	128,309.50 €	


6. SUBVENCIONET E MBPZHR-së (PROGRAMI I PAGESAVE DIREKTE)

6.1 Nga dt.15.01-13.02.2024, MBPZHR-ja ka shpallur thirrje për aplikim për TM2(subvencionim për qumësht sipas cilësisë,viça për majmëri, therrje dhe akuakulturë) për vitin 2023.




6.2 Programi për Pagesa Direkte për vitin 2024, nga MBPZHR është shpallur nga dt.13.03.2024 deri me 12.04.2024.

Kanë aplikuar gjithsej **1813** fermerë nga Komuna e Pejës, që kanë aplikuar me kultura të ndryshme bujqësore të mbjellura, të cilat subvencionohen direkt nga Ministria e Bujqësisë.



6.3 Nga data 01.08 deri me 01.09.2024 MBPZHR-ja ka shpallur thirrjen për aplikim për TM12024 (subvencionim për qumësht sipas cilësisë,viça për majmëri, therrje dhe akuakulturë), për sasi të grurit të dorëzuar dhe për faktura të plehut artificial.



7. AKTIVITETET E QENDRËS INFORMUESE DHE KËSHILLIMORE

Nga data 24.02-15.03.2024 në Qendren e Trajnimit në Lipjan është mbajtur trajnim me këshilltarët publik dhe privat lidhur me avancimin e shërimeve këshillimore në nivel vendi.

Janë njoftuar fermerët pronar të bujtinave për mundësinë e aplikimit në Grante.

Është mbajtur takim me kultivuesit e trangullit dhe kompaninë AgroCelina në Rahovec me qëllim të grumbullimit të këtij produkti për eksport jashtë vendit.

Janë kryer vizita në terren tek disa fermerë me rastin e paraqitjes së dëmtuesit në kulturën e grurit (morri).

Janë dërguar raporte mujore në DSHKT-Prishtinë.

Janë ndihmuar rreth 76 fermerë për aplikim në grantet e AZHB-së, me këshilla për kompletim të dokumentacionit, sqarime lidhur me procedurat e aplikimit si dhe forma të tjera në mënyrë që fermerët të jenë aplikues dhe përfitues.

Organizimi i këshillimeve me fermerë me dt.07.06.2024 në Qendrën e Trajnimeve në fshatin Novosellë me temën "Kultivimi i pemëve të imëta-Mjedër".

Me dt.19.06.2024 këshillime me fermerë në Qendrën e Trajnimit në Novosellë me temën "Kujdesi ndaj bletës gjatë muajve të verës", me ligjëruesit Elbasan Qekaj dhe Venera Kelmendi.

PËRMBLEDHJE:

✚ Gjatë vitit 2024 Drejtoria e Bujqësisë përmes subvencioneve dhe bashkëpunimeve me donatorë të ndryshëm ka ndihmuar **318** fermerë me paisje të ndryshme bujqësore, me subvencionim të projekt-propozimeve të granteve, si dhe me subvencionim të bizneseve familjare në mënyrë që të krijohen kushte me të mira të punës:

- 11 përfitues të makinave mbjellëse
- 87 përfitues të Frezave 1.8m
- 66 përfitues të Frezave 2.0m
- 51 përfitues të makinave Spërkatëse
- 20 përfitues Shpërndarëse Plehu 350L
- 5 përfitues të Serave 500m²
- 45 përfitues të Serave 100m²
- 7 përfitues për kultivimin e boronicës
- 11 përfitues për kultivimin e mjedrës
- 15 biznese familjare (gra dhe persona me aftësi të kufizuara) bashkëpunim me projektin nga Syri Vizion

✚ Nga Drejtoria janë ndihmuar **1813** fermerë për përgaditjen e dokumentacionit dhe aplikim në sistemin elektronik eFR gjatë afateve të subvencioneve të shpallura nga MBPZHR.

✚ Vlera totale e fondeve të përfituara për vitin 2024 nga marrëveshjet me donatorë: **256,982.93** Euro.

✚ Totali i mjeteve financiare, subvencione nga Drejtoria e BPH-së: **167,660.00** Euro.

✚ Vlera totale e kontratave të nënshkruara për investime kapitale për vitin 2024/2025 : **811,907.94 € , 15 mijë metra kanal te ujitjes.**



KOMUNA E PEJËS

RAPORTI JANAR-DHJETOR 2024

DREJTORIA

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Dielleza Berisha

EMRI I DREJTORIT TË FINANCAVE:

GAZMEND MUHAXHERI

EMRI I KRYETARIT TË KOMUNËS:

Fusha	Aktiviteti	Rrezultati
FINANCA	Përmbyllja e vitit paraprak.	E përfunduar, Janar 2024
	Analizë e të hyrave të vitit paraprak.	E përfunduar, Janar 2024
	Përgaditjet me Informata financiare, komunikim me Drejtoritë tjera për të arketueshmët.	E përfunduar, Janar 2024
	Përgaditje e pasqyrave FINANCIARE te vitit paraprak	E përfunduar, Janar 2024
	Përgaditja e draft rregullores per taksa dhe tarifa	E përfunduar ne Shkurt 2023, e miratuar ne Korrik 2023, ka hyre ne fuqi Janar 2024
	Ridestnimi I Rezerves buxhetore	E përfunduar, Mars 2024
	Analize Financiare për tremujorin e parë të vitit.	E përfunduar, Prill 2024
	Përgaditja, dhe bartja e mjeteve te vitit paraprak si dhe rritjes buxhetore.	E përfunduar, Prill 2024
	Analize e Qarkores se pare buxhetore	E përfunduar, Maj 2024
	Përgaditja e Kabit Komunal	E përfunduar, Qershor 2024
	Procesi I Auditimit të jashtëm.	E përfunduar, Mars 2024
	Komunikim, dhe përgaditje e raportve per donatorë.	Gjatë gjithë Vitit
	Mbajtja e degjimeve buxhetore	Gusht 2024
	Analize e Qarkores se dyte buxhetore	Gusht 2024
	Futja e te dhenave ne PIP dhe BDMS	Shtator 2024

	Zotim I mjeteve sipas kërkesave.	Gjatë gjithë Vitit
	Procesim I Pagesave	Gjatë gjithë Vitit
	Raportimet mujore	Gjatë gjithë Vitit
	Analize Financiare për projektet kapitale.	Gjatë gjithë Vitit
	Alokim I të hyrave.	Gjatë gjithë Vitit
Fusha	Aktiviteti	Rrezultati
BUXHETI	Përgaditje e Raportit të të Hyrave dhe Shpenzimeve për vitin Paraprak.	E përfunduar, Janar 2024
	Përgaditje dhe Finalizim i Pasqyrave Financiare.	E përfunduar, Mars 2024
	Përgaditje e Raportit të të Hyrave dhe Shpenzimeve për tremujorin e parë.	E përfunduar, Prill 2024
	Përgaditja e Kabit Komunal	E përfunduar, Qershor 2024
	Përgaditje e raportit 6 Mujor 2024	E përfunduar Korrik 2024
	Përgaditja e Buxhetit per vitin 2024	Gusht -Shtator 2024
	Përgaditje e raportit 9 Mujor 2024	Tetor 2024
	Protokolim dhe barazim I faturave me Departamentin e Financave	Gjatë gjithë Vitit
Fusha	Aktiviteti	Rrezultati
:e	Analizë e të hyrave nga Tatimi në Pronë për vitin paraprak.	E përfunduar, Janar 2024

Tatimi në Pron

Shpërndarje e Fakturave të Tatimit në Pronë	E përfunduar, Mars 2024
Pranimi i Ankesave për Tatimin në Pronë.	Gjatë gjithë Vitit
Regjistrim i Objekteve të reja.	Gjatë gjithë Vitit
Lëshim i vertetimeve, printim i fakturave, pagese e takses rrugore	Gjatë gjithë Vitit
Rianketim i Objekteve.	Gjatë gjithë Vitit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEĆ

Raport i Punës Janar-Dhjetor 2024

Pejë, Dhjetor 2024

DREJTORIA PËR ÇËSHTJE PRONËSORE-JURIDIKE

RAPORT I PUNËS

Janar-Dhjetor 2024

REFERENCA :	Raport i Punës
Datë/Datum/Date	Dhjetor 2024
PËR/ZA/TO	Z. Gazmend Muhaxheri - Kryetar i Komunës së Pejës
PËRMES/PREKO/THROUGH	Arianit Krasniqi – Drejtor në Drejtorinë për Çështje Pronësore-Juridike
NGA/OD/FROM	Drejtoria Për Çështje Pronësore - Juridike – Pejë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	RAPORTI I PUNËS / JANAR – DHJETOR 2024

RAPORT I PUNËS JANAR – DHJETOR 2024

Gjatë kësaj periudhe raportuese Drejtoria për Çështje Pronësore - Juridike ka realizuar punët e listuara si më poshtë:

- Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike nga Janari deri me tani ka pranuar gjithsej **1058** kërkesa nga palët, nga të cilat të pranuar **1** kërkesë, në proces **120** kërkesa, të miratuara janë **889**, të refuzuara **19** kërkesa, hedhur poshtë **1** kërkesë, të pezulluara **15** kërkesa dhe të anuluar **13** kërkesa, si dhe raste të cilat janë hapur ex- officio të natyrës Këmbim prone dhe Ankesa për uzurpim të pronës;
- Gjatë vitit 2024 jemi marrë me lëndët të cilat kanë qenë të natyrave të ndryshme duke përfshirë lëndët për shpronsime, këmbime, dhëniës së lejës për shfrytëzim të përkohshëm të pronës publike, evidentimin dhe parandalimin e uzurpimit, si dhe largimin e uzurpimeve nga pronat komunale;
- Në lagjet “Kapeshnica” dhe “Puhovci” janë rrënuar **6** shtëpi dhe **2** lokale të cilat nuk ishin të pajisura me leje apo nuk ishin në pajtim me Planin Zhvillimor Komunal. Ndërsa, edhe **2** (dy) shtëpi janë në procedurë për rrënim në lagjen “Kapeshnica”;
- Në lagjen “Asllan Qeshme” është përfunduar largimi i uzurpimeve mbi Kanalin e Ujërave Atmosferikë;

- Në Qendrën e qytetit në “Korzo”, janë rrënuar 4 lokale, ku është marrë leja e ndërtimit dhe ka filluar ndërtimi i objektit të ri sipas planit zhvillimor komunal, gjithashtu në procedurë për rrënim janë edhe **12** (dymbëdhjetë) lokale me ç’rast njoftimet i’u janë dërguar pronarëve privat. Procedura e rrënitit të këtyre lokaleve do të përfundoj në momentin kur rregullohen të gjitha dokumentet përkatëse.

Gjatë kësaj periudhe kemi kryer poashtu edhe:

- Kontrollin dhe hapjen e rasteve për shfrytëzim të pronës publike;
- Kontrollin dhe zhvillimin e procedurave për kioska dhe objekte të përkohshme të cilat janë në shfrytëzim nga palët.
- Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike për uzupimet e pronës komunale ka lëshuar **2** (dy) gjopa: një në vlerë prej 1.000.00 €, ndërsa tjetrën në vlerën 500.00 €;
- Nga pagesat e panove reklamuese kemi gjeneruar të hyra në vlerë prej **133,391.29€**.
- Nga pagesa e qirasë nga objektet publike të cilat janë në shfrytëzim- kemi gjeneruar të hyra në vlerë prej **14,594.50 €**.
- Nga dhënia në shfrytëzim e pronës publike (Parkingje, Kioska, Tavolina) Drejtoria për Çështje Pronësore–Juridike ka gjeneruar të hyra në vlerë prej **214,715.60€**.
- Nga këmbimet, Drejtoria për Çështje Pronësore–Juridike ka gjeneruar të hyra në vlerë prej **141,245.00€**.
- Nga data 01.01.2024 deri më 24.12.2024, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike ka gjeneruar të hyra në vlerë prej **503,946.39Euro**.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Pejës
Opština Peć
Peja Municipality

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër /Direkcija za Geodezija i Kataster
/Department of Geodesis and Cadastre

PËR/ZA/TO:	z.Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës Pejës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Mustafë Nila, Drejtor i Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër
NGA/OD/FROM:	z.Fjolla Kasapolli, UD si Shef i Sherbimit Juridik-Administrativ
LËNDA:	Raporti i punës për peridhën 03.01.2024. - 23.12.2024.
Data:/Datum:/Date:	23.12.2024.

Nr.	EMËRTIMI I LËNDËS	Numri i lëndëve
1	NUMRI I KËRKESAVE PËR DALJE NË TERREN	90
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	90
	NUMRI I LËNDEVE TË PAREALIZUARA	0
2	NUMRI I LËNDËVE NGA GJEODETAT PRIVAT	975
	NUMRI I LËNDEVE TË REALIZUARA	955
	NUMRI I LËNDEVE TË PAREALIZUARA	20
3	NUMRI I LËNDËVE PËR BARTJE TË PRONËS	3224
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	3074
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	150
4	NUMRI I LËNDËVE PËR HISTORIAT TË PRONËS	120
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	120
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	0
5	NUMRI I LËNDËVE PËR REGJISTRIM/FSHIRJE TË HIPOTEKAVE	439
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	439
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	0
6	NUMRI I LËNDËVE PËR LEGALIZIM	126
	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	110
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	16

	NUMRI I LËNDËVE PËR KORRIGJIM, TË DHËNAVE	100
7	NUMRI I LËNDËVE TË REALIZUARA	70
	NUMRI I LËNDËVE TË PAREALIZUARA	30
8	NUMRI I KËRKESAVE PËR FLETA POSEDUESE DHE KOPJE TË PLANIT	12152

RAPORT DYMBËDHJET MUJOR I AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NË 2024

Aktivitetet e realizuara nga DKRS

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit	Data e realizimit të aktivitetit	Sa është Kosoto	Kush i mbulon shpenzimet	Sektori/ Institucioni
1	THIRRJE PËR PROJEKT PROPOZIME 2024	Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, ka hapur thirrjen për propozimin e projekteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit për vitin 2024. Takim pune me Komisionin për vlersimin e projekteve për subvencione 2024	Janar - Qershor	Ska Kosto	/	Sporti
2	SESION INFORMUES - THIRRJE PËR PROJEKT - PROPOZIME 2024	SESION INFORMUES - THIRRJE PËR PROJEKT - PROPOZIME 2024 Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport ka mbajtur sesionin informues - thirrje për propozimin e projekteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit për vitin 2024. Në sesionin informues të pranishmit janë njoftuar rreth plotësimit të formularëve të aplikimit dhe informatave të tjera shtesë.	Shkurt	Ska Kosto	/	Sporti
3	Shpallja e sportistit të vitit 2023	DKRS organizon ceremoninë e shpalljes së sportistit të vitit .Ku bëhet ndarja e çmimeve, shpërblimeve,dekoratave dhe mirënjohjeve nga autoritetet të ndryshme sportive dhe qeverisëse	25.01.2024	Darka	Komuna e Pejës	Sporti
4	Aktivitetet për Ditën e Pavaresis 16 vjet shtet	DKRS ne bashkëpunim me Sportin shkollor , në Palestra e sporteve Karagaçi organizuam garat në Basketboll për vajza dhe djem SHMU .	16.03.2024	Sobvencione	Sporti shkollor	Shoqata e Sportit shkollor
5	Turneu dimëror në Ragbi	DKRS (Sektori i sportit në Bashkëpunim me klubin e Ragbit<<Peja Eagle Rugby Club , në Qendren sportive Bobi organizuan Turneun dimëror në ragby, ku pjemares ishin 9 ekipe nga Kosova	16.03.2024	Sobvencione		
6	Turniri ndërkombëtar i Boksit Epopeja e Dukagjinit	DKRS (Sektori i sportit në Bashkëpunim me klubin e Boksit "PEJA AP " , në Palestren sportive Karagaçi organizuan Turneun ndërkombëtar ditët e fillimit të luftës së UÇK në dulagjin dhe 25 vjetori i sulmeve ajrore të Natos.	24 Mars	1000	K.Box "Peja AP"	Sporti
7	Finalet e SHFMU në Volejboll	DKRS ne bashkëpunim me Sportin shkollor organizoi finalet ne Volejboll për Djem dhe Vajza , ku u zhvilluan në objektin sportiv " Suti Sport" .	Mars - Prill	Sporti shkollor	Komuna e Pejës	Sporti
8	Finalet e SHML dhe SHMU në Volejboll	DKRS ne bashkëpunim me Sportin shkollor organizoi finalet ne Volejboll për Djem dhe Vajza ku u zhvilluan në objektin sportiv " Suti Sport" .	Mars -	Sporti shkollor	Komuna e Pejës	Sporti
9	Ndeshja Reviale ne mes te veteranve nga Diaspora dhe Peja	Ndeshja Reviale ne mes te veteranve nga Diaspora dhe Peja qe u organizohet nga DKRS dhe Shoqata e veteranve te futbollit ku zhvillohet ne stadiumin e qytetit "Shahin Haxhiislami".	Gushtë	Vetrane e Futbollit	Komuna e Pejës	Sporti
10	Finalet e SHML dhe SHMU në Futsall	DKRS ne bashkëpunim me Sportin shkollor organizoi finalet ne Futsall për Djem dhe Vajza ku u zhvilluan në Palestrëne sporteve Karagaçi për : SHFMU vajzat dhe djemt si deh SHML vajzat dhe djem.	Mars - Nëntor	Sporti shkollor	Komuna e Pejës	Sporti
11	Turneu i Basketbollit në Nilüfer, Bursa (TURQI)	Ekipi i Basketbollit i cili do ta prezanton Drejtorja për Kulturë, Rini Dhe Sport - Komuna Pejë në festivalin tradicional të Sportit dhe Rinisë në Nilüfer, Bursa-Qytet si motër me Komuna Pejë	Mars - Prill	1000	komuna e Pejës	Sporti
12	Turniri Memorial në Karate "Haki Iberdemaj"	Klubi Karates "Ippon" në bashkëpunim me Federata Karates e Kosoves organizoin Turnirin Memorial ne Karate "Haki Iberdemaj".	Mars - Prill	federata e Karates me lubin	komuna e Pejës	Sporti
13	Ndeshja revijale në Futboll ; Në Kujtim të Legjendave të futbollit	Në Kujtim të Legjendave të futbollit ; Tahit Vokshi ; Haki Loci : Shahin Haxhiislami Legjendat nuk Vdesin . U organizua ndeshja revijale ne mes te Veteraneve të reprezentacionit të Kosoves dhe Klubit te Futbollit të veteraneve të Beses me daten 12.11.2024	Nëntor	Komuna	Komuna e Pejës	Komuna e Pejës
	Organizimi i Takimeve Letrare Azem Shkreli	Në Edicionin e XX-Jubilar Takimet Letrare Ndërkombëtare Azem Shkreli jane paraqitur në format të ri.	Tetor	4,000	Komuna e Pejës	Dkrs

14	Hapja e Qendrës për Edukimin e të Rinjve dhe të Rriturve në Pejë	DVV International, në bashkëpunim me Komunën e Pejës bënë inaugurimin e Qendrës për Arsimin dhe Edukimin e të Rinjve dhe të Rriturve në Pejë (YALEC - Youth and Adult Learning and Education Center – Peja). Qëllimi i kësaj qendre është të krijojë mundësi për pjesëmarrjen e të rinjve dhe të rriturve në oferta gjithëpërfshirëse të programeve edukative nga komuna e Pejës.	Nëntor	20,000	DVV International	DKRS
15	Pjesmarja në Paraden Kuq e Zi në Tiranë	Pjesmarja në Paraden më të madhe shqiptare ku sivjet kuma e Pejës ishte e përafshur me 220 pjesëmarrës :Kuç e Zi : Pjesëmarrës ; Ansambli Rugova, Grupi i Valltareve të Tasim Dajçit , Klubi i Xhudos Peja , Studentët e Fakultetit Haxhi Zeka , Sporti shkollor Etj.	Janar - Qershor	Ministria	Komuna e Pejës	Sporti
16	Festa e 28 nëntorit	Aktivitetet e ndryshme për 28 nëntorin ,Sektori Sportiv në bashkëpunim me Sportin Shkollor dhe Klubin e Femrave të beharit zhvilluan aktivitetet në Futboll për femra dhe futboll	Nëntor	Komuna	Komuna e Pejës	Sporti

**RAPORTI 12 MUJOR I AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NË 2024
NË "SALLËN E PARTIZANIT"**

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit	Data e realizimit të aktivitetit	Sa është Kosto	Kush i mbulon shpenzimet	Sektori/ Institucioni
1	Klubi Karates " Ippon"	Klubi Karates " Ippon" secant stërvitore i zhvillon në Sallën Partizanit " Gjatë periudhës Janar- Dhjetor , Klubi i ka zhvilluar gjithsejt 98 seanca stërvitore	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
2	Klubi Karates " Arena "	Klubi Karates "Arena " secant stërvitore i zhvillon në Sallën e Partizanit " Gjatë periudhës Janar- Dhjetor , Klubi i ka zhvilluar gjithsejt 98 seanca stërvitore	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
3	Policia e Kosovës DRP - Pejë "	Policia e Kosovës DRP - Pejë (Njësia për reagim të shpejtë),ka shfrytëzuar Sallën e Partizanit për pregaditje fizike dhe kondicionale. Gjatë periudhës Janar- Dhjetor , kan zhvilluar gjithsejt 9 seanca stërvitore	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit

**RAPORTI 12 MUJOR I AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NË 2024
NË STADIONIN "SHAHIN HAXHIISLAMI"**

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit	Data e realizimit të aktivitetit	Sa është Kosto	Kush i mbulon shpenzimet	Sektori/ Institucioni
1	Klubi futbollit "KF Rilindja 1974 "	Klubi Futbollit " KF Rilindja "I ka zhvilluar 85 seanca stërvitore dhe 18 ndeshje .	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
2	Klubi futbollit "KF Shqiponjat" "	Klubi Futbollit "Shqiponjat "juniorët i kan zhvilluar 58 seanca st .	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit

**RAPORTI 12 MUJOR I AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NË 2024
NË SALLËN E SPORTIT KARAGAÇ**

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit	Data e realizimit të aktivitetit	Sa është Kosto	Kush i mbulon shpenzimet	Sektori/ Institucioni
1	K.H " BESAFAMGAS"	Klubi Hendbollit "Besafamilja " secant stërvitore i zhvillon në Sallën e Palestrës " Karagaçi" Gjatë periudhës Janar- Dhjetor , Klubi i ka zhvilluar gjithsejt 153 seanca stërvitore dhe 31 ndeshje si dhe 15 lojra i kanë zhvilluar kadetët.	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
2	KV " PEJA "	Klubi Volejbollit "PEJA " secant stërvitore i zhvillon në Sallën e Palestrës " Karagaçi" Gjatë periudhës Janar- Dhjetor , Klubi i ka zhvilluar gjithsejt 153 seanca stërvitore dhe 612 ndeshje si dhe 6 lojra i kanë zhvilluar juniorët.	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
3	KB " BOREA"	Klubi Basketbollit "BOREA " secant stërvitore nuk ka zhvilluar në Sallën e Palestrës " Karagaçi" Gjatë periudhës Janar- Dhjetor , Klubi i ka zhvilluar 36 seanca stërvitore dhe 15 ndeshje kampionale ne Palester.	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
4	KB " PENZA'	Klubi Basketbollit "PENZA " Vajzat secant stërvitore i zhvillon në Sallën e Palestrës "Karagaçi". Gjatë periudhës Janar- Dhjetor, klubi i ka zhvilluar gjithsejt 120 seanca stërvitore dhe 25 ndeshje.	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
5	KB' PEJA'	Klubi Basketbollit "PEJA " secant stërvitore i zhvillon në Sallën e Palestrës "Karagaçi". Gjatë periudhës Janar- Dhjetor , klubi i ka zhvilluar gjithsejt 153 seanca stërvitore dhe 27 ndeshje.si dhe grupmoshat e reja U12 i kanë zhvilluar 5 ndeshje dhe U18 i kan zhvilluar 12 ndeshje .	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
6	KB" PEJA 03 " Femrat	Klubi Basketbollit "PEJA " Femrat secant stërvitore i zhvillon në Sallën e Palestrës "Karagaçi". Gjatë periudhës Janar- Dhjetor , klubi i ka zhvilluar gjithsejt 120 seanca stërvitore dhe 25 ndeshje .	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit

7	KBox "PEJA "	Klubi Boksit "Peja " seancat stërvitore i zhvillon në Sallën e Palestrës "Karagaçi". Gjatë periudhës Janar- Dhjetor, klubi i ka zhvilluar gjithsejt 50 seanca stërvitore .	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
8	KBox "BESA "	Klubi Boksit "BESA " seancat stërvitore i zhvillon në Sallën e Palestrës "Karagaçi". Gjatë periudhës Janar- Dhjetor, klubi i ka zhvilluar gjithsejt 161 seanca stërvitore .	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
9	Kbox. Femrat "BESA "	Klubi Boksit Femrat "BESA " seancat stërvitore i zhvillon në Sallën e Palestrës "Karagaçi". Gjatë periudhës Janar- Dhjetor, klubi i ka zhvilluar gjithsejt 7 seanca stërvitore dhe 2 ndehje Kampionale	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit

**RAPORTI 12 MUJOR I AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NË 2024
NË QENDRËN SPORTIVE "TAHIR VOKSHI" në Brestovik**

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit	Data e realizimit të aktivitetit	Sa është Kosto	Kush i mbulon shpenzimet	Sektori/ Institucioni
1	Klubi futbollit "FC BESA Peja "	Klubi Futbollit " FC Besa Peja " i ka zhvilluar 90 seanca stërvitore dhe 17 ndeshje .	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
2	Klubi futbollit "KF Dardania "	Klubi Futbollit " KF Dardania " i ka zhvilluar 85 seanca stërvitore dhe 16 ndeshje . .	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
3	Klubi futbollit " KF Dardania U17 "	Klubi Futbollit " KF Dardania " U17 i ka zhvilluar 45 seanca stërvitore dhe 8 ndeshje . .	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
4	Klubi futbollit "FC ARENA U 13 -15 "	Klubi Futbollit " FC Arena " U13- U15 i ka zhvilluar 105 seanca stërvitore .12 lojra	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
5	Klubi futbollit "KF Peja "U13 - 15 -17	Klubi Futbollit " KF Peja " i ka zhvilluar 65 seanca stërvitore dhe 6 ndeshje.	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
6	Veteranet e futbollit	Veteranet e Futbollit i ka zhvilluar 7 ndeshje .	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
7	Rreprezentacioni i Futbollit U15 të L.R Pejë	Rreprezentacioni i Futbollit U15 të L.R Pejë i ka zhvilluar 24 seanca stërvitore .	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit

RAPORTI 12 MUJOR I AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NË 2024 NË FUSHËN E FUTBOLLIT " VITOMERICË " NË VITOMERICË

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit	Data e realizimit të aktivitetit	Sa është Kosto	Kush i mbulon shpenzimet	Sektori/ Institucioni
1	Klubi Futbollit " Behar "	Klubi Futbollit " KF Behar " i ka zhvilluar 98 seanca stërvitore.dhe 15 ndeshje	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori/ Institucioni
2	Klubi Futbollit " Behar " Femrat	Klubi Futbollit " KF Behar " femrati ka zhvilluar 60 seanca stërvitore.dhe 8 ndeshje . .	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori/ Institucioni
3	Klubi Futbollit " Phoniks "	Klubi Futbollit " KF Phoenix " i ka zhvilluar 32 seanca stërvitore.dhe ndeshje 5 ndeshje	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori/ Institucioni

RAPORTI 12 MUJOR I AKTIVITETEVE TË REALIZUARA NË 2024 NË FUSHËN E FUTBOLLIT " NOVOSELLË " NË NOVOSELLE

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit	Data e realizimit të aktivitetit	Sa është Kosto	Kush i mbulon shpenzimet	Sektori/ Institucioni
1	Klubi Futbollit "Drini bardhë "	Klubi Futbollit " KF Drini i Bardhe " i ka zhvilluar 160 seanca stërvitore.me grupmoshat U 8 - U15 i ka zhvilluar 16 ndeshje . .	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
2	Klubi Futbollit "Istogu "	Klubi Futbollit " KF Istogu" ka zhvilluar 63 seanca stërvitore. 8 lojë	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
3	Klubi Futbollit "Peja "	Klubi Futbollit " KF Peja " i ka zhvilluar 4 seanca stërvitore.dhe ndeshje 10 ndeshje	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
4	Klubi Futbollit "Istogu 03"	Klubi Futbollit " KF Istogu 03 " ka zhvilluar 8 seanca stërvitore. 10 lojë	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
5	Klubi Futbollit "AS Peja"	Klubi Futbollit " KF As Peja " ka zhvilluar 8 seanca stërvitore. 10 lojë	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
6	KF "Rilindja 1974"	Klubi Futbollit " KF Rilindja 1974 " ka zhvilluar 28 seanca stërvitore..	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
7	Klubi Futbollit " Dardania"	Klubi Futbollit " KF Dardania " i ka zhvilluar 29 seanca stërvitore.dhe ndeshje 29 ndeshje	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
8	Klubi Futbollit " KF Shkendija"	Klubi Futbollit " KF Shkendija " ka zhvilluar 77 seanca stërvitore. 15 lojë	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit
9	Klubi Futbollit " Besa Peja "	Klubi Futbollit " KF Besa Peja " ka zhvilluar 5 seanca stërvitore.	Janar - Dhjetor	Stërvitje pa pagesë	DKRS	Sektori i Sportit

RAPORTI VJETOR I PUNËS ME AKTIVITETE DHE PROJEKTE TË REALIZUARA - 2024 Biblioteka "Azem Shkreli"

Nr	Emri i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit	Data e realizimit të aktivitetit	Sa është Kosto	Kush i mbulon shpenzimet	Sektori/ Institucioni
1	Qytetari Digjital	Raporti vjetor për implementimin e planit punuës në Bibliotekën "Azem Shkreli" u është realizuar nga ky projekt (Qytetari Digjital) huazime me Lap-Top, Micro Bit dhe BOSAN nga sektori i fëmijëve, të rriturve dhe salla e leximit gjithësejt 163 huazime. Gjithashtu, nga ky projekt Biblioteka "Azem Shkreli" ka hyrë në garë me gjitha institucionet e arsimit dhe bibliotekave që janë përfshirë me këtë projekt. Gjithashtu, pranimi i tri ropotave.	01.01.2024-31.12.2024	1000	Organizata IRIM - Croatian Makers , i mbështetur nga Google dhe me partner lokal Kosova Makers League- Prishtina	Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS

2	Bashkëpunimi me Shkollën Ekonomike "Ali Hadri"	Me datën 05.02.2024, është bërë marrëveshje në mes të institucionit të Arsimit dhe Aftësisit Profesional "Ali Hadri" e përfaqësuar nga drejtori z. Arif Ademaj, dhe me institucionin e Bibliotekës "Azem Shkreli" çdo të merkurë nxënësit të vijnë në bibliotekë të mësojnë punën në Bibliotekë. . Qëllimi i marrëveshjes është që përmes bashkëpunimit me Bibliotekën nga sektori publik të krijohet mundësi për 40 nxënës të Institucionit të Arsimit dhe Aftësisit Profesional, t'i aplikojnë njohuritë e tyre teorike në një ambient pune dhe njëkohësisht që të përfitojnë nga sektorët përkatëse duke iu ofruar mundësinë e përgaditjes, testimit dhe rekrutimit të punëtorëve.	05.02.2024-31.03.2024	Pa kosto		Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
3	Promovim i Librit "Refugjatë dhe Turistë"	Me datën 23.02.2024, është promovuar libri "Refugjatë dhe Turistë", një libër udhëtimi me rrëfime autobiografike mes individualës, fatit kolektiv dhe vlerave universale nga autori Enver Ulaj.	23.02.2024	Pa kosto		Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
4	Master Class	Në kuadër të Bibliotekës "Azem Shkreli" sot është zhvilluar një punëtori, me krijuesit e artit dhe letërsisë (Master Class), në kuadër të programit ministror "Arti në shkollë" në Shkollën Fillore "Dëshmoret e Kombit" në Baran. Qëllimi i këtij aktiviteti për "Artin në shkollë" ishte që fëmijët të jenë më shumë të informuar rreth rëndësisë së edukimit për estetikën, të artit të shkruar, kultivimin artistik emocional ideve. Në këtë punëtori, poetesha dhe profesoresha Arbnesha Kelmendi Draga i shpalosi në mënyrë profesionale qëllimet e shprehjes së mendimeve të shkruara në letër, në forma tradicionale e artit të shkruar në cilësi të estetikës duke ndërlikuar me figura stilistike me kultivimin e edukimit artistike emocionale të fëmijëve për mbrenda natyrës së tyre. Më pas nxënësit me idetë kreative paraqitën krijimet e veta më shkrim në vargje. Bashkëpunimi me shkollat fillore: -Shkollë Fillore "Asdreni" 18.02.2024 -Shkollë Fillore "Dëshmor të Kombit" Baran 14.02.2024 -Shkollë Fillore "Dardania" 26.02.2024	26.02.2024 14.02.2024 18.02.2024	Pa kosto		Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
5	Arti në shkollë	Ne kuadër të projektit "Arti në shkollë" është zhvilluar aktiviteti i prezantimit të Bibliotekës "Azem Shkreli". Ku, është prezantuar institucionin dhe mundësitë që ofron për leximin dhe ruajtjen e arkivimit e librave. Biblioteka "Azem Shkreli" ka një fond të konsiderueshëm të librave në braj, pjesërisht të krijuar me fond vetanak dhe rreth 100 tituj të dhuruar nga Qbmk Xheladin Deda Pejë	20.03.2024	Pa kosto		Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
6	Dita Ndërkombëtare e Librit për Fëmijë -2 Prilli	Në Ditën Ndërkombëtare e Librit për Fëmijë, vizituan Bibliotekën "Azem Shkreli" nxënësit e Kopshti Pëllumbat e Paqës dhe Kolegji Cambridge.	02.04.2024	Pa kosto		Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
7	Dita Botërore e Librit 23 Prilli	Ky është aktiviteti i veçantë që në si institucion i librit e kemi parim bazë të punës sonë. Festojmë së bashku, në forma të ndryshme, zhvillimet më të fundit të letërsisë shqiptare. Në këtë ditë të veçantë, Shkëlqim Duraku, ia dhuroi Bibliotekës "Azem Shkreli", dhe gjitha Bibliotekave shkollore të Komunës së Pejës 50 kopete të veprave të Nebil Durakut. Falenderojmë Shkëlqim Durakun. Falenderojmë gjithashtu, Forumin Rinor të LDK-ës për dhurimin e 50 ekzemplarëve të dhuruara. Një takim mbresëlënës u zhvillua më të rinjë, shkrimtarë dhe intelektualë të qytetit të Pejës. Gjithashtu, në vizitë ishin fëmijët e Qëndrimit Ditor "Ideali", Shkollë Fillore "Rilindja", "8 marsi", "Lidhja e Prizrenit" ku me nxënësit kemi debatuar për rëndësinë e librit dhe me kënaqësi dëgjuam rrëfimet dhe këshillat për librin.	23.04.2024	Pa kosto		Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
8	Vizita e Kopshtit "ENGJUJT"	Fëmijët e Kopshtit "Engjujt", të shoqëruar nga mësueset e tyre dhe në mënyrë të organizuar, vizituan sot Bibliotekën "Azem Shkreli" në muajin e librit. Fëmijët u njoftuan për së afërmi me fondin e librave për fëmijë, për mënyrën e regjistrimit dhe huazimit të librit.	25.04.2024	Pa kosto		Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
9	Vizita e Shkollës Fillore "Lidhja e Prizrenit"	Nxënësit e Shkollës "Lidhja e Prizrenit", të shoqëruar nga mësueset e tyre dhe në mënyrë të organizuar, vizituan sot objektin e Bibliotekës "Azem Shkreli". Ata u njoftuan për së afërmi për fondin e librave që i ka biblioteka dhe për hapsirat e rehatshme për lexim dhe aktivitete të ndryshme që do të organizohen me lexuesit e vegjël dhe për mënyrën e regjistrimit dhe huazimit të librit. Mësueset e shkollës "Lidhja e Prizrenit" premtuan se do të bashkëpunojnë me bibliotekën përmes aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të krijimit të shprehive dhe shkathtësive të leximit tek fëmijët.	30.04.2024	Pa kosto		Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS

10	Java e Bibliotekës në Kosovë	Në ditën e tretë e Javës së Bibliotekës në Kosovë e organizuar nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës në Bibliotekën Publike të Pejës, është mbajtur sesion shkencorë me temën Kultura e leximit: korelacioni bibliotekë - shkollë - familje Drejtues të sesionit ishin Shengyl Kelmendi Gashi & Elmedina Abdullahi -Biblioteka në raport me lexuesin dhe etika e bibliotekarit Shengyl Kelmendi Gashi -Përdorimi i veglave interaktive për promovim të Bibliotekave Elmedina Abdullahi -Roli i bibliotekave në motivimin e kulturës së leximit Nagjije Berbatit Kastrati -Evolucioni i Katalogimit në Botim : nga kartoteka tradicionale te njësitë e digitalizuara Fahrie Marmullaku & Shukrie Istogu -Revizioni i inventarëve Fatime Bublaku	29.05.2024	Pa kosto	Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
11	Ekspozita "Rijetësimi artizanial i trashëgimisë kulturore jo-materiale"	Në kuadër të aktiviteteve të organizuara, u hap ekspozita "Rijetësimi artizanial i trashëgimisë kulturore jo-materiale", organizuar nga OJQ - 'Dera e hapur', dhe kuruar nga Belxhizare Muharremi. Ekspozita u hap nga znj. Zaide Krapi, Biblioteka Kombëtare e Kosovës, dhe nga znj. Belxhizare Muharremi, drejtore e OJQ 'Dera e hapur'. Ekspozita u hap në Mullirin 'Haxhi Zeka', në Pejë.	29.05.2024	Pa kosto	Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
12	Forcimi i Bashpunimit ndërmjet Shërbimit Sprovues të Kosovës dhe Komunitetit	Biblioteka "Azem Shkreli" ka marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët "Forcimi i Bashkëpunimit ndërmjet Shërbimit Sprovues të Kosovës dhe komunitetit". Në këtë tryezë diskutimi kanë qenë përfaqësues nga Komuna e Pejës, Gjykata, Prokuroria, Policia e Kosovës, Shoqëria Civile, sektori privat, liderët lokalë, përfaqësues nga komuniteti, biblioteka, organizatat e grave dhe ato rinore, sektori i arsimit, sektori i shëndetësisë, si dhe përfaqësues të tjerë relevante. Pjesë e panelit të kësaj tryeze diskutimi ishin: • Zv. Udhëheqëse e Drejtorisë Rajonale të ShSK, Pejë-Drita Haka • Përfaqësues nga Gjykata Themelore e Pejës (TBC) • Përfaqësues nga Prokuroria Themelore e Pejës (TBC) • Moderimi – Skender Perteshi, QKSS Takimi është mbajtur në Hotel Dukagjini, Pejë në orën 10:00-12:00	11.06.2024	Pa kosto	Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
13	Promovimi i librit "Rugovë jehonë burrërie"	Është mbajtur promovimi i librit me vlera historike, figura kombëtare me kujtime ... e vërteta që bazohet në fakte para lexuesve me librin më të ri i profesorit Osman R. Shala "Rugovë jehonë burrërie".	28.06.2024	Pa kosto	Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
14	Vizita e Bibliotekës Koreane	Me datën 17.07.2024, vizita e Bibliotekës së Trashëgimisë Koreane znj. Jungeun Hong.	17.07.2024		Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
15	Muaji i letërsisë	Në kuadër të Tetorit, muajt të letërsisë është vizituar Biblioteka "Azem Shkreli" nga Shkolla Filllore "Dëshmorët e Kombit", që të risjellim në vëmendje ndërgjegjësimitin për rëndësinë e librit si pasuri kulturore që mbart historinë, gjuhën dhe vlerat e një kombi.	18.10.2024	Pa kosto	Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
16	Ora e Shkrimtarit	Në ambientet e rrethuar me libra llojesh dhe zhanresh të ndryshme dhe me praninë e shumë pjesëmarrësve, në Bibliotekën "Azem Shkreli" në Pejë, u mbajt Ora e shkrimtarit me poeten Naime Beqiraj. Ky ishte takimi i dymbëdhjetë më radhë, i organizuar nga PEN Qendra e Kosovës, projekt i përkrahur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili po organizohet në shumë qendra të Kosovës. Aktiviteti u moderua nga shkrimtari Binak Kelmendi, i cili prezantoi Naime Beqirajn, si poetë, gazetare dhe drejtore të Bibliotekës së kryeqytetit të Republikës së Kosovës. Duke i përmenduar veprat kryesore të saj të shkruara deri më tani, Kelmendi vlerësoi lart krijimtarinë letrare të Beqirajt në kuadër të zhvillimeve të poezisë së sotme shqipe.	05.11.2024	Pa kosto	Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
17	Hapja e këndit Gjerman	Ceremonia zyrtare e hapjes së këndit Gjerman, për t'u pasuruar fondi librar edhe me gjuhën gjermane. Në ceremoni ka marrë pjesë zyrtari i ambasadës Gjermane, drejtoreja e DKRS-së, znj. Xhenet Syka Kelmendi, ku dhe mbajti njëfjalim rasti për hapjen e këndit gjerman në Bibliotekën e Pejës.	20.09.2024	Pa kosto	Biblioteka "Azem Shkreli" -Sektori i Kultures - DKRS
	Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Ri-integrimin e Personave të Riadhesuar dhe Integrimin e të Huajve, ka organizuar punëtori mbështetësi nga GIZ - Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit.	<ul style="list-style-type: none"> • "Avancimi e bashkëpunimit nder-regjional, ngritje e kapaciteteve të akterëve lokalë për këshillim efektiv dhe zbatimin e politikave të Riintegrimit. • Verësimin e Nevojave rreth procesit të Riintegrimit dhe Integrimit të Riadhesuarve", Punëtorja ka përfshijë sesione të thelluara, diskutime dhe ushtrime praktike, me synim mbështetjen e akterëve lokalë në zbatimin e suksesshëm të këtyre politikave. • "Trajnim për Qarkoren Informativë për Zbatimin e Rregullores QRK NR. 22/2020 Për Riintegrimin e Personave të Riadhesuar" Implementimi i Planeve Komunale të Veprimt Për Riintegrimin e Personave të Riadhesuar dhe Integrimin e të Huajve • Zbatimit të Politikave të Integrimit të Huajve dhe Qasjes së Tyre në në Skemat e Integrimit"
Fusha	Aktiviteti	Rezultati
Bashkëpunimi me Ministrin për Komunitete dhe Kthim (MKK)	Takimet e rregullta me MKK-në	Takimet e rregullta me MKK-në lidhur me procesin e kthimit dhe zgjidhje të qëndrueshme.
	Punëtori për zyrtarët e ZKKK-ve	Perdorimi e bazës së të dhënave të MKK-së
	Takim rajonal koordinues	Strategjinë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre 2023-2027," me një fokus të veçantë në rolin e komunave në zbatim, monitorim dhe raportim.
Fusha	Aktiviteti	Rezultati
Bashkëpunimi me nivelin qendror	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal/MAPL, në bashkëpunim me Organizatën "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjptianëve", "Terre des hommes" dhe "HEKS" ka organizuar një tryezë diskutimi.	"Vlerësimi të kapaciteteve të strukturave komunale të mandatuara për të punuar me grupet e marginalizuara/MAPL dhe "Rregulloren e (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil".
Fusha	Aktiviteti	Rezultati
Bashkëpunim me nivelin Lokal	Bashkëpunim me Komuna tjera - ZKKK	Gjate vitit kemi vizituar ZKKK ne Komunitat Istog, Deçan, Klinë, Gjakove dhe Prizren. Qellimi i keyre vizitave ishte shkembimi i përvojave, si dhe ndarja e informatave rreth punëve të zyrës.

	Aktiviteti	Rezultati
Bashkëpunimi me Policin e Kosovës, FSK-në dhe KFOR-in	Takime me Polici dhe FSK-es	Takime të rregullta mujore për çështje të komuniteteve ne komunën e Pejës.
	Takim me KFOR-in	Takim me KFOR-in lidhur më pozitën e komuniteteve ne komunën e Pejës.
Fusha	Aktiviteti	Rezultati
Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare	Bashkëpunim me IOM-in lidhur me projektin për RRK V	Për këtë vit kemi pasur 4 raste të reja të interesuar për kthim nga Mali i Zi. Në këtë vit nuk kemi pasur raste të reja kthimi. Është ndërtuar një shtëpi (rast i vjetër) nga ky program në Gorazhdec, nga komuniteti serb - 3 anëtarë të familjes.
	Bashkëpunim me IOM-in lidhur me projektin "Stabilizim Komuniteteve"	<ul style="list-style-type: none"> Vlerisimin në teren aplikuesve per projekt. Pranim dorezimi I projektit Furnizim me mjete te konkretizimit/Laborator Fizik - Kimi- biologji per shkollen fillore ne Novoselle - Peje.
	Fondacioni Jahjaga në koordinim me Zyrën e Shefit të Misionit të UNHCR-së në Prishtinë dhe Zyrën e UNDCO-së ka organizuar takim me perfaqesuesi KKPeje dhe komunitetet e kthyer në Pejë	"Investimi në fuqizimin ekonomik për të përmirësuar mirëqenien, përfshirjen sociale dhe qëndrueshmërinë në mes grave dhe të rinjve të kthyer". Qëllimi është shqyrtimii rrugët e mundshme për të lehtësuar përfshirjen e këtyre individëve në mundësi të zhvillimit sociAo-ekonomik.
	Agjencisë për Zhvillim Rajonal-Perëndim, ka organizuar tryezën e rumbullakët "Prioritetet zhvillimore të OSHC-ve nga Rajoni Perëndimorë dhe bashkëpunimi i ardhshëm me MZHR", si takim i përbashkët i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal me Organizatat e Shoqërisë Civile nga rajoni perëndimorë i Kosovës.	Qëllimi i tryezës me OSHC-të e rajonit është diskutimi i mundësitë e bashkëpunimit me MZHR në realizimin e qëllimeve të përbashkëta zhvillimore, mundësitë e financimit të aktiviteteve të OSHC-ve për qëllime të zhvillimit rajonal të balancuar, si dhe implikimet ligjore nga Ligji i ri për Zhvillim Rajonal dhe aktet e ndërlidhura nënligjore, sipas agjendës së bashkangjitur.
	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) misioni në Kosovë ka organizuar punëtori	<ul style="list-style-type: none"> Vlerisimin"Punëtorinë dy ditore në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që qon në Terrorizëm (PEDhRT), në komunën e Pejës" . Punëtorja synon fuqizimin e grave në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. "Ngritja e kapaciteteve për rritjen e aftësive te punësimit të grave të kthyer dhe grave nga komunitetet jo shumice si përfitues të iniciativave socio-ekonomike nga rajoni i Pejës dhe Mitrovicës"
	Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje të Komunave (DEMOS)	"Përmirësimin e performancës së komunave në qeverisje, menaxhim dhe shërbime duke kontribuar në rritjen e kënaqshmërisë së qytetarëve".Një ndër komponentet e rëndësishme të projektit ka të bëjë me angazhimin e qytetarëve në procesin e planifikimit të buxhetit komunal.
Fusha	Aktiviteti	Rezultati
Bashkëpunimi me drejtoritë komunale	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje ne Komision Komunal për Riintegrim (KKR) Komisioni Komunal për Kthim (KKK) Komiteti për Komunitete (KK) Komitet për politik dhe financa (KPF) Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) Kuvendi Komunal Komision Komunal për Mekanizmit Koordinues Komunal kunder Dhunes ne Familje 	<ul style="list-style-type: none"> KKR ka mbajtur 2 mbledhje në të cilat janë shqyrtuar 2 raste (Kërkesë); 2 Kërkesa për Akomodim KKK ka mbajtur 1 takime dhe janë shqyrtuat 1 raste. Nacionalitet Egjiptian - 1 ZKKK ka mare pjes ne 11 takime te regullta ne Komitetin për Komunitete (KK) Gjatë kësaj periudhe kohore ZKKK-ja ka marr pjese ne pesë takime ne Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS). ZKKK ka mare pjes ne 2 takime te regullta ne KKomitet për politik dhe financa (KPF) Gjatë kësaj periudhe kohore ZKKK-ja ka marr pjese ne pesë takime ne Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS).

Fusha	Aktiviteti	Rezultati
Shërbimeve të tjera ZKKK-ës	Pranimi i paleve	ZKKK ofron shërbime, këshillon palët në baza ditore si për kthimin, riintegrimin dhe të drejtat e komuniteteve
	Vizita e refugjatve në Miin eZI	<ul style="list-style-type: none"> • Vizita "Shko informo" në Herceg Novi • Vizita e 4 rasteve cillat kanë shprehur interesimin për kthim .
	ZKKK-ja e realizon vizita në terren të kthyerve, personave të riatdhesuar dhe të gjitha komuniteteve për të parë riintegrimin e tyre në shoqëri dhe për të marrë informacion për problemet dhe nevojat e tyre.	Vizitat janë bërë në teretëritorin e Komunes së Pejës
	Financat e ZKKK-ës	<ul style="list-style-type: none"> • Sipas kërkesave nga Buxheti i Zyrës Komonale për Komunitetet dhe Kthim, të gjithë kërkesat shqyrtohen dhe azhurohen më kohë.



RAPORT PUNE I KKSBB-së PËR VITIN 2024

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), i cili përbëhet nga 26 anëtarë (13M. dhe 13F.), gjatë vitit 2024, duke u bazuar në planin e punës ka mbajtur gjashtë (6) takime me anëtarë të KKSBB-së si dhe panelist – përfaqësues të institucioneve relevante të ndërlidhura me KKSBB, KLSP-ve, OJQ-ve si dhe përfaqësues të MPB-së, MAPL-së, Policia e Kosovës, UNMIK, OSBE etj.

KKSBB, mbajti edhe trajnime, seminare dhe tryeza, më temë:

- Qasja e policimit në bashkësi, organizuar nga UNDP,
- Tryezë rajonale me forumet e sigurisë në bashkësi dhe shoqërinë civile, organizuar nga OSBE,
- Shënimi i Ditës Botërore të Mjedisit, ku tema bosht ishte - Aktivitetet parandaluese ndaj krimeve mjedisore, organizuar nga OSBE në bashkëpunim me policinë e Kosovës, si dhe trajnime tjera në organizim me KLSP, dega Pejë.

Sipas procesverbaleve të mbajtura për çdo takim, përmbajtja e tyre vijon sipas renditjes së më poshtme.

Takimi i parë, u mbajt më dt. 29.02.2024, kryesuar nga Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri. Ky takim iu dedikua gjendjes aktuale në territorin komunës së Pejës, gjendjes së sigurisë poashtu në territorin e komunës së Pejës, gjendjes në shkolla dhe situatës së zhvillimit të procesit arsimor, sigurisë në shkolla, përdorimit të substancave narkotike dhe bartjes së mjeteve të rrezikshme si dhe koordinatori i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, z.Fatmir Asllani pyeti të pranishmit nëse kanë për të shtuar ndonjë tematikë shtesë ose ndonjë sygjërim, për t'a vendosur si pikë e rendit të ditës për t'u diskutuar në këtë takim.

Takimi i parë për vitin 2024, kishte këtë rend dite:

- Arritja dhe regjistrimi i anëtarëve të KKSBB-së;
- Hapja e mbledhjes së KKSBB-së nga ana e koordinatorit – **z. Fatmir Asllani**, prezentimi i rendit të ditës, planit të punës dhe aprovimi si dhe procesverbali i mbledhjes së fundit të vitit 2023;
- Fjala hyrëse dhe paraqitja e gjendjes aktuale në Komunë – kryetari i Komunës **z. Gazmend Muhaxheri**
- Raport për gjendjen e sigurisë në Komunën e Pejës – **Komandanti i Policisë z. Idriz Atashi**;
- Arsimi, gjendja në shkolla dhe situata e zhvillimit të procesit arsimor. Siguria në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme. – **drejtori i DKA-së z. Naser Gega**;
- Diskutime dhe Pyetje nga anëtarët e KKSBB-së;
- Konkludime, Rekomandime;

si dhe planin e punës, i cili është aprovuar nga anëtarët e rregullt.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka raportuar për gjendjen aktuale në Komunë. Këtë vit e kemi filluar me disa projekte, të cilat kanë mbet pa u përfunduar nga viti i kaluar, pra këtë vit me plan të punës dhe plan të prokurimit e kemi rregullimin e sheshit, rregullimin e kanalizimeve të dyqaneve në shesh, vendosjen e rrymës nëntoksore në shesh, gjelbërimi ka me qenë i rikuperushëm dhe në funksion të qytetarëve, ndërtimin e urave, njëra e cila e lidh Puhovcin me Kapeshnicën, ndërsa ura tjetër fillon nga Kombinati i Lëkurkepucëve, e cila e lidh pjesën me restorant "Universin" edhe del poshtë në rrugën për Prishtinë, vazhdimi i shetitores, grantin e performancës, të cilin e kemi fitu është 1 milion e 752 mijë, janë 22 projekte të shpërndara nëpër fshatra dhe qytet, në pjesë të ndryshme për rregullim urban, punimi i ambulancës së re në fshatin Trestenik, do të përfundojë edhe shtegu i shëndetit, hapësira tek uji i zi, punimet te kanali te furra "Husaj" dhe në lagjen "Fidanishte", rregullimin komplet të lagjes "Fidanishte" me kubëzim dhe ndriçim edhe rregullimin e kanalit mbi shkollë, ndërsa 280 mijë euro i kemi ndarë për rregullim të kanalit në lagjen "2 Korriku", rruga "Maja e Zezë" - Vitomiricë është përfunduar, ka filluar ndërtimi i çerdhes te Shkolla e Mesme Ekonomike "Ali Hadri", e cila do të jetë një çerdhe e madhe, që do të përfundojë në vitin 2025, janë 68 kilometra rrugë në fshatra, që bëhen, pastaj janë 7 kilometra rrugë në qytet edhe janë 36 kilometra rrugë në Rugovë.

Drejtori për Arsim në Komunën e Pejës, z.Naser Gega ka raportuar për gjendjen në shkolla, situatën e zhvillimit të procesit arsimor, sigurinë në shkolla, përdorimin e substancave narkotike dhe bartjen e mjeteve të rrezikshme.

Takimin me këshillin e prindërve dhe drejtorë të shkollave i kemi të vazhdueshme në DKA dhe të gjitha ato vështirësi që i hasim në terren, merremi automatikisht me to për tejkalimin e tyre. Nuk kemi asnjë rast të raportuar për përdorimin e substancave narkotike dhe bartjen e mjeteve të rrezikshme për këtë vit. Bulizmin në shkolla, fyerjet, ofendimet dhe ngacmimet të tilla në rastin e parë që hetohet mirren masa adekuate që këto të tejkalohen, qoftë raporti nxënës-nxënës ose mësimsdhënës-nxënës.

Një problem më vete në shkolla, edhe pse jemi në kontakt dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me Stacionin Policor, paraqesin veturat e ndaluara para shkolle, ku prindërit i sjellin fëmijët në shkollë, duke filluar prej Gjimnazit "Bedri Pejani", ish dashtë gjithsesi, s'paku prej orës 12.00-13.00, të jenë prezent policia.

Pushimin papagesë të stafit, sidomos pas liberalizimit të vizave, e kemi reduktuar në minimum sepse synimi kryesor është që nxënësi s'bën të mbetet asnjë moment pa mbulesë - pa mësimsdhënësin adekuat.

Në vazhdim anëtarët kanë paraqitur shqetësimet dhe kërkesat e tyre bazuar në nevojat e komuniteteve, që ata i përfaqësojnë.

Takimi i dytë, i kryesur nga Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, u mbajt më dt. 22.05.2024, më këtë rend dite:

- Arritja dhe regjistrimi i anëtarëve të KKSB-së;
- Hapja e mbledhjes së KKSB-së nga ana e koordinatorit – **z. Fatmir Asllani**, prezentimi i rendit të ditës, procesverbali i mbledhjes së takimit të kaluar dhe aprovimi;
- Fjala hyrëse dhe paraqitja e gjendjes aktuale në Komunë – kryetari i Komunës **z. Gazmend Muhaxheri**
- Raport për gjendjen e sigurisë në Komunën e Pejës – **komandanti i Stacionit të Policisë z. Idriz Atashi**;

- Arsimi, gjendja në shkolla dhe situata e zhvillimit të procesit arsimor. – **DKA-së z. Naser Gega;**
- Shitja/Blerja e ushqimit të përditshëm, prodhim i pakontrolluar, datat e skaduara të prodhimeve – **Drejtoria e Inspeksionit,**
- Aktivitetet për pengimin e krijimit të deponive ilegale. Mbeturinat – Drejtoria e Inspeksionit, **znj. Edonjeta Berisha.**
- Dhuna në familje, mbrojtja e të drejtave të personave të cilët privohen nga të drejtat themelore – Qendra për Punë Sociale dhe **Znj. Ardita Bala** – drejtoreshë në Qendrën për Mirëqenien e Gruas, Pejë
- Identifikimi i brengave dhe shqetësimeve të qytetarëve lidhur me sigurinë publike – përfaqësuesja e KLSP-së, Nora Draga;
- Diskutime dhe Pyetje nga anëtarët e KKSBB-së;
- Konkludime, Rekomandime;

Takimin e hapi dhe e udhëhoqi koordinatori i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, z.Fatmir Asllani, i cili pasi e konfirmoi pjesëmarrjen, prezantoi rendin e ditës, i cili është aprovuar nga anëtarët e rregullt si dhe pyeti të pranishmit nëse kanë për të shtuar ndonjë tematikë shtesë ose ndonjë sygjërim, për t'a vendosur si pikë e rendit të ditës për t'u diskutuar në këtë takim.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka raportuar për gjendjen aktuale në Komunë.

Raportin për gjendjen e sigurisë në Komunën e Pejës e prezantoi Komandanti i Policisë z.Idriz Atashi.

Drejtori për Arsim në Komunën e Pejës, z.Naser Gega ka raportuar për gjendjen në shkolla, situatën e zhvillimit të procesit arsimor dhe sigurinë në shkolla.

Drejtoria e Inspeksionit prezantuan gjendjen e Shitje/Blerjes së ushqimit të përditshëm, prodhimi i pakontrolluar, datat e skaduara të prodhimeve dhe aktivitetin e tyre për parandalim dhe kontrollim.

Aktivitetet për pengimin e krijimit të deponive ilegale të mbeturinave, e prezantoi Drejtoresha e Inspeksionit, znj. Edonjeta Berisha.

Agim Mala-udhëheqës i shërbimit social pranë QPS-së në Pejë, foli për dhunën në familje dhe mbrojtja e të drejtave të personave të cilët privohen nga të drejtat themelore.

Nora Draga përfaqësuese e KLSP-së, foli për identifikimin e brengave dhe shqetësimeve të qytetarëve lidhur me sigurinë publike dhe bashkëpunimin me Policinë e Kosovës.

Diskutime dhe pyetje nga anëtarët e KKSBB-së.

Takimi i tretë, i kryesuar nga Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri, u mbajt më 20.06.2024, më këtë rend dite:

- Arritja dhe regjistrimi i anëtarëve të KKSBB-së;
- Hapja e mbledhjes së KKSBB-së nga ana e koordinators, prezentimi i rendit të ditës, procesverbalit të mbledhjes së kaluar dhe aprovimi – **z. Fatmir Asllani;**
- Fjala hyrëse dhe paraqitja e gjendjes aktuale në komunë - **z. Gazmend Muhaxheri,** kryetar i Komunës;
- Raport për gjendjen e sigurisë në territorin e komunës së Pejës - **z. Idriz Atashi,** komandant i Stacionit të Policisë në Pejë;

- Situata e zhvillimit të procesit arsimor si dhe përgatitjet për procesin e përmbylljes së vitit shkollor 2023/2024 - **z. Naser Gega**, drejtor i DKA-së;
- Informatë mbi punën e Këshillave Lokal të Sigurisë Publike në territorin e komunës së Pejës – Nora Draga, Ranko Bakić.

Takimin e hapi koordinatori i KKSB-së, z.Fatmir Asllani, i cili pasi e konfirmoi pjesëmarrjen e prezantoi edhe rendin e ditës, i cili u aprovua nga anëtarët e rregullt si dhe pyeti të pranishmit nëse kanë për të shtuar ndonjë tematikë shtesë ose ndonjë sygjërim, për t'a vendosur si pikë e rendit të ditës për t'u diskutuar në këtë takim.

Kjo mbledhje iu dedikua gjendjes specifike të sigurisë në territorin e Komunës së Pejës, situatës së zhvillimit të procesit arsimor, si dhe përgatitjeve për procesin e përmbylljes së vitit kalendarik shkollor 2023/2024.

Kryetari i komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të pranishmit, të cilët i njoftoi s'e me projektin e grantit të performancës, me DEMOS-in dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal janë 22 projekte dhe jemi orientuar kryesisht në trotuare dhe ndriçim publik për ta rritur sigurinë e qytetarëve, jemi të orientuar në fshatrat, të cilat lidhen me qytetin - Loxha, Novosella, Vitomirica, Llozhani, pastaj te Sharra me kriju një bazen tjetër pak më të madh, për rekreacion dhe freskim, rregullimi i kanalit të Çokolicës, ndërsa për qentë endacak e kemi zhvilluar procedurën, objekti ka avancu mjaft, ku do të trajtohen qentë, po ashtu është duke vazhduar impianti për trajtimin e mbeturinave në Sverkë, ujësjellësi i Lugut të Baranit do të lidhet te rrethi në Vitomiricë, ku do të bëhet lidhja kryesore edhe një tjetër është në rrugë të Zahaqit, ndërsa sa i përket rrugës së Rugovës ajo është në domenin e Ministrisë së Infrastrukturës, po ashtu theksoi s'e e kemi sfidë të madhe dëmtimin e rrugëve, që është duke u bërë nga "Hidrodrini" për t'i kryer punët dhe shpresojmë, që këtë javë do t'i përfundojnë punimet, sepse po ka gëcje në trafik.

Komandanti i Stacionit të Policisë në Pejë, z.Idriz Atashi ka raportuar për gjendjen e sigurisë në territorin e Komunës së Pejës.

Drejtori për Arsim në Komunën e Pejës, z.Naser Gega ka raportuar për situatën e zhvillimit të procesit arsimor, si dhe përgatitjet për procesin e përmbylljes së vitit shkollor 2023/2024.

Lidhur me punën e Këshillave Lokal të Sigurisë Publike në territorin e Komunës së Pejës ka raportuar znj.Nora Draga, ndërsa z.Ranko Bakić ka munguar për arsye shendetësore..

Në vazhdim anëtarët kanë paraqitur shqetësimet dhe kërkesat e tyre bazuar në nevojat e komuniteteve, që ata i përfaqësojnë.

Takimi i katërt, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB i kryesuar nga Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka mbajtur takimin e katërt më 19.09.2024.

Takimin e hapi koordinatori i KKSB-së, z.Fatmir Asllani, i cili pasi e konfirmoi pjesëmarrjen, prezantoi rendin e ditës duke thënë nëse pajtoheni më këtë rend dite që e keni pranuar edhe në email, mirëpo sot e keni edhe kopje fizike, nëse ka dikush ndonjë pikë shtesë rreth rendit të ditës, është momenti që tani ta paraqisni dhe ta aprovojme si pikë e rendit për diskutim sot. Sipas rregullores u aprovua rendi i ditës ku bashkangjitur është edhe procesverbali i takimit të kaluar.

Përveç raportimit të përgjithshëm të Kryetarit të Komunës së Pejës dhe Komandantit të Stacionit të Policisë në Pejë, ky takim ka trajtuar edhe çështje të caktuara si:

1. Fillimi i procesit të të mësuarit me theks të veçantë përgatitjet e fillimit të vitit shkollor 2024/2025.

2. Masat parandaluese dhe sensibilizimi i qytetarëve për pasojat nga zjarri gjatë periudhës së korrije-shirjeve dhe djegieve të pyjeve.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka raportuar në mënyrë të detajuar për gjendjen aktuale në Komunën e Pejës, investimet, të cilat janë duke u kryer, rreth projekteve, rrugëve, të cilat i ka përfunduar Komuna e Pejës deri më tani.

Komandanti i Stacionit të Policisë në Pejë, z.Idriz Atashi ka raportuar për gjendjen e sigurisë në territorin e Komunës së Pejës. Ka qenë një sezonë e qetë, pa incidente të mëdha, është një gjendje e qetë dhe e menaxhueshme, policia është aty ku kanë nevojë qytetarët e Kosovës. Unë do të raportojë për fazën tremujore (20qershor – 19 shtator) që e quajmë sezoni veror sepse në këtë kohë kemi planin operativ që e quajmë sezoni veror sepse në zonën tonë pëgjegjësisë, në komunën tonë vijnë edhe të gjithë bashkatdhetarët dhe krijohet pak a shumë një dyfishim i popullsisë. Në bazë të statistikave rezulton që ka një rënie të veprave penale, prezenca jonë ka qenë sepse ka pas aktivitete kulturore, aktivitete tjera dhe të gjitha këto aktivitete janë zhvilluar pa incidente. Qetë ishte edhe situata sa i përket ahengjeve e dasmave si dhe gjuajtjeve me armë zjarri, ndoshta kemi pas 3 ose 4 raste të cilat menjëherë janë zbulu dhe janë marrë masa ndaj tyre, ku armët janë konfisku. Poashtu kemi pas takime me pronarë të restoraneve që organizojnë dasma dhe ahengje, ku edhe ata kanë kontribu që të jetë një situatë më e qetë sa i përket kësaj dukuria. Në përgjithësi policia ka qenë prezente në të gjitha zonat e territorit të komunës së Pejë edhe në bashkëpunim me qytetarët kemi pas edhe informacione të cilat na kanë ndihmu në kryerjen e detyrave tona, çka e vlerësoi bashkëpunimin qytetarë-polici sepse e përbën suksesin e sigurisë për të gjithë ne.

Tash fillojmë me planin operativ për të gjitha shkollat, ku policia është prezente që të kemi siguri sa më të madhe për nx. tonë. Prezent policia janë edhe në stacionin e autobusave aty ku bëhen udhëtimet që bëhet një tollovi më e madhe e nxënësve. Në përgjithësi policia vazhdon me plane operative duke fillu prej sigurisë në trafik, siguria në shkolla, parandalimi i vjedhjeve janë këto plane në vazhdimësi që kanë njësitet e caktuara me detyra konkrete edhe bëjnë hetimin edhe parandalimin e këtyre veprave penale.

Kërkesat tona si polici është që projekti i markimit të fillojë mirë me markime të kalimeve këmbësore, të bëhet përcaktimi i vendeve të vendkalimit të këmbësoreve sepse përcaktimi i mirë dhe profesional i këtyre vija i parandalon dukuritë negative në trafik dhe ofron siguri më të madhe për këmbësor. Besoj që do të vazhdojmë me këtë projekt nëse operatori ka mjete.

Projekti i kamerave poashtu është një projekt i rëndësishëm, ka problem, ka ngecje e që neve funksionalizimi i tyre na hyn në punë shumë edhe na ndihmon, ish dashtë që me e gjetë një formë të re dhe me e përfundu.

Disa nga raportimet-statistikat, në këtë periudhë, që ne e quajmë sezoni veror:

- Në total kemi pas 641 vepra në përgjithësi, vrasje nuk kemi pas, tentim vrasje kanë qenë 2vepra penale, lëndim i lehtë trupor 45 vepra, lëndim i randë trupor 2 vepra, vepra penale kundër narkotikëve dhe sub. tjera narkotike kanë qenë 13, uzurpim i pronës kanë qenë 3 vepra, vjedhje 67 dhe vjedhje e rëndë 43, grabitje nuk kemi pas, armë të konfiskuara gjatë kësaj periudhe 20 e 318 fishekë, incidente në shkolla duke e përfshirë periudhën e qershorit kanë qenë 16 incidente, dhunë në familje 66 vepra, incidente më dëme material 151, të cilat kanë qenë më dëme të vogla material, protesta skemi pas, asistim në gjykatë 223, kuvendin komunal e kemi asistim me 4raste, asistim të institucioneve tjera: KEDS,AKP, përmbarues kanë qenë 26, persona të ndaluar në Qendrën tonë të paraburgimit 121, ndërsa urdhëresa të realizuara në total kanë qenë 211, gjoba të shqiptuara për këtë periudhë kanë qenë 3201. Komandanti tha kjo është një pasqyrë e

veprave me të cilat dmth policia është marrë dhe ka paraqitë kallzime penale dhe kundërvajtëse.

Drejtori për Arsim në Komunën e Pejës, z.Naser Gega ka raportuar për fillimin e procesit të të mësuarit, me theks të veçantë përgatitjet e fillimit të vitit shkollor 2024/2025.

Lidhur me përgatitjet për fillim viti shkollor, besoj që kryetari tha mjaft të gjitha ato investime, të gjitha ato punë që janë duke u bërë gjithandej në shkolla në komunën tonë, vërtetë janë për çdo lavdatë. Përgaditjet teknike kanë shkuar mirë, kanë mbetur dy salla të edukatës fizike, njëra në Treboviq është para përfundimit dhe tjetra në Gllogjan posa ka fillu. Ajo që është më e rëndësishme janë bërë përgatitjet te shkollat për nxemje, janë kry ofertat për furnizim me dru dhe pelet për ngrohje të shkollave, dmth është një problem i kryer dhe furnizimi nëpër shkolla është duke u kryer.

Është formuar komision për shqyrtimin e kërkesave për transportin e nxënësve sipas ligjit për arsim parauniversitar dhe gjithpërfshierje. Sipas ligjit jemi të obliguar që gjithë ata nxënës që udhëtojnë mbi 4km të ua kompenzojmë udhëtimin me derivate, ngajshëm ndodh edhe më fëmijët me nevoja të veçanta të cilët shkojnë nëpër shkolla gjegjëse, në këtë rast nuk ka kriter 4km por e kanë mbështetjen vazhdimisht, komisioni është duke u marrë me këtë çështje.

Është bërë plotësimi i normave, orëve të punës të të gjithë mësimitdhënësve poashtu edhe të mësimitdhënësve të cilët kanë ngel pa orë për shkak të mbylljes së dy paraleleve të ndara në fshatin Broliq dhe Dobërdol. Numri i nxënësve në viset rurale është duke rënë vazhdimisht. Përpjekjet tona mbasin që t'i sistemojmë këta mësimitdhënës, jemi duke e bërë më të mirën të mundshme që këta mësimitdhënës t'i sistemojmë. Risistemi i tyre varet nga performanca çfare e kanë dhe jo mbas stazhit të punës (kështu e thotë ligji).

Furnizimi i nx. me texte shkollore është gati në përfundim.

Në të gjitha shkollat regjistrimi në kl. e parë dhe kl. e dhjetë ka përfunduar me sukses.

Numrin total të nx. në shkolla nuk mundem me e dhënë tash se janë duke u ripërpunuar të dhënat në sistemin SIA dhe në afatin më të shkurtër, kur t'i kemi ato të gatshme ato do t'i prezentojmë para jush.

Duke marrë parasysh që komuna e Pejës është e predispozuar nga rreziqet e mundshme, siç janë: zjarri, reshjet intensive – vërshimet dhe erërat e forta, kjo për shkak të pozitës gjeografike ku jemi të rrethuar nga bjeshkët e Rugovës, tha Drejtori i Emergjencave në Komunën e Pejës, z.Gëzim Gashi. Z.Gashi më tej ka raportuar për masat parandaluese dhe sensibilizimin e qytetarëve për pasojat nga zjarri gjatë periudhës së korrije-shirjeve dhe djegieve të pyjeve. Vetëm gjatë muajve korrik, gusht kemi pasur rreth 218 raste zjarri, kryesisht zjarre fushore. Poashtu vlen të cekem dy raste të zjarreve që kanë qenë në zonat malore, saktësisht në bjeshkën e Rugovës, në fshatin Liqenat afër liqenit dhe tjetra në bjeshkët e Lipës, në vendin e ashtuquajtur Maja e Hasanit.

Përfaqësuesja e KLSP-së znj. Nora Draga, pasi përshëndeti të pranishmit, tha

- Dua të filloj me disa aspekte pozitive që i kemi përfunduar si Komitet Lokal për Siguri Publike, kemi pasur vazhdimisht aktivitetet që kanë të bëjnë me çështjen e sigurisë, diçka që dua t'a veçoj është se po organizojmë një aktivitet për Ditën e Paqes, ky aktivitet i mbledh të gjithë përfaqësuesit dhe iu bëj thirrje të gjithëve që të jemi bashkë në një panel diskutimi në qendër të qytetit për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Paqes.
- Një sfidë që po na shqetëson të gjithëve, në veçanti prindërit, është përdorimi i mjeteve të ftohta nga të rinjtë, kështu që unë kisha kërkuar, edhpse vazhdimisht jemi me policinë por kisha kërkuar edhe nga komuna që të kemi një fuqizim ose edhe një sigurim më shumë ndaj të rinjve e sidomos fëmijëve për shkak se duhet të kontrollohen që të mos përdoren

mjetet e ftohta në shkollë sepse kjo po e cenon sigurinë e të gjithëve. Nevojitet një koordinim akoma ma shumë edhe nëpër qendra rinore, sidomos në Qendrën Rinore në Dardani, që të ketë akoma ma shumë pjesë të stafit, padyshim të policisë dhe komunës për shkak se po ka të rinj që po bëjnë aktivitete jo aq të mira jashta Qendrës, t'i identifikojmë dhe parandalojmë në kohë.

Takimi vazhdoi edhe me shqetësimet dhe kërkesat e disa nga anëtarët e tjerë bazuar në nevojat e komuniteteve, që ata i përfaqësojnë.

Takimi i pestë, më dt. 23.10.2024, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB i kryesuar nga Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka mbajtur takimin e pestë për vitin 2024.

Takimin e hapi Koordinatori i KKSBB-së, z.Fatmir Asllani, i cili pasi e konfirmoi pjesëmarrjen e prezantoi rendin e ditës:

- Arritja dhe regjistrimi i anëtarëve të KKSBB-së;
- Hapja e mbledhjes së KKSBB-së nga ana e koordinatorit, prezentimi i rendit të ditës, procesverbalit të mbledhjes së kaluar dhe aprovimi – **z. Fatmir Asllani**;
- Fjala hyrëse dhe paraqitja e gjendjes aktuale në territorin e komunës së Pejës - **z. Gazmend Muhaxheri**, kryetar i Komunës;
- Raport për gjendjen e sigurisë në territorin e komunës së Pejës - **z. Idriz Atashi, komandant i Stacionit të Policisë në Pejë**;
- Siguria në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme. Angazhimet në parandalimin e sjelljeve devijuese dhe dhunës në shkollat e komunës së Pejës, me theks të veçantë në shkollat e mesme. Transporti në viset rurale (bartja e nxënësve) - **z. Naser Gegaj**, drejtor në Drejtorinë Komunale të Arsimit;
- Mbikëqyerja e vazhdueshme e lokaleve – kafiterive, veçanarisht ato që ekzistojnë afër objekteve shkollore, ku mundësitë për trafikim me substancë narkotike janë më të mëdha – Drejtoria e Inspektionit, znj. Edonjeta Berisha, drejtoreshë;
- Raporti i progresit dhe ecuria e aktivitetit të prokurimit për kamerat e qytetit dhe të ngjajshme në fushën e kamerave të sigurisë, përfshirë sigurimin fizik të:
 1. Objekteve shkollore,
 2. Objekteve të komunës si dhe objekteve rekreative, kulturore, sportive etj. – Administrata e Përgjithshme, sektori për Teknologji Informativ, z. Labinot Dizdari - udhëheqës i sektorit;
- Promovimi i vlerave të multietnicitetit dhe bashkëjetesës në vendbanimet ku jetojnë komunitetet e përziera – **Miodrag Dašić**, përfaqësues i komunitetit serb në Brestovik, **Maja Srbljak** - përfaqësuese e komunitetit serb në Gorazhdec, **Mersiha Adroviq**, përfaqësuese e komunitetit boshnjak, **Dijana Sefaj** - përfaqësuese e komunitetit egjiptian, **Hatixhe Muça** - përfaqësuese e komunitetit rom, **Ardita Bala** – përfaqësuese e shoqërisë civile, **Fatlinda Radi** – përfaqësuese e komunitetit për komunitete,

i cili u aprovua nga anëtarët e rregullt.

Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka raportuar për gjendjen aktuale në Komunën e Pejës. Janë 23 procedura të prokurimit, që i kemi dhe disa projekte të ndryshme me

grantin e performancës, ku 12-të prej tyre janë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 11-të të tjera janë në bashkëpunim me DEMOS-in, prej të gjithave 21 janë duke u zhvillu.

Drejtori për Arsim në Komunën e Pejës, z.Naser Gega ka raportuar për sigurinë në shkolla, përdorimin e substancave narkotike, bartjen e mjeteve të rrezikshme, angazhimet në parandalimin e sjelljeve devijuese dhe dhunës në shkollat e Komunës së Pejës me theks të veçantë në shkollat e mesme, si dhe transportin e nxënësve në viset rurale.

Drejtoresha e Inspektionit në Komunën e Pejës, znj.Edonjeta Berisha ka raportuar për mbikëqyrjen e vazhdueshme të lokaleve dhe të kafiterive, veçanërisht ato, që ekzistojnë afër objekteve shkollore, ku mundësitë për trafikim me substanca narkotike janë më të mëdha.

Administrata e Përgjithshme - Sektori për Teknologji Informative - Udhëheqësi i Sektorit, z.Labinot Dezdari ka raportuar për progresin dhe ecurinë e aktivitetit të prokurimit për kamerat e qytetit dhe të ngjashme në fushën e kamerave të sigurisë, përfshirë sigurimin fizik të objekteve shkollore, objekteve të komunës, si dhe objekteve rekreative, kulturore, sportive etj.

Ndërsa për promovimin e vlerave të multietnicitetit dhe bashkëjetesës në vendbanimet ku jetojnë komunitetet e përziera ka folur përfaqësuesja e komunitetit egjiptian, znj.Diana Sefaj si dhe përfaqësuesja e shoqërisë civile, znj.Ardita Bala.

Takimi vazhdoi edhe me shqetësimet dhe kërkesat e disa nga anëtarët e tjerë bazuar në nevojat e komuniteteve, që ata i përfaqësojnë.

Takimi i gjashtë. - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), i kryesuar nga Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka mbajtur takimin e gjashtë dhe të fundit për këtë vitin 2024, më dt. 06.12.2024.

Takimin e hapi Koordinatori i KKSBB-së, z.Fatmir Asllani, i cili pasi e konfirmoi pjesëmarrjen e prezantoi rendin e ditës:

- Arritja dhe regjistrimi i anëtarëve të KKSBB-së;
- Hapja e mbledhjes së KKSBB-së nga ana e koordinatorit, prezentimi i rendit të ditës, procesverbalit të mbledhjes së kaluar dhe aprovimi – **z. Fatmir Asllani;**
- Fjala hyrëse dhe paraqitja e gjendjes aktuale në territorin e komunës së Pejës - **z. Gazmend Muhaxheri**, kryetar i komunës;
- Vlerësimi mbi çështjen e sigurisë në territorin e komunës së Pejës - **z. Idriz Atashi, komandant i Stacionit të Policisë në Pejë;**
- Riintegrimi i personave të riatdhesuar - informatë nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim – **znj. Anela Hukiq;**
- Projektet për kthim dhe riintegrim të të kthyerve si dhe stabilizim të komuniteteve - informatë nga **Albiana çavolli, përfaqësuese në IOM;**
- Mbrojtja e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale dhe familjare si dhe mbrojtja dhe ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje deri në riintegrim të viktimës – **Drejtorja e Mirëqenies Sociale –znj. Albulena Mujaj Bajraktari, Qendra për Mirëqenien e Gruas – znj. Ardita Bala;**
- Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit, ndriçimi publik – **Drejtorja e Shërbimeve Publike – z. Agron Nikqi;**
- Marrja e masave parandaluese për mënyrën e përdorimit të mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit – **Drejtorja e Inspektionit, znj. Edonjeta Berisha;**

- Informatë për promovimin e vlerave të multietnicitetit dhe bashkëjetesës në vendbanimet ku jetojnë komunitetet e përziera:
- **Miodrag Dašić** - përfaqësues i komunitetit serb në Brestovik,
- **Maja Srbljak** - përfaqësuese e komunitetit serb në Gorazhdec,
- **Mersiha Adroviq** - përfaqësuese e komunitetit boshnjak,
- **Hatixhe Muça** - përfaqësuese e komunitetit rom,
- **Fatlinda Radi** – përfaqësuese e komunitetit për komunitete.

i cili u aprovua nga anëtarët e rregullt.

Fjalë hyrëse e mori kryetar i komunës z. Gazmend Muhaxheri, i cili prezantoi e gjendjen aktuale në territorin e Komunës së Pejës.

Komandant i Stacionit të Policisë në Pejë z. Idriz Atashi, prezantoi vlerësimin mbi çështjen e sigurisë në territorin e Komunës së Pejës.

Nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim zyrtarja Anela Hukiq, prezantoi informatën për procedurat e riintegrit të personave të riatdhesuar.

Nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale, për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë për shërbimet sociale dhe familjare si dhe mbrojtja dhe ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje deri në riintegrim të viktimës foli zyrtari Durim Kelmendi.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, drejtori Agron Nikqi, prezantoi gjendjen në terren, mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit, ndriçimi publik dhe tema të tjera për infrastrukturën.

Nga Drejtoria e Inspeksionit, drejtoresha Edonjeta Berisha tregoi për marrjen e masave parandaluese për mënyrën e përdorimit të mjeteve piroteknike gjatë festave të fund-vitit/2024.

Pati edhe prezantime dhe informata nga përfaqësuesit e minoriteteve për promovimin e vlerave të multietnicitetit dhe bashkëjetesës në vendbanimet ku jetojnë komunitetet e përziera.

Në vazhdim anëtarët kanë paraqitur shqetësimet dhe kërkesat e tyre bazuar në nevojat e komuniteteve, që ata i përfaqësojnë.

**Me respekt, koordinatori i KKSB-së
z. Fatmir Asllani, nënkryetar!**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në naze të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli I.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i komunës më datën 09.01.2025, merr këtë:

K o n k l u z i o n

1. **I propozohet** Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrton dhe t'ia rekomandon për Kuvend informatën e Kryetarit për Gjendjen Ekonomiko-Financiare të Komunës së Pejës.
2. Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Konkluzioni dërgohet:
Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
Anëtarëve të KPF, dhe
Arhives

I.nr. 100 0 11703 / 2025
Pejë, 09 janar 2025

KOMUNA E PEJËS





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEÇ



ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli nr .01-016/01-41343/20 i datës 20 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri me 09.01.2025, merr këtë,

K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrtoj dhe t'ia rekomandon për Kuvend Informatë e Kryetarit mbi Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2025.

Konkluzioni dërgohet,

- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të KPP, dhe
- Arhives

KOMUNA E PEJËS

I nr.400 01.1697 / 2025
Pejë, 09 janar 2025



Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli nr .01-016/01-41343/20 i datës 20 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri me 09.01.2025, merr këtë,

K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrtoj dhe t'ia rekomandon për Kuvend raportin e punës së Kryetarit për vitin 2024.

Konkluzioni dërgohet,

- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të KPP, dhe
- Arhives

Lnr.400 01/1719 / 2025
Pejë, 09 janar 2025

KOMUNA E PEJËS





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës nr.01/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri, më 10.01.2025, pas shqyrtimit të kërkesës të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa, merr këtë:

K o n k l u z i o n

I Propozohet Komitetit për Politik dhe Financa për shqyrtim raporti i informativ që i nijeti material të dërgohet në Kuvend për informim për anëtarët e kuvendit **Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Dhjetor 2024.**

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtoratit për Buxhet dhe Financa.

Konkluzioni dërgohet:

- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të KPP, dhe
- Arkives

I.nr. 100 01/2024 / 2025
Pejë, 10 janar 2025

KOMUNA E PEJËS





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEÇ



ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli nr .01-016/01-41343/20 i datës 20 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri me 09.01.2025, merr këtë,

K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrtoj dhe t'ia rekomandon për Kuvend Informatë mbi Planifikimin e Prokurimit për vitin 2025.

Konkluzioni dërgohet,

- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të KPP, dhe
- Arhives

KOMUNA E PEJËS

L.nr.400 01 1707 / 2025
Pejë, 09 janar 2025



Gazmend Muhaxheri
Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli I.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, më datën 16.01.2025, merr këtë:

K o n k l u z i o n

I propozohet Kuvendit Komunal në Pejë ta bëjë shqyrtimin e raportit të KKSBB-së për vitin 2024.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Shërbimi i Zyrës së Kryetarit të Komunës KK Pejë.

Konkluzioni i dërgohet:

- Kuvendit Komunal në Pejë
- Arhives

I.nr. 01/400/01-3501 2025
Pejë, 16 janar 2025

KOMUNA E PEJËS



Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ**



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 20 Janar 2025, në propozim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit të Komunës së Pejës të shqyrton informatën e kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të Komunës së Pejës, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

**I. Numër: 400-01/1703
Pejë, date: 20 Janar 2025**

**KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-**

**KRYESUESI KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj**





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takim të mbajtur me datë: 20 Janar 2025, në propozim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLUZION

I REKOMANDOHET Kuvendit të Komunës së Pejës të shqyrton informatën e kryetarit mbi planin e punës së ekzekutivit për 2025, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 400-01/1697
Pejë, date: 20 Janar 2025

KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-

KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj





**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ**



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë:30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 20 Janar 2025, në propozim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLUZION

I REKOMANDOHET Kuvendit të Komunës së Pejës të shqyrton informatën e kryetarit mbi raportin vjetor të Komunës së Pejës për vitin 2024, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

**I. Numër: 400-01/1719
Pejë, date: 20 Janar 2025**

**KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-**

**KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj**





**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ**



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 20 Janar 2025, në propozim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit të Komunës së Pejës të shqyrton raportin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2024, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

**I. Numër: 400-01/2124
Pejë, date: 20 Janar 2025**

**KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-**

**KRYESUES I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj**





**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ**



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 20 Janar 2025, në propozim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit të Komunës së Pejës të shqyrton informatën mbi planifikimin e Prokurimit për vitin 2025, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

**I. Numër: 400-01/1707
Pejë, date: 20 Janar 2025**

**KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-**

KRYESUES I KUVENDIT,

Z. Rexhep Kurtbogaj





**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ**



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 20 Janar 2025, në propozim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLUZION

I REKOMANDOHET Kuvendit të Komunës së Pejës të shqyrton informatën mbi raportin e KKSBB-së për vitin 2024, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

**I. Numër: 400/01-3501
Pejë, date: 20 Janar 2025**

**KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-**

**KRYESUES I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj**





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E PEJËS / OPŠTINA PEĆ / MUNICIPALITY OF PEJA



Raport Pune- 2024

Komiteti Konsultativ për Aftësin e Kufizuar

Në bazë të vendimit Nr.53-2023 mbi themelimin e Komiteteve Konsultative të Kuvendit të Komunës së Pejës, u përzgjedhën anëtarët e Komitetit Konsultativ për Aftësin e Kufizuar për mandat 4 vjeçar vitin e kaluar, dhe këtë komitet e përfaqësoj unë edhe në këtë mandat.

Ky komitet ka gjithsejt 7 anëtar që do të mundohemi të japim kontribut për personat me aftësi të kufizuar edhe gjatë këtij mandate.

Ne si komitet aritem të mbajm gjashtë takime ashtu siq parashihen sipas vendimit,dhe kësaj here kemi pregaditur një raport më të shkurt me disa rekomandime dhe disa lëvizje pozitive për personat me aftësi të kufizuara pasi që këtë komitet përfaqësojm.

‘‘Plani Strategjik për Përmirësimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare 2022-2024’’ u hartua nga një bashkëpunim i ngushtë në mes këtij Komiteti por me antarët e mandatit të kaluar, me Komunen e Pejës, Drejtoratin për Mirëqenie Sociale, Qendrës për Punë Sociale dhe organizatava që ofrojnë shërbime në Komunën tone, me mbështetje të OSCE-së, dhe pasi që ishte plan 2022-2024 ne kishim mundësi që edhe këtë vit të fokusohemi në aktivitetet mbrenda këtij plani.

Ky plan skadon pra në fund të këtij viti dhe kemi kërkuar prap mbështetjen nga OSCE, dhe janë dakord të na përkrahin për përpilimin e një plani strategjik 2025- 2027.

Duke u bazuar në këto dokumente që posedonim si komitet, vendosëm për vitin 2024 të fokusohemi në fushat e arsimit, punësimit, infrastrukturës dhe qëndrueshmëris së organizatave që ofrojn shërbime për këtë kategori.

Fusha e Arsimit;Sipas informatave të mblledhura si Komitet gjithëpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuar është në nivel të duhur, fillimisht duke u bërë vlerësimi i tyre nga Ekipi Vlerësues Pedagogjik dhe pastaj kyqja e tyre nëpër shkolla, po ashtu edhe ndihma e mësuesve mbështetës, por këtu kemi një problem tjetër sepse shumë herë kemi munges të materialit pedagogjik dhe mjete pune për të punuar me këta fëmi ku shumë shkolla ndodh që nuk kanë as letër të bardhë.... Po flasim për ciklin fillor që është obligative pastaj për shkollë të mesme nuk shprehin interesim për të vazhduar qoftë shkollën apo edhe ndonjë aftësim profesional të ndonjë fushe të caktuar.

Po ashtu nga ekipi është shqetësuese edhe femijët me epilepsi dhe rekomandim nga ekipi është që mësimmhënësit të trajnohen për dhënien e ndihmës së duhur në rast se ndonjë fëmij ka sulm

epileptik, dhe pos kësaj është shqetësuese edhe gjendja e fëmijëve me diabet, anetari i komitetit z. Idriz Ethem i njohur edhe përfaqësues i Shoqatës na njoftoi se deri tani janë të identifikuar 48 fëmijë me diabet në shkollat e Pejës dhe duhem sa më shpejtë që në shkollat të fillojmë me fushatë vetëdijësuese për diabet.

Punësimi; Sa i përket punësimit gjatë vitit 2024 kemi gjithësejt 6 persona me aftësi të kufizuara të punësuar duke ju falënderuar një bashkëpunimi të ngushtë të Komitetit me organizatat që ofrojnë shërbime në Komunën e Pejës dhe me disa biznese.

Te kompania ‘‘Ujë Rugove’’ një i punësuar nga ‘‘Handikos’’

Te kompania ‘‘Devolli Café’’ një i punësuar nga ‘‘Handikos’’

Te ‘‘Hotel Dugagjini’’ një i punësuar nga ‘‘Shoqata e Diabetit’’

Te kompania ‘‘Eko Sig’’ në bashkëpunim me Komunën dhe organizatën ‘‘Qendra për Jetë të Pavarur’’ tre persona të punësuar.

Kjo vlerësohet si një arritur duke pasur parasysh që në vitin 2023 nuk kemi pas asnjë të punësuar me AK. Ne nuk do të ndalemi me kaq, do të avokojmë që ky numër të rritet në vitet në vazhdim por na duhet një bashkëpunim me Inspektoriatin e Punës dhe ATK-në, që të kontrollohen bizneset në lidhje me zbatimin e ligjit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Infrastruktura; Akoma është problem në shumë vende të qytetit duke filluar nga trotuarët e larta, trotuarët me vetura të parkuara, pastaj mungesa e pjerinave nëpër institucione, shenjat sinjalizuese etj.

Për pjerinat disa vende arsyetohen se objekt i vjetër p.sh ‘‘Posta-PTK’’ gjysmën e shkallëve mund ta shëndrojmë në një pjerin sepse ka mjaft gjësi, apo objektet kur nuk kanë hapësirë për dy toaleta-WC një për P.A.K dhe një për të tjerët, atëherë pse nuk e bënë vetëm një për personat me aftësi të kufizuara që ato mund ta shfrytëzojnë të gjithë kurse ato që janë të ndërtuara për ne ata nuk mund ta shfrytëzojnë,

Toaletet- WC që ndërtohen sipas standardeve për aftësi të kufizuara mund ta përdorim të gjithë jo vetëm me aftësi të kufizuara por edhe një i moshuar apo një grua shtatzënë qoftë mbrenda hoetlit, Institucioneve apo kudo tjetër!

Kur jemi tek infrastruktura, objektet shkollore janë të vjetra dhe nuk kanë ashensor dhe nxënësi po kyqet në mësim shkon deri në klasën e 6-të, nuk ka asnjë problem sepse ka mësuesen mbështetëse dhe është në katin e parë, por kur del në klasën e gjashtë dhe tutje disa nga lëndët i kanë kabinetet në katin e dytë dhe ky nxënës nuk është aktiv në atë lëndë mësimore mbrenda kabinetit sepse e ka të pamundur qasjen.

Qëndrueshmëria e organizatave që ofrojnë shërbime për këtë kategori; Organizatat janë në gjendje të rëndë financiare , kjo sepse në dhjetor të vitit që lam pas shumë organizata në Kosovë kanë përfunduar programet dhe projektet e donatorëve ndërkombëtar në mbështetje të shërbimeve sociale dhe kështu duke krijuar zbrazëtira të mëdha të financimit për shërbime ato u mbyllën, dhe kjo për shkak të jo-financimit të qëndrueshëm nga Institucionet Publike, disa prej tyre reduktuan shërbimet, disa prej tyre reduktuan numrin e përfituesve e disa u mbyllën tërësisht.

Në mungesë të shërbimeve sociale fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuar do mbesin të izoluar në shtëpi dhe do pësojnë regres në zhvillimin e tyre fizik, psikologjik dhe emocional dhe jo vetëm sepse kjo situatë do të rëndojë edhe gjendjen ekonomike dhe emocionale të familjeve të cënueshme të cilët do të detyrohen të marrin shërbime me pagesë në ordianca private e jo të gjithë e kanë mundësinë për këto shërbime me pagesë.

Me mbylljen e organizatave të specializuara për shërbime të cilat janë të pajisura me mjete pune, program dhe staf profesional dhe të licencuar për ofrimin e shërbimeve rrezikohet edhe humbja e stafit profesional në të cilin është investuar ndër vite përmes ngritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve të ndryshme, të vazhdueshme si në vend dhe jashtë saj nga ekspert ndërkombtar.

Dhe në fund fare rekomandim nga ky Komitet për Komunen e Pejës, Kuvendit Komunal, Drejtorive përkatëse që të planifikojnë buxhetin e mjaftueshëm për zbatimin e ligjit të ri për "Shërbime sociale dhe familjare në mbështetje të kategorive të cënueshme të popullatës dhe në nevojë për shërbime të specializuara".

Ky komitet rekomandon që krahas planifikimit të shiqohen mundësi ligjore që nga subvencionimi të kalohet në kontraktim/ blerje të shërbimeve sociale dhe familjare si në formë/ praktike e vlerësuar më efektive për të siguruar qëndrueshmërinë financiare!

Na duhet një punë e madhe për ndryshime por të fillojmë nga më të voglat hap pas hapi.

Po ashtu për fund gjithsecili nga ne ta dimë rëndësinë e këtij komiteti e sidomos organizatave që ofrojnë shërbime sepse nga këto shërbime përfitojmë të gjithë ne, fillimisht përfiton fëmija dhe familja direkt por indirekt përfiton e gjithë shoqëria duke u socializuar, duke u aftësuar për jetë apo edhe duke u punësuar.

Të veprojmë për fëmijët e këtij qyteti për banorët e këtij qyteti sepse të gjithë kemi të drejtë të barabarta dhe këto të drejta i duam edhe me vepra dhe jo vetëm me fjalë.

Me respekt

Kryesuesja e Komitetit Konsultativ për Aftësinë e Kufizuar

Fitore Haxhihasani



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË
- Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit.-
Numër:
Pejë, datë: 06.Janar .2025.

KRYESUESIT TË KUVENDIT KOMUNAL PEJË

Për

KUVENDIN KOMUNAL PEJË

RAPORTI I PUNËS

SË KOMITETIT KOMUNAL PËR MBROJTJEN E AMBIENTIT TË KK. PEJË, PËR VITIN 2024.

- Historiku :

Kuvendi komunal Pejë, bazuar në nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.16/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna të datës 21.10.2016, ka publikuar Konkursin Numër:112/01-19584 dt.01. Mars 2023, për anëtarë të Komiteteve Konsultative dhe atë:

- 1.Komitetin Konsultativ për Zhvillim Ekonomik (7 anëtarë),
2. Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit (7 anëtarë) dhe
3. Komitetin Konsultativ për Përsona me Aftësi të Kufizuara (7 anëtarë). Me ç'rast ka përcaktuar edhe kushtet konkrete për përzgjedhjen e aplikuesve në konkursin në fjalë.

Kuvendi me rastin e publikimit të konkursit ka përcaktuar edhe Panelin përzgjedhës konform Udhëzimit Administrativ të lartëshenuar.

Kuvendi Komunal Pejë, në seancen e rregullt të mbajtur me datë: 27.Korrik 2023, me propozim të Panelit përzgjedhës miraton Vendimin Nr.53/2023 mbi themelimin e

Komiteteve Konsultative të Kuvendit të Komunës në përbërje prej 7 (shtatë) anëtarësh, me mandat 4 (katër) vjeçar.

Komitet Komunal Për Mbrojtje e Ambientit, ka mbajtuar seancën konstituive me datën:12. 09. 2023, në ora 11,00 në sallën e takimeve të KPF-ca të KK.Pejë.

Pas konstituimit Komiteti Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit, i është qasur punës në realizimin e obligimeve që rrjedhin nga fushëveprimi i saj të përcaktuara me ligjet në fuqi dhe Rregullorën komunale.

Në janar të vitit 2024, Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit paraqet raport me gojë dhe me shkrim për punën e tij në periudhën raportuese për vitin 2023, që është obligim ligjor i komitetit për raportim në kuvend.

- **Raport për punën e KKMA-për vitin 2024 .-**

KKMA. në periudhën raportuese 2024, ka mbajtur: 7 (shtatë) mbledhje të rregullta si vijon:

- 1. Mbledhjen e I. (parë) të rregullt me datë: 31. Janar 2024,**
- 2. Mbledhjen e II. (dytë) të rregullt me datë: 29. Mars 2024,**
- 3. Mbledhjen e III. (tretë) të rregullt me datë: 17. Prill 2024,**
- 4. Mbledhjen e IV. (katërt) të rregullt me datë: 16. Maj 2024,**
- 5. Mbledhjen e V. (pestë) të rregullt me datë: 19. Qershor 2024,**
- 6. Mbledhjen e VI. (gjashtë) të rregullt me datë: 29.Korrik 2024 dhe**
- 7. Mbledhjen e VII. (shtatë) të rregullt me datë: 18. Nentor 2024.**

Komiteti ka planifikuar të mbaj edhe takime të tjera, por për shkak të angazhimeve të anëtarëve të komitetit dhe pamundësisë së sigurimit të pjesëmarrjes së përfaqësuesve përkatës të institucioneve përgjegjëse nuk ka arrit ti realizoi. Por sidoqoft, janë përmbushur obligimet ligjore dhe planifikimi i parapar me udhëzime administrativ dhe ligjet në fuqi. Sidoqoft komiteti nuk ka arritur të plotësoj 100% objektivat e veta, por sërish mund të konkludohet se objektivat janë përmbushur në masën e duhur.

Komitetei në takimet e lartëshenuara ka shqyrtuar çështje të ndryshme nga fushveprimtarija e mbrojtjes se ambientit - mjedisit. Ka komunikuar dhe bashkëpunuar ngusht me Drejtorin për Urbanizëm dhe zyrtaren për mbrojtjen e ambientit, me OJQ-në Let's Do It Peja, tani OJQ me emërtim të ri "Rilindja e Gjelber" Pejë, me Agjencionin për mbrojtjen e pyjeve, me Drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, me Drejtorin për Punës Komunale e Shërbime Publike, Drejtorin e Inspektionit, me Ndërmarrjen Rajonale "Hidrodrini" me NPL."Ambienti" sh.a. Pejë, me përfaqësues të NPL."EKOSIG"sh.a. përfaqësuesit e të cilëve janë ftuar dhe kanë marë pjesë në takimet e punës së KKMA, dhe kanë dhënë kontributin e tyre me rastin e trajtimit të temave të

ndryshme nga përgjegjësia e tyre dhe KKMA.-të (siq janë: mbrojtja e ambientit, cilësia e ajrit, cilësisë së ujit të pijës, ujrave sipërfaqesori, gjendjen dhe rregullimin e kanaleve të ujitjes e kanalëve tjera, grumbullimin e mbeturinave, selektimin e tyre dhe riciklimin, ujrata e zeza, mirëmbajtjen e gjelbrimit, mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale, nga zjarret e çështjeve tjera nga fusha në fjalë).

Komiteti në fillim të vitit raportues, ka miratuar Kalendarin e Takimeve të KKMA.-it për vitin 2024 si dhe ka miratuar Planin e Punës së KKMA, për vitin 2024. Sipas të cilit ka punuar gjatë vitit 2024..

Anëtarët e komitetit në forma të ndryshme kanë marrë pjesë në aktivitete për mbrojtjen e ambientit, kanë përcjell gjendjen në teren dhe mangësit evidente i kanë prezantuar në takime të komitetit dhe kanë sugjeruar marrjen e masave në eliminim e tyre, si psh. nga NPL” Ambienti” sh.a . e KK. Pejë, është kërkuar menaxhim më i rregullt i mbeturinave, seleksionimi dhe krijimi i kushteve për riciklimin e tyre. Vendosi e kontejnerëve për mbeturina në hapsira të caktuara ku ato mungojn, shtimin e numrit të tyre, pastaj kanë paraqitur si problem madhor edhe çështjen e qenëve endacak në Komunën e Pejës, që është problem që po paraqet vëllshirësi të madhe dhe sidomos në këtë periudhë të dimrit kur ata edhe më shumë egërsohen qoftë nga i ftohti apo mungesa e ushqimit etj. Edhe pse ky problem nuk është problem ekskluziv për zgjedhje në nivel lokal, por kërkohet ndërgjegjësim të përgjegjësve nga niveli qendror që ky problem të zgjidhet apo së paku të zbutet me masa që duhet ndërmarë në këtë drejtim nga niveli qendror në bashkëpunim me komunën e Pejës. Komiteti njikohësisht ka bashkëpunuar me Drejtoratin e Zhvillimit Ekonomik lidhur me Projektin “Nera”, si dhe ka shpalosur sfida të ndryshme me të cilat ballafaqohemi në përditshmeri, me institucione komunale dhe institucionet tjera përgjegjëse.

Sidoqoftë, janë zhvilluar dhe duhet të zhvillohen aktivitete të tjera qoftë nga komiteti, qoftë nga institucionet komunale, sidomos në eliminimin e ndotësve të ujrave nga individ apo subjekte juridike, ndotësve të ambienteve gjelbëruese, shtretërve të lumenjeve me hudhje të mbeturinave të ndryshme në kohra kur hapsirat gjelbëruese kanë qenë të frekuentuara nga qytetarët duke aluduar tek ta në ndërgjegjësim për mbrojtje të ambientit në tërësi e sidomos aty ku veprojmë dhe jetojmë. Duhet trajtuar edhe ndotjen e ajrit, akustiken, mbrojtje e pyjeve nga prerjet pa kontroll etj. Aktivitete këto dhe të tjera do të jenë përmanent çështje vigjilence nga ana e komitetit në bashkëpunim me subjektet e tjera përgjegjëse institucionale në Komunën e Pejës dhe më gjërë.

Pejë, Janar 2025.

Komiteti Komunal për Mbrojtje të Ambientit,
K r y e s u e s j a,
Valbona Avdijaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË
- Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit.-
Numër:
Pejë, datë: 06.Janar .2025.

KRYESUESIT TË KUVENDIT KOMUNAL PEJË

Për

KUVENDIN KOMUNAL PEJË

RAPORTI I PUNËS

SË KOMITETIT KOMUNAL PËR MBROJTJEN E AMBIENTIT TË KK. PEJË, PËR VITIN 2024.

- Historiku :

Kuvendi komunal Pejë, bazuar në nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.16/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna të datës 21.10.2016, ka publikuar Konkursin Numër:112/01-19584 dt.01. Mars 2023, për anëtarë të Komiteteve Konsultative dhe atë:

- 1.Komitetin Konsultativ për Zhvillim Ekonomik (7 anëtarë),
2. Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit (7 anëtarë) dhe
3. Komitetin Konsultativ për Përsona me Aftësi të Kufizuara (7 anëtarë). Me ç'rast ka përcaktuar edhe kushtet konkrete për përzgjedhjen e aplikuesve në konkursin në fjalë.

Kuvendi me rastin e publikimit të konkursit ka përcaktuar edhe Panelin përzgjedhës konform Udhëzimit Administrativ të lartëshenuar.

Kuvendi Komunal Pejë, në seancen e rregullt të mbajtur me datë: 27.Korrik 2023, me propozim të Panelit përzgjedhës miraton Vendimin Nr.53/2023 mbi themelimin e

Komiteteve Konsultative të Kuvendit të Komunës në përbërje prej 7 (shtatë) anëtarësh, me mandat 4 (katër) vjeçar.

Komitet Komunal Për Mbrojtje e Ambientit, ka mbajtuar seancën konstituive me datën:12. 09. 2023, në ora 11,00 në sallën e takimeve të KPF-ca të KK.Pejë.

Pas konstituimit Komiteti Konsultativ për Mbrojtje të Ambientit, i është qasur punës në realizimin e obligimeve që rrjedhin nga fushëveprimi i saj të përcaktuara me ligjet në fuqi dhe Rregullorën komunale.

Në janar të vitit 2024, Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit paraqet raport me gojë dhe me shkrim për punën e tij në periudhën raportuese për vitin 2023, që është obligim ligjor i komitetit për raportim në kuvend.

- **Raport për punën e KKMA-për vitin 2024 .-**

KKMA. në periudhën raportuese 2024, ka mbajtur: 7 (shtatë) mbledhje të rregullta si vijon:

- 1. Mbledhjen e I. (parë) të rregullt me datë: 31. Janar 2024,**
- 2. Mbledhjen e II. (dytë) të rregullt me datë: 29. Mars 2024,**
- 3. Mbledhjen e III. (tretë) të rregullt me datë: 17. Prill 2024,**
- 4. Mbledhjen e IV. (katërt) të rregullt me datë: 16. Maj 2024,**
- 5. Mbledhjen e V. (pestë) të rregullt me datë: 19. Qershor 2024,**
- 6. Mbledhjen e VI. (gjashtë) të rregullt me datë: 29.Korrik 2024 dhe**
- 7. Mbledhjen e VII. (shtatë) të rregullt me datë: 18. Nentor 2024.**

Komiteti ka planifikuar të mbaj edhe takime të tjera, por për shkak të angazhimeve të anëtarëve të komitetit dhe pamundësisë së sigurimit të pjesëmarrjes së përfaqësuesve përkatës të institucioneve përgjegjëse nuk ka arrit ti realizoi. Por sidoqoft, janë përmbushur obligimet ligjore dhe planifikimi i parapar me udhëzime administrativ dhe ligjet në fuqi. Sidoqoft komiteti nuk ka arritur të plotësoj 100% objektivat e veta, por sërish mund të konkludohet se objektivat janë përmbushur në masën e duhur.

Komitetei në takimet e lartëshenuara ka shqyrtuar çështje të ndryshme nga fushveprimtarija e mbrojtjes se ambientit - mjedisit. Ka komunikuar dhe bashkëpunuar ngusht me Drejtorin për Urbanizëm dhe zyrtaren për mbrojtjen e ambientit, me OJQ-në Let's Do It Peja, tani OJQ me emërtim të ri "Rilindja e Gjelber" Pejë, me Agjencionin për mbrojtjen e pyjeve, me Drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, me Drejtorin për Punës Komunale e Shërbime Publike, Drejtorin e Inspektionit, me Ndërmarrjen Rajonale "Hidrodrini" me NPL."Ambienti" sh.a. Pejë, me përfaqësues të NPL."EKOSIG"sh.a. përfaqësuesit e të cilëve janë ftuar dhe kanë marë pjesë në takimet e punës së KKMA, dhe kanë dhënë kontributin e tyre me rastin e trajtimit të temave të

ndryshme nga përgjegjësia e tyre dhe KKMA.-të (siq janë: mbrojtja e ambientit, cilësia e ajrit, cilësisë së ujit të pijës, ujrave sipërfaqesori, gjendjen dhe rregullimin e kanaleve të ujitjes e kanalëve tjera, grumbullimin e mbeturinave, selektimin e tyre dhe riciklimin, ujrata e zeza, mirëmbajtjen e gjelbrimit, mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale, nga zjarret e çështjeve tjera nga fusha në fjalë).

Komititeti në fillim të vitit raportues, ka miratuar Kalendarin e Takimeve të KKMA.-it për vitin 2024 si dhe ka miratuar Planin e Punës së KKMA, për vitin 2024. Sipas të cilit ka punuar gjatë vitit 2024..

Anëtarët e komitetit në forma të ndryshme kanë marrë pjesë në aktivitete për mbrojtjen e ambientit, kanë përcjell gjendjen në teren dhe mangësit evidente i kanë prezantuar në takime të komitetit dhe kanë sugjeruar marrjen e masave në eliminim e tyre, si psh. nga NPL” Ambienti” sh.a . e KK. Pejë, është kërkuar menaxhim më i rregullt i mbeturinave, selekcionimi dhe krijimi i kushteve për riciklimin e tyre. Vendosi e kontejnerëve për mbeturina në hapsira të caktuara ku ato mungojn, shtimin e numrit të tyre, pastaj kanë paraqitur si problem madhor edhe çështjen e qenëve endacak në Komunën e Pejës, që është problem që po paraqet vëllshirësi të madhe dhe sidomos në këtë periudhë të dimrit kur ata edhe më shumë egërsohen qoftë nga i ftohti apo mungesa e ushqimit etj. Edhe pse ky problem nuk është problem ekskluziv për zgjedhje në nivel lokal, por kërkohet ndërgjegjësim të përgjegjësve nga niveli qendror që ky problem të zgjidhet apo së paku të zbutet me masa që duhet ndërmarë në këtë drejtim nga niveli qendror në bashkëpunim me komunën e Pejës. Komiteti njikohësisht ka bashkëpunuar me Drejtoratin e Zhvillimit Ekonomik lidhur me Projektin “Nera”, si dhe ka shpalosur sfida të ndryshme me të cilat ballafaqohemi në përditshmeri, me institucione komunale dhe institucionet tjera përgjegjëse.

Sidoqoftë, janë zhvilluar dhe duhet të zhvillohen aktivitete të tjera qoftë nga komiteti, qoftë nga institucionet komunale, sidomos në eliminimin e ndotësve të ujrave nga individ apo subjekte juridike, ndotësve të ambienteve gjelbëruese, shtretërve të lumenjeve me hudhje të mbeturinave të ndryshme në kohra kur hapsirat gjelbëruese kanë qenë të frekuentuara nga qytetarët duke aluduar tek ta në ndërgjegjësim për mbrojtje të ambientit në tërësi e sidomos aty ku veprojmë dhe jetojmë. Duhet trajtuar edhe ndotjen e ajrit, akustiken, mbrojtje e pyjeve nga prerjet pa kontroll etj. Aktivitete këto dhe të tjera do të jenë përmanent çështje vigjilence nga ana e komitetit në bashkëpunim me subjektet e tjera përgjegjëse institucionale në Komunën e Pejës dhe më gjërë.

Pejë, Janar 2025.

Komiteti Komunal për Mbrojtje të Ambientit,
K r y e s u e s j a,
Valbona Avdijaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KOMITETI KONSULTATIV PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Pejë, 15 Janar 2025

Për:	<ul style="list-style-type: none">- z. Rexhep Kurtbogaj, Kryesues i Kuvendit Komunal Pejë- z. Avni Gashi, Sekretar i Kuvendit Komunal Pejë
Në dijeni:	<ul style="list-style-type: none">- z. Gazmend Muhaxheri, Kryetari i Komunës së Pejës- z. Nasret Hajrizi, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik në Pejë- Asambleistave (Anëtarëve) të Kuvendit Komunal të Pejës
Nga:	<ul style="list-style-type: none">- Faruk Daci, Kryesues i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik në komunën e Pejës
Lënda:	RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR ZHVILLIM EKONOMIK NË KOMUNËN E PEJËS PËR VITIN 2024

Të nderuar, Bashkangjitur e keni Raportin e punës për periudhen e caktuar.

Duke u bazuar në nenin 13 pika 4, të Udhëzimit administrativ nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, Kryesuesi i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Pejës ka përgaditur Raportin vjetor të punës së Komitetit për vitin 2024 dhe para Kuvendit Komunal të Pejës prezenton këtë raport.

**Kryesuesi i Komitetit
Faruk DACI**

**REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PEJËS
KOMITETI KONSULTATIV PËR ZHVILLIM EKONOMIK**

**RAPORTI VJETOR I PUNËS
PËR VITIN 2024**

Pejë, Janar 2025

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE E KRYESUESIT TË KOMITETIT	4
1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....	5
2. STATISTIKA MBI MBLEDHJET E KOMITETIT	6
2.1. Evidentimi i mungesave të anëtarëve në mbledhje	6
2.2. Evidenca e numrit të propozimeve (ideve) të paraqitura nga anëtarët	6
3. PUNA, MBLEDHJET DHE VENDIMARRJA E PROPOZIMEVE.....	7
4. KONTRIBUTI DHE IMPLEMENTIMI I IDEVE TË KOMITETIT	7
5. REKOMANDIMET APO PROJEKT – PROPOZIMET PËR KUVENDIN KOMUNAL DHE DREJTORINË PËR ZHVILLIM EKONOMIK.....	9
5.1. Kostoja e projekt propozimeve	9
5.2. Propozimet	10
5.3. Hulumtime dhe Analiza	15
PËRFUNDIMET.....	16
LISTA E TABELAVE DHE FOTOGRAFIVE.....	17

FJALA HYRËSE E KRYESUESIT TË KOMITETIT

“Ruajuni e kini kujdes nga njerëzit që minojnë ambiciet tuaja. Njerëzit e vegjël e bëjnë këtë gjithmonë, e njerëzit e mëdhenjë vërtet përpiqen t’ju bëjnë që edhe ju të ndiheni sikur mund të bëheni njerëz të mëdhenjë!”

„Çuvajte se ljudi koji potkopavaju vaše ambicije. Mali ljudi to uvijek čine, a doista veliki ljudi nastoje da se osjećate kao da i vi možete postati veliki!”

Mark Twain

Peja është e njohur për biznese dhe sipërmarrës të suksesshëm të cilët veprojnë në një treg vendor dhe ndërkombëtar duke qenë edhe konkurent në botë. Pavarësisht kësaj, sfidat në aspektin e mjedisit biznesor dhe zhvillimit ekonomik po janë ndonjëherë evidente. Prandaj, gjatë punës sonë si komitet po përkushtohemi seriozisht zgjidhjes së problemeve ekzistuese të zhvillimit ekonomik dhe të mjedisit biznesor, por edhe dhënjen e ideve tjera dhe veprimeve tjera të nevojshme për qytetarët dhe komunitetin tonë.

Zhvillimi ekonomik dhe social është procesi me anë të të cilit mirëqenia ekonomike, cilësia e jetesës së një kombi, rajoni, komuniteti lokal ose një individ përmirësohen sipas qëllimeve dhe objektivave të synuara.

Si komitet do të qendrojmë në krye të detyrës, me ambicie e motiv të lartë pune, me synime të caktuara për përmirësimin e mjedisit institucional dhe biznesor, të japim ide dhe projekt – propozime që të jenë katalizator të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisit biznesor.

Sinqeriteti, puna, respekti, si individ që ka ambicie me ndihmu komunën dhe sipërmarrësit, individ apo grup që ka ambicie dhe ka forcë për dhënjën e ideve të një pas njëshme. Ne jemi të vendosur të sjellim propozime cilësore dhe të bëjmë përpjekje maksimale për me i zgjedhur problemet e identifikuar.

Me respekt!

Faruk Daci

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Kuvendi Komunal i Pejës është themelues i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Pejës, me këtë përbërje:

1. Faruk Daci,
2. Natyra Avdyli,
3. Dafina Lajqi,
4. Blerta Husaj,
5. Zana Lipoveci - Kastrati, dhe
6. Omer Daciqi (Omer Dacić).

Anëtarët e Komitetit janë një ekip profesional. Ata kryejnë detyrat, përgjegjësitë dhe aktivitetet me cilësi të lartë ashtu siç dalin nga Udhëzimi Administrativ dhe ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës. Mandati i këtij komiteti është 4 vjeçar.



Fotografia 1. Pamje gjatë një mbledhje të anëtareve, ku prezent ishte edhe drejtori z. Nasret Hajrizi (nga e djathta: Zana Lipoveci-Kastrati, Omer Daciq, Natyra Avdyli, Nasret Hajrizi, Faruk Daci, Dafina Lajqi, Blerta Husaj)

Sipas nenit 73 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe sipas nenit 12 të Udhëzimit administrativ nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna janë Kompetencat e komitetit:

1. Dhënien e propozimeve për rregullore të ndryshme;
2. Hulumtime të ndryshme;
3. Japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga kryetari i komunës, komitetet e përhershme apo kuvendi komunal në fushën përkatëse.
4. Paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve të kryetari i komunës dhe kuvendi i komunës;
5. Japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

2. STATISTIKA MBI MBLEDHJET E KOMITETIT

Në vitin 2024, Komiteti ka mbajtur gjithsejt 7 mbledhje të rregullta. Me këtë e kemi përmbushur nenin 11, pika 2 të Udhezimit Administrativ nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative, që Komiteti duhet të mbajë së paku 6 (gjashtë) takime në vit. E 1 (një) mbledhje e komitetit është mbajtur në mënyrë vullnetare sepse ka qenë nevoja e mbajtjes së edhe një mbledhje më shumë. Mbledhjet janë organizuar në një atmosferë unike kolegjiale, profesionale, ndjenjë pozitive për punën.

2.1. Evidentimi i mungesave të anëtarëve në mbledhje

Tabela 1. Anëtarët prezent dhe ata/ato që munguan në mbledhje

Emri dhe Mbiemri	Prezenca në mbledhje	Mungesa në mbledhje	Gjithsejt Mbledhje
Faruk Daci	7	0	7
Dafina Lajqi	6	1	7
Natyra Avdyli	7	0	7
Blerta Husaj	6	1	7
Zana Lipoveci - Kastrati	4	3	7
Omer Daciq	7	0	7

Burimi: Lista e nënshkrimeve të mbledhjeve të komitetit

Të gjitha takimet e komitetit kanë pasur po thuajse të gjithë anëtarët e saj, kryesuesi është përkujdesur që të jetë kuorumi për pjesëmarrje dhe për vendimarrje. Në tabelën e mësipërme janë paraqitur prezenca dhe mungesat në 7 (shtatë) mbledhje sa janë mbajtur, në mënyrë gjenerale dhe të shprehura me numëra. Vetëm anëtarja Zana Lipoveci-Kastrati i ka 4 mbledhje të mbajtura, ndërsa anëtarët tjerë duhet të paguhen për 6 mbledhje, ata që kanë ka shtatë mbledhje kanë ardhur në mënyrë vullnetare.

2.2. Evidenca e numrit të propozimeve (ideve) të paraqitura nga anëtarët

Tabela 2. Evidenca e numrit të propozimeve (ideve) të paraqitura nga anëtarët

Emri dhe Mbiemri i anëtarit	Propozim – ide të paraqitura
Faruk Daci	2
Omer Daciq	1
Zana Lipoveci - Kastrati	1
Natyra Avdyli	1
Dafina Lajqi	0
Blerta Husaj	0
Gjithsejt:	5

Burimi: Procesverbalet e mbledhjeve të komitetit

Në tabelën e mësipërme tregohet se sa kanë dhënë ide dhe propozime gjatë mbledhjeve secili anëtar. Se cilën ide anëtarët e kanë vlerësuar, nga pikëpamja e pritshmërive dhe arritjeve, fitimit dhe rezultateve përfundimtare pozitive, por edhe nga pikëpamja e investimeve të nevojshme dhe të mundshme nga komuna e Pejës. Nëse vlerësimet dhe përgjigjet nga propozimi kanë qenë pozitive dhe të qarta, ideja është pranuar. Secili anëtarë ka dhënë argumente të vlefshme dhe të qarta për zhvillim të mëtutjeshëm të idesë dhe realizimin e një të tille.

3. PUNA, MBLEDHJET DHE VENDIMARRJA E PROPOZIMEVE

Tiparet më të rëndësishme që gjatë punimëve kanë qenë:

- atmosfera unike e krijuar,
- ndjenja pozitive për punën,
- përmirësimi dhe fleksibiliteti i punës,
- cilësia e ideve dhe e diskutimeve,
- përgjegjësia dhe llogaridhënja, si dhe
- qëllimet e përbashkëta midis anëtarëve.

Këto karakteristika janë të rëndësishme për dhënjen e kontributit për propozime për komunën, në rritjen e transparencës dhe llogaridhënjës.

Vendimarrjen për propozime e bazojmë në sajë të propozimit të idesë nga anëtari apo anëtarët, ku pastaj e analizojmë e dikutojmë duke u bazuar në njohuritë dhe përvojën. Gjithashtu vendimet i marrim në bazë të informacioneve që i kemi, e që është thelbësor për marrjen e vendimeve. Duke pas pak informacione të përgjithshme dhe duke u thelluar në hulumtime dhe anazila vijm deri të propozimet.

4. KONTRIBUTI DHE IMPLEMENTIMI I IDEVE TË KOMITETIT

Në vitin **2023** nga Komiteti është propozuar që të bëhet **Themelimi i Inkubatorit të biznesit në komunën e Pejës**” dhe implementimi i idesë ka arritur në vitin **2024**. Drejtoria për Zhvillimi Ekonomik, e posaçërisht drejtori Nasret Hajrizi e ka zhvilluar më tepër e tutje këtë ide, duke parë shancat dhe mundësit, gjetjen e bashkëpunëtorëve për implementimin e saj. Komuna ndau parcelë në maj 2024 për këtë inkubator, e së bashku me Universitetin “Haxhi Zeka” do të zhvilloj këtë inkubator. Gjithashtu instanca më e lartë shtetërore (MINT), e mbeshteti e mundësinë e themelimit të këtij inkubatori, duke i dhënë mbeshtetje maksimale edhe ministrja z. Rozeta Hajdari. Kështu që edhe niveli qëndror dhe lokal kontribuan në këtë drejtim.

Fotografia 2. Faksimile nga Kuvendi e Komunës së Pejës për Vendim të themelimit të Inkubatorit të Biznesit në Komunën e Pejës, Vendimi i Kryesuesit z. Rexhep Kurtbogaj më datë 28 maj 2024



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
L.Numër: 400-01/37458 , dt. 28 Maj 2024.

Në bazë të nenit 11 e nenit 12.2 pika d) dhe nenit 17 pika a) të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.qershor 2008), nenit 15 të Ligjit nr.08/L-208 për Parqet Industriale dhe Teknologjike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 24/30 Nëntor 2023), nenit 5 pika 1.2 dhe nenit 6 pika 1.4 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 15/2016 për Mënyrën e Themelimit, Funksionimit dhe Administrimit të Inkubatorëve të Biznesit, nenit 20, paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, L.Numër:01-016/01-413431 dt. 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28 Maj 2024, merr këtë:

VENDIM
Nr.20/2024

Mbi iniciativën e themelimit të inkubatorit të biznesit në Pejë

1. MIRATOHET Vendimi mbi iniciativën e themelimit të inkubatorit të biznesit në Pejë
2. Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Pejës dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së si dhe 7 (shtat) ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Pejës.

Vendimi i dërgohet:
MAPL,
MINT,
Kryetarit të Komunës,
DZHE,
Arkivë.



Burimi: Komuna e Pejës. Pejë, Maj 2024.

Fotografia 3. Faksimile nga MINT për Vendim të themelimit të Inkubatorit të Biznesit në Komunën e Pejës, Vendimi i ministrës z. Rozeta Hajdari më datë 30 korrik 2024



Burimi: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Prishtinë, Korrik 2024.

5. REKOMANDIMET APO PROJEKT – PROPOZIMET PËR KUVENDIN KOMUNAL DHE DREJTORINË PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Sipas nenit 73, pika 3 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime, bëjnë hulumtime dhe ofrojnë mendime për iniciativat e kuvendit të komunës, në pajtim me statutin e komunës.

Gjatë takimeve të Komitetit janë marrë vendime që të dërgojmë rekomandimet apo projekt propozimet për Kuvendin Komunal dhe Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik, ato propozime janë:

1. KONFERENCA RAJONALE PËR TURIZËM
2. RRJETI TELEFONIK DHE INTERNET PËRGJATË RRUGËS SË RUGOVËS
3. ‘THEMELIMI I PARKUT TË BIZNESIT NË PEJË (ZONËS EKONOMIKE)
4. MBËSHTETJA FINANCIARE PËR BIZNESET ARTIZANALE – SHËRBYESE
5. ZHVILLIMI I TURIZMIT TË AVENTURAVE NË PEJË (Parqeve të Aventurave)

Duke pasur parasysh informata, duke hulumtuar dhe duke parë zbrastirë në këtë drejtim, janë prezentuar këto propozime të nevojshme për përfundimin e tyre, duke kontribuar në zhvillim ekonomik. Gjithashtu parasysh cilësinë që kanë qenë të përgaditura me të gjitha karakteristikat e nevojshme si një projekt.

5.1. Kostoja e projekt propozimeve

Tabela 3. Kostoja e të propozimeve (ideve) të paraqitura

Nr.	IDEA APO PROPOZIMI	KOSTOJA
1	KONFERENCA RAJONALE PËR TURIZËM	2,000 deri në 30,000 euro ¹
2	RRJETI TELEFONIK DHE INTERNET PËRGJATË RRUGËS SË RUGOVËS	Nuk është paraqitur
3	‘THEMELIMI I PARKUT TË BIZNESIT NË PEJË (ZONËS EKONOMIKE)	Nuk është paraqitur
4	MBËSHTETJA FINANCIARE PËR BIZNESET ARTIZANALE – SHËRBYESE	4998 euro ²
5	ZHVILLIMI I TURIZMIT TË AVENTURAVE NË PEJË (Parqeve të Aventurave)	Nuk është paraqitur

Burimi: Procesverbalet e mbledhjeve të komitetit

Këtë propozim mundë të kryhej menjëherë nga komuna e Pejës, pasi që nuk ka një kosto të lartë për të qenë ngarkesë buxhetore për Komunën e Pejës. Dy projekte paraqesin edhe kosoton e realizimit, ku në njërin janë kostot fikse 4998.00 euro të nevojshme, e në trjetrin projekt kostoja totale është variabile prej 2,000.00 deri 30,000.00 euro. Nevojitet edhe një përpunim shtesë nga organet komunale, që të caktojë shumën e nevojshme për realizim. Kërkohet edhe mbeshtejte nga niveli qëndror, osee mund të projektohet për donatorët e mundshëm si dhe në parteritet publiko-privat.

¹ Kostot e konferencave ndikohen nga një mori faktorësh, duke i bërë ato po aq të ndryshme sa edhe vetë konferencat. Duke filluar me kërkesat minimale të buxhetit prej 2,000 deri në 30,000 euro, kostot mund të rriten në qiell në varësi të vendit të ngjarjes, numrit të pjesëmarrësve dhe nivelit të lehtësive.

² Janë paraqitur kostot totale të 22 mjeteve dhe veglave të nevojshme për përfundimin e këtij projekti.

5.2. Propozimet

PROPOZIMI 1: KONFERENCA RAJONALE PËR TURIZËM

Si informata të përgjithshme kemi qe konferenca është një grup aktivitesh dhe marrëdhëniesh që rrjedhin nga udhëtimi dhe qëndrimi i individëve që mbledhen së bashku për të shkëmbyer njohuri kryesisht shkencore dhe profesionale, dhe ku vendi i takimit nuk është një vend pune apo vendbanimi por një vend që mbledh këta përfaqësues për të diskutuar dhe prezantuar shërbimet, hulumtimet dhe tjera. Të kuptuarit e tendencave të industrisë dhe rrjetëzimit në sferën e zhurmshme të turizmit dhe kohës së lirë është jetike. Ndër mjetet e ndryshme të disponueshme për profesionistët e kësaj fushe, një e spikatur është konferenca. Kjo fushë thekson sigurimin e kënaqësisë së klientit, menaxhimin e burimeve dhe përmirësimin e operacioneve të biznesit në hotele, resorte, agjenci udhëtimesh dhe entitete të tjera të lidhura. Profesionistët në këtë fushë përdorin ekspertizën e tyre për të krijuar përvoja të paharrueshme për mysafirët duke optimizuar performancën e biznesit. Promovimi i qytetit, kultures, gastronomise dhe tradites jane tendencat kyqe!

Përmbajtja e këtij projekt propozimi ishte: qëllimi i përgjithshëm i projektit, objektivat specifike të projektit, aktivitetet kryesore dhe rezultatet e pritura, pjesëmarrësit e konferencës, kostoja e projekt propozimi, përfundimet dhe rezultatet e projektit.

Kostot e konferencave ndikohen nga një mori faktorësh, duke i bërë ato po aq të ndryshme sa edhe vetë konferencat. Duke filluar me kërkesat minimale të buxhetit prej 2,000 deri në 30,000 euro, kostot mund të rriten në qiell në varësi të vendit të ngjarjes, numrit të pjesëmarrësve dhe nivelit të lehtësive.

Fotografia 4. Pamje ilustruese të prezentimit të konferencës dhe publikut



Burimi: Ekipedia/Conference meeting

PROPOZIMI 2:

RRJETI TELEFONIK DHE INTERNET PËRGJATË RRUGËS SË RUGOVËS

Duke e ditur që dita ditës po rritet numri i turistëve nga mbarë bota me theks të veçant ballkani të cilet vizitojnë Rugovën si vend turistik tashmë i njohur nga veqantit e saj, përveq nevojës imediate që të punohet.

Me projekte kapitale siq është rregullimi i rrugës kryesore që lidh fshatrat e Rugovës nevoj tjetër është edhe shtrirja e rrjetit (telefonik dhe internetit) përmes vendosjes së antenave ku do të komunikohet me lehtë dhe përdorimi i internetit apo thirrjeve telefonike do tu mundesohej në veqanti turistëve që të shërbehen me internet gjatë rrugës (4G) si në përdorimin e hartave “maps” apo në kërkimin e hoteleve/bujtinave ku do të qëndronin dhe ndoshta të informoheshin me mirë për ato bukuri që i ofrojnë bjeshkët e Rugovës.

Në vazhdimi të kësaj do të ishte mirë që secili fshat i Rugovës në hyrje të tij të vendos hartat për madhësi të fshatit me ke kufizohet pastaj edhe një historik të shkurter rreth fshatit e ato qka ofron apo veqohen për t’u vizituar.

Të bëhet një sensibilizim me banorët apo bizneset që të bashkëpunojnë me kompani të ndryshme marketingu dhe të punohet drejtë asaj që të pakten 80% e bujtinave të mundë të rezervohen përmes “booking” platformave nga secili turist.

Kostot e propozimit nuk janë elaboru.

Përmbajtja e këtij projekt propozimi ishte: qëllimi i përgjithshëm i projektit, objektivat specifike të projektit, aktivitetet kryesore dhe rezultatet e pritura, pjesëmarrësit e konferencës, kostoja e projekt propozimi, përfundimet dhe rezultatet e projektit.

PROPOZIMI 3:

THEMELIMI I PARKUT TË BIZNESIT NË PEJË (ZONËS EKONOMIKE)

Përmbajtja e këtij projekt propozimi ishte: hyrje me informata të përgjithshme, kuptimi i parkut të biznesit, qëllimi e përgjithshme të projektit dhe objektivat specifike të projektit, historiku i zhvillimit të parkut të biznesit në botë, rëndësia dhe karakteristikat e parkut, përfitimi i bizneseve dhe komunës nga Parku i biznesit, gjendja aktuale e parqeve në Republikën e Kosovës, kostoja e projekt, përfundimet dhe rezultatet e projektit.

Anëtarët e komitetit diskutuan dhe analizuan në detaje propozimin, duke përfunduar rezultatet e pritura nga projekti janë shumë të larta dhe reale, sa që do të iu ndihmontë shumë ndërmarrjeve që të zgjerojnë veprimtaritë e tyre, por edhe ndërmarrjeve fillestare. Duke pasur hapësirë të mjaftueshme e të nevojshme logjistike, por qoft edhe hapësire administrative.

Krijimi i Parkut të biznesit jemi të bindur se do të sjelle investitor vendor dhe të huaj, e kështu do të ketë punësime të reja.

Fotografia 5. Pamje ilustruese e disa bizneseve në një park biznesi në SHBA



Burimi: ëikipedia/

PROPOZIMI 4:

MBËSHTETJA FINANCIARE PËR BIZNESET ARTIZANALE – SHËRBYESE

Përmbajtja e këtij projekt propozimi ishte: Hyrje me qëllimin e projektit dhe informatat e përgjithsme, Kërkesa për mjetet e nevojshme të punës (duke specifikuar vlerën e mjeteve), Të ardhurat totale, Shfrytëzuesit e projekt-propozimit, Përfundimet duke arësytuar projektin.

Ky projekt-propozim për shërbimeve (zanateve) për furnizimin e mjeteve dhe veglave bazë për punë, për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe punësimin e pjesëtarëve të papunë të komuniteteve joshumicë. Ky propozim të behet si donacion për përfituesin/it. Shuma e përgjithshme për mbeshtetje (donacion) është 4,998.00 €, ku propozuesi i ka specifikuar në detaje mjetet dhe veglat e nevojshme gjithë 22 mjete.

Ky program do të elaboronte nevojën dhe arsytimin e investimit në skelat montuese dhe pajisjet përcjellëse për punën e fasadave dhe aktivitetet e tjera shërbyese në ndërtim. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe kushtet që do të kishin këta artizanë në mjedisin e tyre. Të gjithë ata theksojnë se janë angazhuar në këtë biznes për një kohë të gjatë. Mirëpo, problem për ta është puna me zeje të ndryshme, ku u duhen mjete të posaçme për të kryer punën më shpejt dhe me efikasitet.

Mjeshterive individual në ndërtimin e fasada dhe lysterje të vrazhd përjashta dhe përbrenda, u duhen mjete dhe vegla, nuk është e ngjashme me aktivitetet e tjera të artizanateve. Por e gjithë kjo nuk mjafton, ata kanë nevojë për mjete shtesë për të blerë mjetet dhe pajisjet e nevojshme për punë dhe për të zgjeruar aktivitetet e shërbimit dhe për të punësuar një numër më të madh të njerëzve.

Ekziston nevoja dhe rrjedhimisht një arsyetim tregu për realizimin e programit të dhënë konceptual ku komunitetet joshumicë të Vitomiricës mund të marrin një donacion dhe ta arsyetojnë atë me punën dhe mundin e tyre të investuar. Me zbatimin e këtij programi, investimi i planifikuar mundëson vetëpunësimin e zejtarëve tani dhe më vonë punësim të mundshëm dhe fuqi punëtore shtesë nga zyra e punës në Pejë.

PROPOZIMI 5:

ZHVILLIMI I TURIZMIT TË AVENTURAVE NË PEJË (Parqeve të Aventurave)

Kjo ide do të mund të realizohet pasi potencialet natyrore dhe turistike të rajonit të Pejës janë të shumta andaj duhet të shtohen dhe të zbardhen llojet e turizmit të aventurës, për të cilat ka kushte të favorshme në këtë zonë.

Ndër aktivitetet e ndryshme aventureske më të rëndësishmet janë: ecje, zip-line, speleoturizëm, rafting, parashutizmi dhe çiklizëm malor. Megjithatë, për shkak të problemeve të shumta kjo degë e turizmit është jo shumë e zhvilluar. Kemi një zip-line, një shteg për ngjitje në shkëmbinjë (Marimangat) një park të aventurave (Ranch), disa shtigje të ecjes (në Grykë të Rugoves, në Radac), etj.

Nga pikëpamja ekonomike është e pamundur të flitet për zonë potenciale sepse nuk ka të dhëna të lëvizjes turistike në fushën e turizmit aventuresk në pjesët e shqyrtuara të Pejës.

Zhvillimi potencial i Parkut të aventurave:

- ✓ Një park të Aventurave në bjeshkë të Lipës;
- ✓ Një park të Aventurave në Shtedim;
- ✓ Park të Aventurave në disa fshatra të Rugovës (Pepaj, Koshutan, Rekë e Allagës).

Të ndërtohen sipas standardeve më të larta dhe të rriten ofertat për turizëm, të ngritet konkurrencë e drejtë, një marketing i mirëfilltë tek turistat.

Baza për grupimin e zonave potenciale bëhet nga këto kriteret: pozicioni turistik - gjeografik (distanca nga atraksionet e tjera turistike), lidhja dhe pozicioni i trafikut, tërheqja e zonës. Një kriter i veçantë janë lokalizimet e pajisura me infrastrukturë turistike (shtigje, sinjalistikë rrugore, shërbim informacioni, reklamë). Për valorizimin turistik të zonës “aventurore” të rajonit të Pejës të rëndësishme janë edhe llojet, karakteristikat dhe vendosja e motiveve të aventurës.

Fotografia 6. Pamje e një parku të aveturave



Burimi: ëikipedia/

5.3. Hulumtime dhe Analiza

Në mbledhje anëtarët e komitetit kanë shqyrtuar faqe për faqe Raportin e DZHE-së, ku njoftohen për punën e drejtoratit për periudhën qershor – dhjetor 2023 dhe janar – qershor 2024. Ku nga ky raport, anëtarët e komitetit mund t'i nxjerrim përgjigjet, pasi në përmbajtje të tij janë 19 faqe A4, dhe është i mbështetur në planin dhe programin të punës për realizimin e punëve dhe detyrave.

Ne si anëtar të komiteit dëshirojmë që paraprakisht të dijmë se cilat janë qëllimet dhe objektivat e drejtoratit, strategjinë e ekzekutivit për zhvillim ekonomik dhe zhvillim të turizmit. Kështu që, si komitet të gjithë energjinë tonë dhe kontributin të japim në të njëjtin drejtim.

Fotografia 7. Pamje e e Grykës së Rugovës



Burimi: facebook

PËRFUNDIMET

Në njëren nga mbledhjet e vitit 2023 nga KKZH ishte dhënë propozimi “Themelimi i Inkubatorit të biznesit në komunën e Pejës”, kështu që gjatë vitit 2024 filloi implementimi i kësaj ideje. Kështu që përfundojmë se puna jonë po vlerësohet nga organet komunale të Pejës, po merren për implementim projektet tona. Gjë që bëri për anëtarët e komitetit që një motiv shtesë për dhënjen e propozim-ideve të reja.

Ne si komitet në vitin 2024 i kemi japur disa propozime të cilat sa do pak mendojmë që mund të ndikojnë në mirëqenien ekonomike. Duke i japur këto propozime: 1. Konferenca Rajinale për turizëm - Konferenca do të ofrojë një mundësi për të eksploruar tema përfaqësuese të sektorit të turizmit si dhe sfidat në promovimin e turizmit, edukimin turistik dhe ndikimin e tij në shërbimet cilësore të turizmit, si dhe zhvillimin përtej turizmit klasik. Shkëmbimi ndërmjet vendeve në rajon, ekspozimi i qasjeve dhe pikëpamjeve të ndryshme, si dhe sfidave, janë të rëndësishme për të kuptuar dhe mësuar nga eksperiencat e njëri tjetrit, duke krijuar hapësira më të gjera për zhvillim dhe avancim në një kuadër rajonal. 2. Rrjeti Telefonik dhe interneti - telefonia mobile është teknologji që është duke u rritur me shpejtësi të jashtëzakonshme. Ky përparim në teknologji mobile ka pasur ndikim në jetën e të gjithëve prandaj edhe është kerkura që të investohet me tepër në zonen turistike në rugove. 3. Themelimi i parkut të biznesit në Pejë është shumë i rëndësishëm pasi që ky park ka për qëllim: Nxitjen dhe mbështetjen e investimeve të qëndrueshme, me veprimtari prodhuese dhe përpunuese, të cilët do të operojnë në formën e një ekosistemi inovativ Punësimin dhe aftësimin e fuqisë punëtore, Nxitjen e veprimtarive që i kontribuojnë ekonomisë qarkore, Rritjen e konkurrueshmërisë dhe mbështetjen e eksportit dhe nxitjen dhe transferimin e teknologjisë së avancuar. 4. Mbeshtetja financiare për bizneset artizanale - sherbyese: Ky sektor sa i lashtë dhe me vlerë është mjaft i ndërlidhur edhe me agroturizmin, i cili po merr zhvillim vitet e fundit në shumë krahina të vendit, ku kontribut bart edhe trashigimia artizanale, si trend që tërheq mjaft turistët e huaj, duke krijuar një mjedis të favorshëm për aktivitete më të qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës. 5. Zhvillimi i turizmit të aventurave në Pejë - Ka një rëndësi të veçantë pasi që përfshin trajnimin e burimeve njerëzore, dixhitalizimin, si dhe mbështetjen e të rinjëve në rrugën për të pasur një biznes në fushën e turizmit.

Në bazë të analizës së punës së deri tanishme të Komiteti për Zhvillim Ekonomik, u konstatua se ka vend për projekte dhe propozime të reja për zhvillimin ekonomik të Pejës.

Propozimet tona të mëhershme që i kemi bashkangjitur janë pranuar pjesërisht nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, por ka edhe projektet e tjera të mëparshme të pa realizuara, andaj ju lutemi gjeni më shumë mirëkuptim dhe ti implementoni projekt-propozimet e reja të paraqitura para jush!

LISTA E TABELAVE DHE FOTOGRAFIVE

Emërtimi i tabelës	Faqe
<i>Tabela 1. Anëtarët prezent dhe ata/ato që munguan në mbledhje</i>	6
<i>Tabela 2. Evidenca e numrim të propozimeve (ideve) të paraqitura nga anëtarët</i>	6
<i>Tabela 3. Kostoja e të propozimeve (ideve) të paraqitura</i>	9

Emërtimi i fotografisë	Faqe
<i>Fotografia 1. Pamje gjatë një mbledhje të anëtareve, ku prezent ishte edhe drejtori z. Nasret Hajrizi</i>	5
<i>Fotografia 2. Faksimile nga Kuvendi e Komunës së Pejës për Vendim të themelimit të Inkubatorit të Biznesit në Komunën e Pejës, Vendimi i Kryesuesit z. Rexhep Kurtbogaj më datë 28 maj 2024</i>	8
<i>Fotografia 3. Faksimile nga MINT për Vendim të themelimit të Inkubatorit të Biznesit në Komunën e Pejës, Vendimi i datës 30 korrik 2024</i>	8
<i>Fotografia 4. Pamje ilustruese të prezentimit të konferencës dhe publikut</i>	10
<i>Fotografia 5. Pamje ilustruese e disa bizneseve në një park biznesi</i>	12
<i>Fotografia 6. Pamje e një parku të aveturave</i>	14
<i>Fotografia 7. Pamje e e Grykës së Rugovës</i>	15